

**LIGJ
PËR PRONËSINË INDUSTRIALE**

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përmbajtja e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet fitimi, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale.

Të drjetat nga pronësia industriale

Neni 2

(1) Të drejtat nga pronësia industriale janë: patenta, dizajni industrial, markaë tregtare, shenja e prejardhjes dhe shenja gjeografike.

(2) Me patentë mbrohet shpikja.

(3) Me dizajnin industrial mbrohet forma e re e trupit, piktura, vizatimi, kontura, kompozicioni i ngjyrave dhe ose kombinimi-dizajni i tyre.

(4) Me markë tregtare mbrohet shenja tregtare.

(5) Me shenjën e prejardhjes dhe shenjën gjeografike mbrohet emri gjeografik.

Përkufizime

Neni 3

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj, kanë kuptimin si vijon:

-“të drejtat nga pronësia industriale” janë të drejta nga krijime intelektuale dhe lidhje ekonomike nga lëmi i industrisë dhe tregtisë, duke përfshirë edhe bujqësinë, sipas nenit 2 paragrafi (1) nga ky ligj;

- “patenta” është e drejtë e pronësisë industriale, me të cilën mbrohet shpikja në procedurën sipas këtij ligji;

-“dizajni industrial” është e drejtë e pronësisë industriale, e fituar në procedurë sipas këtij ligji me të cilën mbrohet dizajni;

- “markë tregtare” (e mallit, e shërbimit, markë kolektive dhe certifikate) është e drejtë e pronësisë industriale fituar me procedurë sipas këtij ligji me të cilën mbrohen shenja tregtare;

- “shenja gjeografike” është e drejtë e pronësisë industriale e fituar në pajtim me këtë ligj, me të cilën mbrohet emri gjeografik;

- “shenja e prejardhjes” është e drejtë e pronësisë industriale e fituar në pajtim me këtë ligj, me të cilën mbrohet emri gjeografik;

-“shpikje” është zgjidhja e e problemit teknik që ka të bëjë me prodhimin, procedurën ose materien vetvetiu, e cila është rezultat i një veprimi të caktuar;

- “dizajni” është pamje e jashtme e prodhimit në tërësi ose të pjesës së tij, i cili është i përcaktuar nga karakteristikat e tij, në veçanti vijat, konturat, ngjyrat, forma, tekstura dhe materialet nga të cilat prodhimi është i përbërë ose i zbukuruar si dhe/ose zbukurimi i tij;

-“shenja tregtare” është shenjë e cila mund të paraqitet grafikisht dhe i plotëson kushtet nga neni 175 i këtij ligji;

- “emër gjeografik” është emri dhe /ose karakteristika e vendit, rajonit ose territorit me të cilët shënohet se prodhimi rrjedh nga ai vend;

- “e drejtë e mbrojtur, e regjistruar ose e pranuar nga pronësia industriale” të përdorura në këtë ligj, e kanë domethënien e njëjtë;

-“materiali biologjik” është material i cili përmban informata gjenetike dhe i cili mund të shumëzohet vet, ose të shumëzohet në sistemin biologjik;

- “veprim i pastër biologjik” është veprimi i cili përbëhet nga fenomeni natyror, siç është kryqëzimi ose seleksionimi;

-“prodhim mjekësor” është cilado substancë ose kombinim i substancave në formën doze farmaceutike i dedikuar për mjekim, diagnostifikim ose pengimin e dhembjeve, gjegjësisht për pengimin, korrigjimin ose modifikimin e funksioneve fiziologjike të njerëzimit ose kafshët;

-“prodhim” është përbërës farmakologjik aktiv ose kombinim i përbërësve aktivë të prodhimit mjekësor;

-“patenta themelore” është patentë e ndarë për çdo prodhim, duke përfshirë edhe procedurën për prodhimin e produktit ose përdorimin e tij, i cila është shënuar në procedurën për dhënie të certifikatës;

-“certifikatë” është certifikatë për mbrojtje plotësuese të prodhimeve mjekësore ose certifikatë për mbrojtje plotësuese të produkteve për mbrojtje të bimëve;

- “produkte për mbrojtje të bimëve” janë substanca aktive dhe preparate që përmbajnë një ose më shumë substanca aktive, në formën në të cilën i dorëzohen shfrytëzuesit, të dedikuara për:

-mbrojtje të bimëve ose të produkteve bimore nga të gjitha organizmat dëmtuese ose për pengimin e veprimit të atyre organizmave , nëse substancat ose preparatet e atilla nuk janë definuar ndryshe më poshtë,

-ndikim ndaj procesit jetësor të bimëve, me ç’rast nuk kanë cilësi të përbërjes ushqyese (për shembull, rregulluesit e rritjes së bimëve)

-ruajtjen e produkteve bimore

-zhdukjen e bimëve të padëshirueshme

-zhdukjen e pjesëve të bimëve, kufizimin ose– pengimin e rritjes së padëshirueshme të bimëve;

-“substancë” janë elementet kimike dhe kombinimet e tyre, të cilat mund të paraqiten në formë natyrore ose të përpunuar, duke përfshirë çdo përbërës që në mënyrë të pashmangshme është rezultat i procesit prodhues;

- “substancë aktive” janë substanca ose mikroorganizma, duke përfshirë edhe virusë të cilët kanë veprim të përgjithshëm ose të veçantë

kundër organizmave të dëmshëm ose ndaj bimëve, pjesëve të bimëve ose prodhime bimore;

- “preparate” janë përzierje ose tretje të përbëra prej dy ose më shumë substancave, nga të cilat së paku njëra është substancë aktive, të dedikuara për përdorim si produkt për mbrojtje të bimëve;

- “ bimë” janë bimë të gjalla ose pjesë të gjalla të bimëve, duke i përfshirë edhe pemët e freskëta dhe farat;

- “produkte bimore” janë produkte të bimëve në gjendje të papërpunuar, ose të cilat kanë pësuar përgatitje të thjeshtë: bluarje, tharje ose terje, por me përjashtim të vet bimëve;

- “ organizmat e dëshmshme” janë dëmtues të bimëve ose prodhimeve bimore të cilat i takojnë botës shtazore ose bimore, e gjithashtu edhe virusë, bakterie dhe mikroplazma dhe agjentë të tjerë patogjenë;

- Konventa e Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale e miratuar në vitin 1883, e ndryshuar dhe e plotësuar (në tekstin e mëtejme: “Konventa e Parisit”);

- Marrëveshje për bashkëpunim në lëmin e patentave, është Marrëveshja nga 19 qershori 1970, e ndryshuar dhe e plotësuar (në tekstin e mëtejme : MBP);

- Marrëveshja e Madridit për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare nga 14 prilli 1891, i ndryshuar dhe i plotësuar (në tekstin e mëtejme : Marrëveshja e Madridit):

- “Klasifikimi ndërkombëtar i prodhimeve dhe shërbimeve” është klasifikim sipas Marrëveshjes nga Nica, për klasifikim ndërkombëtar të prodhimeve dhe shërbimeve për regjistrim të markave tregtare nga 15 qershori 1957, i ndryshuar dhe i plotësuar;

- “Klasifikimi i Lokarnës” është klasifikim sipas marrëveshjes së Lokarnës për klasifikim ndërkombëtar të dizajnit industrial, nga 8 tetori 1968, i ndryshuar dhe i plotësuar;

- “Unioni i Parisit” është union i themeluar në Konventën e Parisit ;

- “Marrëveshja e Hagës për paraqitje ndërkombëtare të dizajnit industrial”, dokumenti i Hagës nga 28 nëntori 1960, i ndryshuar dhe i plotësuar (në tekstin e mëtejme: marrëveshja e Hagës) ;

- Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e patentave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Organizatës Evropiane të patentave dhe Dispozitat të cilat vlejné gjatë zgjerimit të patentave evropiane, nga 24 qershori 1997 (në tekstin e mëtejme : Marrëveshje për zgjerim);

- Konventa Evropiane e patentave nga 05.10.1973, e reviduar më 17.10.1991 dhe më 29.12.2000, e miratuar nga Këshilli administrativ i Organizatës evropiane të patentave më 28.06. 2001 (në tekstin e mëtejme: KEP);

- Enti evropian i patentave i obliguar për zbatizimin e procedurës për njohjen e patentave evropiane në pajtim me KEP-në (në tekstin e mëtejme: EEP-së)

- Fletëparaqitjet e patentave të parashtruara para EEP-së, të cilave u është caktuar data e dorëzimit në EEP (në tekstin e mëtejme : fletëparaqitjet evropiane);

- Patentat të cilat i ka pranuar EEP-ja në bazë të KEP-së (në tekstin e mëtejme: patentat evropiane);

- Protokoli i marrëveshjes së Madridit për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare nga 27 qershori 1989 (në tekstin e mëtejme : Protokoli i Madridit);

- Organizata tregtare botërore, organizatë ndërkombëtare e formuar me marrëveshjen e Marakeshit(në tekstin e mëtejme : OTB);

-Marrëveshja për aspektet tregtare të të drejtave nga pronësia intelektuale e OTB(në tekstin e mëtejme: TRIPS) dhe

- Konventa për ekspozita ndërkombëtare e nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928, për herë të fundit e reviduar më 31 maj 1988 (në tekstin e mëtejme :Konventa për ekspozita ndërkombëtare).

Parimi i ligjshmërisë

Neni 4

Të drejtat e pranuar në bazë të këtij ligji, nuk mund të shfrytëzohen në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe zakonet e mira afariste.

Subjektet e të drejtave nga pronësia industriale

Neni 5

(1) Subjekte të të drejtave nga pronësia industriale, janë persona fizikë dhe juridikë vendorë dhe të huaj.

(2) Personat e huaj fizikë dhe juridikë, në pajtim me këtë ligj, në aspektin e mbrojtjes së të drejtave nga pronësia industriale në Republikën e Maqedonisë, i gëzojnë të drejtat e njëjta si personat vendorë juridikë dhe fizikë, nëse kjo rrjedh nga marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, ose nga zbatimi i parimit të reciprocitetit.

(3) Ekzistimin e reciprocitetit nga paragrafi (2) i këtij ligji, e dëshmon personi i cili thirret në të.

Të drejtat e subjekteve të të drejtave nga pronësia industriale

Neni 6

(1)Shpikësi i patentës dhe autori i dizajnit industrial, kanë të drejta morale dhe ekskluzive në krijimet e tyre, të përcaktuara me ligj.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe bartësi i patentës, dizajnit industrial, markës tregtare, shfrytëzuesi i autorizuar i shenjës së prejardhjes dhe shfrytëzuesi i autorizuar i shenjës gjeografike, kanë edhe të drejta tjera të përcaktuara me marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare, ligj tjetër, akte të përgjithshme dhe marrëveshje.

E drejta morale

Neni 7

(1) E drejtë morale e shpikësit dhe autorit është të jenë të shënuar në fletëparaqitje dhe dokumente, që kanë të bëjnë me patentën dhe dizajnin industrial.

(2) Nëse shpikja ose dizajni është rezultat i punës krijuese të më shumë personave, ata e gëzojnë të drejtën nga paragrafi (1) i këtij neni.

Të drejta ekskluzive

Neni 8

(1) E drejta ekzluzive e bartësit të patentës, dizajnit industrial dhe markës tregtare, e përfshin të drejtën e shfrytëzimit, e disponimit, të drejtën e kompensimit dhe të drejtën që t'ua ndalojë personave të tretë, shfrytëzimin e paautorizuar në rastet dhe në mënyrë që janë paraparë me marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare, me këtë ligj, me ligj tjetër dhe me marrëveshje.

(2) Bartësit e markës tregtare kolektive dhe shfrytëzuesit e autorizuar të shenjës së prejardhjes dhe shenjës gjeografike, i gëzojnë të drejtat nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç të drejtës për disponim.

Institucioni kompetent

Neni 9

(1) Punët në lidhje me marrjen dhe mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale, i kryen Enti shtetëror për pronësi industriale (në tekstin e mëtejshëm: Enti).

(2) Enti është organizatë administrative me status të organit të pavarur të administratës shtetërore, me kompetenca të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(3) Enti ka cilësi të personit juridik.

(4) Selia e Entit është në Shkup.

Udhëheqja

Neni 10

(1) Me Entin udhëheq drejtori.

(2) Drejtori ka zëvendës.

(3) Drejtorin e Entit dhe zëvendësin, i emëron dhe i shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Drejtori e përfaqëson dhe prezanton Entin.

Kompetencat

Neni 11

Enti i kryen këto detyra :

- kryen pranimin e fletparaqitjeve për mbrojtjen e të drejtave të përonësisë industriale;
- zbaton procedurë administrative për fitimin e të drejtave nga pronësia industriale;
- udhëheq regjistra të të drejtave të fituara dhe regjistra tjerë të përcaktuar me këtë ligj ;
- boton gazetë zyrtare në të cilën përmbahen të dhënat për të drejtat e paraqitura dhe të pranuar nga pronësia industriale ;
- realizon provim për përfaqësues të sferës së pronësisë industriale për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale;
- përgatit propozime për nxjerrjen e akteve ligjore dhe akteve tjera nga lëmi i pronësisë industriale;
- e promovon mbrojtjen e pronësisë industriale;
- e përfaqëson Republikën e Maqedonisë dhe i paraqet interesat e saj në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale për pronësi industriale;
- ngrit iniciativa për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kujdeset për kryerjen e obligimeve nga lëmi i pronësisë industriale, të cilat dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, që i ka lidhur Republika e Maqedonisë;
- përgatit dhe lëshon udhëzime, doracakë dhe komente nga lëmi i pronësisë industriale;
- bashkëpunon me subjekte tjera, të inkuadruara në sistemin për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në vend dhe jashtë dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Financimi

Neni 12

(1) Mejtet për punë të Entit, sigurohen nga të hyrat e veta, ndërsa nëse nevojiten mjete plotësuese edhe nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Të hyrat

Neni 13

Të hyrat e veta Enti i realizon për punët të cilat i kryen sipas marrëveshjes së Madridit, protokollit të Madridit dhe marrëveshjes së Hagës, Marrëveshjes për zgjerim, si dhe nga arkëtimi i harxhimeve të procedurës dhe nga kompensimet për dhënie të shërbimeve informative.

Marrdhëniet e Entit me organet dhe shfrytëzuesit tjerë

Neni 14

Për realizimin e veprimtarisë së tij Enti bashkëpunon me organe tjera shtetërore, persona juridikë dhe fizikë dhe shoqata të qytetarëve nga lëmi i pronësisë industriale dhe këmben informata me ente tjera nga jashtë, përveç

nëse për lloj të caktuar të këmbimit të informatave me ligj nuk është përcaktuar ndryshe .

Raporti

Neni 15

Enti paraqet së paku një herë në vit raport për punën e vet, te Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Regjistrat dhe shpallja e të dhënave nga regjistri i Entit

Neni 16

(1) Enti udhëheq regjistra të të drejtave të paraqitura dhe të pranuar nga pronësia industriale dhe regjistër të përfaqësuesve në lëmin e pronësisë industriale.

(2) Në regjistrat shënohen edhe ndryshimet e mëvonshme që kanë të bëjnë me parashtruesin e fletëparaqitjes, bartësin e të drejtës dhe vet të drejtës.

(3) Regjistrat nga paragrafi (1) i këtij neni janë publikë.

(4) Regjistrat e Entit udhëhiqen në formë elektronike.

(5) Të dhënat për fletëparaqitjet e parashtruara dhe të drejtave të pranuar nga pronësia industriale, shpallen në gazetë zyrtare në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(6) Gazeta zyrtare publikohet në formë elektronike dhe shpallet në ueb faqen e Entit.

Lloje të fletëparaqitjeve për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale

Neni 17

(1) Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Maqedonisë, kërkohet me parashtrim të fletëparaqitjes përkatëse në Ent.

(2) Enti pranon edhe fletëparaqitje me të cilat kërkohet mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale jashtë vendit, nëse ajo është në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare dhe konventat të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

(3) Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Maqedonisë, mund të kërkohet edhe me fletëparaqitje të parashtruar jashtë, nëse ajo është në pajtim me marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

(4) Parashtruesi i fletëparaqitjes nga paragrafi (3) i këtij neni, i ka të njëjtat të drejta si dhe parashtruesi i fletëparaqitjes nacionale, përveç nëse me marrëveshje ose konventë të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjes

Neni 18

(1) Fletëparaqitja për fitimin e të drejtave nga pronësia industriale parashtrohet në formë të shkruar, personalisht, me postë ose në formë elektronike.

(2) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik.

(3) Fletëparaqitja për fitimin e të drejtës nga pronësia industriale mund të parashtrohet edhe në gjuhë të huaj, nëse e përmban shënimin e llojit të mbrojtjes e cila kërkohet dhe të dhëna për kontakt me parashtruesin në gjuhën maqedonase.

(4) Nëse fletëparaqitja është parashtruar në gjuhë të huaj, parashtruesi doemos duhet që në afat prej 90 ditëve nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes në gjuhë të huaj, të dorëzojë përkthim të fletëparaqitjes në gjuhën maqedonase, në të kundërtën do të konsiderohet që fletëparaqitja është tërhequr dhe miratohet konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

Procedura administrative

Neni 19

(1) Në procedurën administrative për fitimin, realizimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale, vendos Enti me akt**vendim**.

(2) Në procedurën administrative Enti vepron në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Për gjithçka që nuk është paraparë me këtë ligj, zbatohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative.

Padi kundër vendimeve të Entit

Neni 20

(1) Aktvendimet e Entit nga neni 19 paragrafi 1 i këtij ligji, janë përfundimtare.

(2) Kundër vendimeve të Entit, pala ka të drejtë të ngritë kontest administrativ.

(3) Kontesti administrativ ngritet me padi në Gjykatën administrative të Republikës së Maqedonisë.

(4) Padia parashtrohet në afat prej 30 ditëve, nga dita e dorëzimit të aktvendimit palës.

Procedimi në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare

Neni 21

Procedurën e cila ka të bëjë me fletëparaqitjet nga neni 17 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, Enti do ta zbatojë në pajtim me dispozitat e këtij ligji

dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

Realizimi i të drejtave përmes të të autorizuarit

Neni 22

(1) Në procedurën para Entit, personat e huaj juridikë dhe fizikë, të drejtat e tyre nga ky ligj i realizojnë përmes të të autorizuarit i cili është i regjistruar për përfaqësim para Entit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk zbatohet në rastet e neneve 48 dhe 86 të këtij ligji.

Qasje te dokumentacioni dhe informatat e Entit

Neni 23

(1) Enti është i detyruar që personave juridikë dhe fizikë të interesuar, t'u mundësojë qasje te dokumentacioni i vet dhe informacionet për të drejtat e paraqitura dhe të pranuar nga pronësia industriale, me përjashtim të atij dokumentacioni i cili nuk është botuar në organin zyrtar të Entit.

(2) Për të drejtat e paraqitura nga pronësia industriale, janë të kapshme vetëm informacionet që gjenden në regjistrin për fletëparaqitje.

(3) Shikim në fletëparaqitje të papublikuar mund të kihet vetëm me leje nga parashtuesi i fletëparaqitjes.

(4) Përmbajtja dhe lloji i informacioneve të cilat kanë të bëjnë me shpikjeet për material mikrobiologjik dhe biologjik, përcaktohen me rregullën të cilën e nxjerr drejtori i Entit, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

(5) Për dokument të shkruar nga dokumentacioni dhe informatat nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe shërbime të tjera që janë në lidhje me mbrojtjen e pronësisë industriale, paguhen shpenzime në pajtim me Tarifën e Entit shtetëror për pronësi industriale.

Taksat dhe shpenzimet

Neni 24

(1) Për fitimin dhe mbajtjen e të drejtave nga pronësia industriale paguhen taksa në pajtim me Ligjin për taksa administrative, si dhe shpenzime të veçanta të procedurës për pranimin e së drejtës.

(2) Lartësinë e shpenzimeve të veçanta të procedurës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe të shpenzimeve për dhënie të shërbimeve të informacionit nga neni 23 paragrafi (5) i këtij ligji, e miraton drejtori i Entit me tarifë për të cilën jep pëlqim Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Nëse taksat për mbajtjen e të drejtave nga ky ligj nuk paguhen në afatet e përcaktuara me këtë ligj, të njëjtat mund të paguhen në afat prej tre

muajsh nga dita e skadimit të atyre afateve, me arkëtim të taksës së rregullt të rritur për 25%, ndërsa mund të paguhet edhe në afat të zgjatur prej gjashtë muajsh nga dita e skadimit të afatit plotësues prej tre muajsh, edhe atë në shumë të dyfishtë.

PJESA E DYTË PATENTA

Lënda e mbrojtjes

Neni 25

(1) Me patentë mbrohet shpikja në të gjitha sferat e teknologjisë, nëse është i rinëse përmban kontribut inventiv dhe nëse mundet të zbatohet në industri.

(2) Nëse janë të plotësuara kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, me patentë mbrohet dhe shpikjaqë ka të bëjë me:

-prodhimin që përbëhet ose përmban material biologjik dhe

-procedurën për fitimin e materialit biologjik, përpunimin ose përdorimin e tij.

(3) Nuk llogaritet për shpikje sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni:

1) shpikja, teoria shkencore dhe metoda matematikore;

2) krijimi estetik;

3) plani, rregulla dhe procedura për kryerjen e veprimtarisë intelektuale, për lojëra ose për kryerjen e aktiviteteve afariste ose të biznesit, si dhe programi kompjuterik;

4) paraqitja e i informacioneve dhe

5) trupi i njeriut në faza të ndryshme të formimit dhe të dhe zhvillimit të tij, ose shpikjeshpikjei i thjeshtë të njërit nga elementet e tij, duke përfshirë sekuencë ose sekuencë të pjesëshme të gjenit.

(4) Përrjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni është i mundur nëse fletëparaqitja për patentë, nuk ka të bëjë me ndonjërin nga ato lëndë, vetvetiu.

(5) Elementi i izoluar nga trupi i njeriut ose i prodhuar përmes procesit teknik, i cili përmban sekuencë ose sekuencë të pjesëshme të gjenit, mundet të mbrohet me patentë edhe atëherë kur struktura e atij elementi është identik me atë të elementit natyror, me ç'rast zbatimi industrial doemos duhet të përmbahet në përshkrimin e shpikjes së përmbajtur në fletëparaqitje.

Përrjashtime nga mbrojtja e patentës

Neni 26

Me patentë nuk mundet të mbrohet shpikja:

-që ka të bëjë me llojet e reja të kafshëve dhe sojeve të bimëve dhe procedurat biologjike të pastra për fitim të kafshëve dhe bimëve, përveç për shpikjet bioteknologjike, shpikjet realizimi teknik i të cilave nuk është i kufizuar në lloj të caktuar, ose nëse bëhet fjalë për procese mikrobiologjike dhe për prodhime të fituara nga ato procese;

- për procedurë kirurgjike dhe diagnostike, ose procedurë për trajtim trupt të njeriut ose kafshës së gjallë, me përjashtim të shpikjes që ka të bëjë me prodhimin

veçanërisht materie ose komponime të cilat shërbejnë për zbatimin e njërës nga këto veprime dhe

- zbatimi i së cilës është në kundërshtim me rendin publik ose moralin , me çfarë zbatimi i shpikjes nuk mundet të llogaritet si i tillë veçanërisht për shkak të faktit

se është e ndaluar me ligj, veçanërisht shpikjet që kanë të bëjnë me: proceset për

klonimin dhe modifikimin e identitetit gjenetik në vijën e trashëgimisë së njeriut, shfrytëzimin e embrioneve të njeriut për qëllime industriale dhe komerciale,

proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve, të cilat me siguri do t'u shkaktjnë vuajtje pa interes të rëndësishëm mjekësor për njeriun ose kafshën

dhe gjithashtu kafshët, që janë rezultat i atyre proceseve.

Risia e shpikjes

Neni 27

(1) Shpikja është e re nëse nuk është epërfshirë me gjendjen e teknikës.

(2) Me gjendje të teknikës nënkuptohet gjithçka që është e kapshme në opinionin botëror, me përshkrimin e shpikjes në formë të shkruar ose gojore, me përdorim ose në çfarëdo mënyre tjetër para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për patentë, në mënyrë që ekspertit nga sfera përkatëse ia mundëson ta zbatojë.

(3) Në gjendjen e teknikës nga paragrafi (2) i këtij neni bëjnë pjesë edhe:

-përmbajtja e fletëparaqitjeve nacionale për patenta, siç janë të parashtruara në Ent, përveç atyre fletëparaqitjeve të patentave të cilat janë hedhur posht, janë tërhequr ose për të cilat është ndërprerë procedura e provimit;

- patentat evropiane për të cilat është kërkuar mbrojtje në territorin e Republikës e Maqedonisë, ashtu siç i ka njohur dhe botuar EEP-ja, në pajtim me

KEP-në dhe marrëveshjen për zgjerim dhe

- fletëparaqitjet ndërkombëtare, të parashtruara sipas MBP-së, të dorëzuar deri te Enti si institucion i zgjedhur.

(4) Dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, nuk do të paraqesin përjashtim nga patentibiliteti, për cilëndo materie ose komponim të përfshirë me gjendjen e teknikës, nëse të njëjtat doemos duhet të përdoren në metodën ose trajnim nga nenit 26 alineja 2 i këtij ligji, nëse përdorimi i atillë nuk është i përmbajtur në gjendjen e teknikës.

Zbulimi i shpikjesshpikjeshpikje pa pasoja juridike

Neni 28

(1) Gjatë vlerësimit nëse shpikja e paraqitur është e re sipas nenit 27 të këtij ligji, nuk do të ndikojë fakti se shpikja është bërë e kapshme për opinionin para skadimit të gjashtë muajve nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes, në mënyrën si vijon:

- me keqpërdorim të hapur ndaj parashtruesit ose të pararendësit të tij juridik ose

- me ekspozimin e shpikjes në ekspozitë zyrtare ose ekspozitë të njohur zyrtarisht, në pajtim me Konventën për ekspozita ndërkombëtare nga parashtruesi ose nga pararendësi i tij juridik.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) alineja 2 e këtij neni, zbatohet vetëm nëse parashtruesi gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes, thirret në faktin se shpikjaka qenë e ekspozuar, dhe me atë rast paraqet dëshmi me shkrim, të lëshuar nga institucioni i autorizuar i vendit në të cilin ka qenë i ekspozuar.

Kontributi inventiv

Neni 29

(1) Shpikja përmban kontribut inventiv, nëse për ekspertin e asaj sfere, lënda e shpikjes, është e qartë që nuk rrjedh nga gjendja teknike e përmbajtur në nenin 27 paragrafi (2) i këtij ligji.

Zbatimi industrial

Neni 30

Shpikja do të llogaritet si e zbatueshme në industri, nëse lënda e mbrojtjes mund të prodhohet ose përdoret, në cilëndo degë të industrisë duke përfshirë edhe bujqësinë.

Subjektet e të drejtës së patentës

Neni 31

(1) Procedurë për njohjen e të drejtës së patentës mund të ngritë shpikësi dhe trashëgimtari i tij juridik.

(2) Nëse shpikja është prodhim i punës së përbashkët të më shumë shpikësve, atëherë e drejta e ngritjes së procedurës për pranimin e të drejtës së patentës, u takon të gjithë shpikësve ose trashëgimtarëve të tyre juridikë.

Shpikësi

Neni 32

(1) Shpikës është personi fizik i cili e ka bërë shpikjen me punën e tij shpikëse.

(2) Nuk llogaritet si shpikës, ai i cili për krijimin e shpikjes ka dhënë vetëm ndihmë teknike.

Trashëgimtari juridik i shpikësit

Neni 33

(1) Trashëgimtari juridik i shpikësit është personi juridik ose fizik, njohja e të drejtës së patentës të të cilit bazohet në ligj, punë juridike, trashëgimi dhe vendim gjyqësor.

(2) Punëdhënësi llogaritet si trashëgimtar juridik i shpikësit, kur në bazë të ligjit ose marrëveshjes për punë, i takon e drejta e fitimit të patentës për shpikje, të krijuar në kuadër të marrëdhënies së punës së shpikësit.

Ngritja e procedurës

Neni 34

(1) Procedura për pranimin e patentës, ngrihet me paraqitjen e fletëparaqitjes së patentës te Enti.

(2) Procedura për pranim të patentës, mund të ngrihet edhe me parashtrimin e fletëparaqitjeve në përputhje me MBP-në, Marrëveshjen për zgjerim dhe KEP-në.

Unikati i shpikjes

Neni 35

(1) Për secilën shpikje parashtrohet fletëparaqitje e veçantë.

(2) Një fletëparaqitje e patentës mund të përmbajë edhe më shumë shpikje, të cilat janë ndërmjet veti të lidhura, që përbëjnë një mendim unik shpikës.

(3) Përmbajtja e fletëparaqitjes për shpikjet të cilat e plotësojnë kushtin për unikat të shpikjes, vërtetohet me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

E drejta e përparësisë

Neni 36

(1) Nga dita e pranimit të fletëparaqitjes së rregullt të patentës në Ent, parashtruesi i fletëparaqitjes të patentës ka të drejtë të përparësisë ndaj secilit person tjetër, i cili për të njëjtën shpikje më vonë do të paraqesë fletëparaqitje.

(2) Përjashtim nga paragrafi (1) i këtij ligji, është atëherë kur plotësohen kushtet për pranimin e të drejtës së përparësisë së unionit dhe panairit, të parapara me nenet 37 dhe 38 nga ky ligj.

E drejta e përparësisë së panairit

Neni 37

(1) Personi i cili në ekspozitën e pranuar zyrtarisht ose në panair me karakter ndërkombëtarë në Republikën e Maqedonisë, ose në ndonjë shtet anëtar të Unionit të Parisit ose OBT-së ekspozon shpikje, mundet në afat prej 90 ditëve nga dita e mbylljes së ekspozitës (panairit), me fletëparaqitje të kërkojë të drejtë të përparësisë nga dita e parë e ekspozimit, gjegjësisht nga dita e përdorimit.

(2) Fletëparaqitjes nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet t'i bashkëngjitet vërtetimi me shkrim nga organi kompetent i vendit anëtar të Unionit të Parisit ose të OBT-së, se bëhet fjalë për ekspozitë (panair) e pranuar zyrtarisht sipas Konventës për ekspozita ndërkombëtare, me shënimin e të dhënave për llojin e ekspozitës ose panairit, vendi e mbajtjes së tij, ditën hapjes dhe ditën e mbylljes, gjegjësisht për ditën e përdorimit.

(3) Me pranimin e të drejtës së përparësisë nga ky nen, nuk zgjaten afatet nga neni 38 të këtij ligji.

E drejta e përparësisë të Unionit

Neni 38

(1) Personit juridik ose fizik i cili në ndonjërin nga vendet anëtare të Unionit të Parisit ose të OBT-së ka dorëzuar fletëparaqitje të rregullt për patentë, do t'i pranohet e drejta e përparësisë në Republikën e Maqedonisë, nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë nëse atë e kërkon në afat prej 12 muajve nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë.

(2) Për fletëparaqitje të rregullt nga paragrafi (1) i këtij, neni llogaritet fletëparaqitja e data e parashtrimit të së cilës është përcaktuar në pajtim me legjislacioni nacional të vendit anëtar të Unionit të Parisit, ose të OBT-së në të cilën është parashtruar, ose në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura mes vendeve anëtare të Unionit të Parisit, pa marrë parasysh fatin e mëvonshëm juridik të fletëparaqitjes.

Obligimet e parashtruesit të fletëparaqitjes patentë me përparësinë e Unionit

Neni 39

Parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës i cili ka për qëllim që ta shfrytëzojë të drejtën e përparësisë nga neni 38 i këtij ligji, është i obliguar që në fletëparaqitjen e parashtruar në Republikën e Maqedonisë t'i paraqesë të gjitha të dhënat për fletëparaqitjen në të cilën thirret dhe në afat prej 90 ditëve nga dita e dorëzimit të fletëparaqitjes, të paraqesë dokument për përparësinë, të vërtetuar nga organi kompetent i vendit anëtar i Unionit të Parisit ose të OBT-së, në të cilin është dorëzuar fletëparaqitja e parë.

E drejta e shumëfishtë e përparësisë

Neni 40

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës mundet në kërkesën për pranim, të thirret në të drejtë të shumëfishtë të përparësisë, në bazë të më tepër fletëparaqitjeve paraprakisht të paraqitura në një ose më shumë vende anëtare të Unionit të Parisit ose të OBT-së.

(2) Nëse parashtruesi thirret në të drejtën e shumëfishtë të përparësisë, afatet sipas këtij ligji rrjedhin nga data e të drejtës së pranuar të përparësisë, duke llogaritur nga data më e hershme e së drejtës së shumëfishtë të përparësisë.

Përfshirja e së drejtës së kërkuar të përparësisë

Neni 41

(1) Kërkesa për pranim të së drejtës të përparësisë i përfshin vetëm ato elemente nga fletëparaqitja të cilat janë të përmbajtura në fletëparaqitjen e parë, ose fletëparaqitjet e para, në bazë të së cilave parashtruesi i fletëparaqitjes thirret në të drejtën e përparësisë.

(2) Nëse në kërkesën e patentës, të theksuar në fletëparaqitjen e parë, nuk janë dhënë disa nga karakteristikat e shpikjes për të cilin është kërkuar e drejta e përparësisë, për pranimin e të drejtës së përparësisë, është e mjaftueshme që të gjitha pjesët tjera nga fletëparaqitja, në detale t'i zbulojnë ato karakteristika.

Certifikata për të drejtën e përparësisë

Neni 42

(1) Enti, me kërkesë të parashtruesit të fletëparaqitjes, jep vërtetim për të drejtën e përparësisë, e cila llogaritet nga data e përcaktuar si datë e parashtrimi të fletëparaqitjes së patentës.

(2) Përmbajtja e kërkesës dhe e vërtetimit për të drejtën e përparësisë, vërtetohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Përmbajtja e të drejtës të patentës

Neni 43

(1) Fletëparaqitja e patentës doemos duhet të përmbajë:

- 1) kërkesë për pranimin e patentës;
- 2) përshkrim të shpikjes;
- 3) një ose më shumë kërkesa për patentë;
- 4) përmbajtje të shkurtër të thelbit të shpikjes (abstrakt);
- 5) projekt (nëse nevojitet) në të cilin thirret përshkrimi dhe kërkesa e patentës;
- 6) provë për taksë të paguar për paraqitje dhe
- 7) përkthim në gjuhën maqedonase nëse fletëparaqitja është parashtruar në gjuhë të huaj.

(2) Me fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohen dhe pjesë dhe shtesa tjera.

(3) Përmbajtja dhe forma e fletëparaqitjes dhe pjesëve dhe shtesave tjera të fletëparaqitjes, në më detajisht përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Përmbajtja e kërkesës për pranimin e patentës

Neni 44

(1) Kërkesa për pranimin e patentës doemos duhet të përmbajë:

- shenjë të qartë se kërkohet pranimi i patentës;
- emrin e shpikjes i cili e pasqyron thelbin e shpikjes dhe
- të dhënat për parashtruesin e fletëparaqitjen dhe për shpikësin.

(2) Deklaratë me shkrim se shpikësi nuk do të jetë i përmendur në fletëparaqitjen, doemos të parashtrohet në Ent në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes.

Përshkrimi i shpikjes

Neni 45

Përshkrimi i shpikjes duhet të jetë i qartë dhe preciz, ashtu që eksperti nga sfera e përcaktuar profesionale do të mund ta zbatojë.

Kërkesa të patentave

Neni 46

(1) Me kërkesë të patentave përcaktohet lënda për të cilën kërkohet mbrojtje.

(2) Kërkesat e patentave duhet të jenë të qarta dhe në tërësi të përmbajtura në përshkrimin e shpikjes.

(3) Kërkesat e patentave mund të jenë të pavarura dhe të varura.

(4) Kërkesat e patentave të pavarura përmbajnë, karakteristika të rëndësishme dhe të reja të shpikjes.

(5) Kërkesat e patentave të varura i përmbajnë karakteristikat specifike, të përcaktuara me ndonjë kërkesë të pavarur ose kërkesë të varur të patentës.

Abstrakti

Neni 47

(1) Abstrakti është përmbajtje e shkurtër e esencës së shpikjes, me dedikim të posaçëm që të japë informata teknike për shpikjen.

(2) Abstrakti nuk mund të shfrytëzohet për nevojat e përcaktimit të vëllimit të mbrojtjes së kërkuar.

Data e parashtrimit

Neni 48

(1) Enti do ta përcaktojë datën e parashtrimit të fletëparaqitjes së patentës, nëse fletëparaqitja në atë datë përmban:

1) shenjë të qartë se kërkohet pranimi i patentës;

2) të dhëna për parashtruesin e fletëparaqitjes, emrin dhe vendbanimin, gjegjësisht selinë; dhe

3) pjesë e cila mund të llogaritet si përshkrim i shpikjes.

(2) Për nevojat e përcaktimit të datës së parashtrimit, personat e huaj juridikë dhe fizikë mund ta parashtrojnë fletëparaqitjen dhe t'i ndërmarrin veprimet në lidhje me përcaktimin e datës së parashtrimit pa përfaqësues, nëse caktojnë adresë për korrespondencë në Republikën e Maqedonisë.

(3) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk do të zbatohen në fletëparaqitjet për të cilat me marrëveshje ndërkombëtare ose me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.

Përcaktimi i datës së fletëparaqitjes së parashtrimit

Neni 49

(1) Nëse fletëparaqitja nuk e ka përmbajtjen e paraparë nga neni 48 i këtij ligji, Enti do ta lajmërojë parashtruesin se fletëparaqitja e tij nuk është e rregullt dhe nuk do t'i pranohet data e parashtrimit.

(2) Enti do ta thërrasë parashtruesin në afat prej 60 ditëve nga pranimi i thirrjes, që t'i mënjanojë mangësitë e konfirmuara në pajtim me paragrafin (1) të këtij ligji.

(3) Nëse parashtruesi i mënjanon mangësitë në afatin e përcaktuar, Enti do ta përcaktojë datën e parashtrimit të fletëparaqitjes.

(4) Si datë e parashtrimit do të konsiderohet data e pranimit të fletëparaqitjes së rregullt, sipas së cilës ka vepruar parashtruesi i fletëparaqitjes në pajtim me njoftimin, sipas nenit 48 nga ky ligj.

(5) Nëse parashtruesi në afat nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk do t'i mënjanojë mangësitë, do të konsiderohet se fletëparaqitja është tërhequr dhe do të merret konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

Ndryshimet në fletëparaqitjen e patentës të cilat nuk janë të lejuara

Neni 50

Fletëparaqitja e patentës në të cilën është përcaktuar data e parashtrimit, nuk mund të ndryshojë në mënyrë plotësuese, me zgjerimin e lëndës për të cilin kërkohet mbrojtje.

Regjistri i fletëparaqitjeve të patentave

Neni 51

(1) Fletëparaqitja e patentës evidentohet në Regjistrin e fletëparaqitjeve të patentave.

(2) Përmbajta dhe mënyra e udhëheqjes së Regjistrit të fletëparaqitjeve të patentave dhe të ekstraktit nga Regjistri, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Deklarimi për mënyrën e zbatimit të procedurës së kontrollimit

Neni 52

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës nga neni 43 i këtij ligji, duhet në kërkesën për pranimin e së drejtës së patentës, të deklarojë se procedura e provimit do të zbatohet si:

1) kontroll i plotë në institucionet nga neni 63 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji;

2) kontroll i plotë në institucionet nga neni 63 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji dhe;

3) kontroll i zbatuar në Ent.

(2) Nëse parashtruesi nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni është i obliguar që të shprehet në afat prej 6 muajve nga data e vërtetuar sikur datë e parashtruesit të fletëparaqitjes deri te Enti.

Ndarja e të drejtës së patentës

Neni 53

(1) Parashtruesi mund ta ndajë lëndën e fletëparaqitjes së patentës të cilës i është vërtetuar data e parashtrimit (fletëparaqitja fillestare) të dy ose

më shumë fletëparaqitje dhe në bazë të secilës prej tyre, të vazhdojë me procedurë të veçantë.

(2) Ndarja e fletëparaqitjes së patentës, është e lejuar deri në miratimin e aktvendimit për pranimin e të drejtës për patentë.

(3) Fletëparaqitja e patentës e krijuar me ndarje të fletëparaqitjes fillestare të patentës (fletëparaqitje e ndarë), e mban datën e parashtrimit të fletëparaqitjes fillestare dhe përparësinë nga fletëparaqitja fillestare e patentës.

(4) Përmbajtja dhe forma të fletëparaqitjes së ndarë përcaktohet me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Kontrolli formal i fletëparaqitjes

Neni 54

(1) Pas regjistrimit të fletëparaqitjes së patentës në Regjistrin e fletëparaqitjeve të patentave, Enti kontrollon:

1) a është e paguar taksa e duhur;

2) a është parashtruar përkthim i fletëparaqitjes në gjuhën maqedonase, nëse fletëparaqitja është në gjuhë të huaj;

3) a është deklaruar parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës, për zbatimin e procedurës së kontrollit nga neni 52 i këtij ligji;

4) a janë dorëzuar projektet nga neni 43 paragrafi (1) pika 5) nga ky ligj, dhe

5) a është parashtruar autorizim i rregullt, nëse fletëparaqitja është parashtruar me anë të ndërmjetësuesit;

(2) Nëse fletëparaqitja e patentës nuk i përmban pjesët nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti do ta thërrasë parashtruesin e fletëparaqitjes në afat i cili nuk mund të jetë më gjatë se 60 ditë, duke llogaritur nga dita e pranimit të thirrjes që t'i largojë mangësitë e vërtetuara.

(3) Me kërkesën e arsyetuar të parashtruesit të fletëparaqitjes, afati nga paragrafi (2) i këtij neni, mundet për shkaqe të arsyeshme të vazhdohet i më së shumti 60 ditë.

(4) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e caktuar nuk i largon mangësitë nga paragrafi (2) të këtij neni, Enti me aktvendim e hedh poshtë fletëparaqitjen.

(5) Kur në fletëparaqitje thirret në projekte që nuk janë të përmbajtura në fletëparaqitje, Enti e thirr parashtruesin e fletëparaqitjes që t'i dorëzojë projektet në afatin e paraparë.

(6) Nëse parashtruesi nuk vepron sipas njoftimit të Entit nga paragrafi (5) i këtij neni, gjatë kontrollimit të fletëparaqitjes do të konsiderohet se projektet nuk ekzistojnë.

(7) Nëse parashtruesi në afatin e përcaktuar e rregullon fletëparaqitjen, do të konsiderohet se fletëparaqitja ka qenë e parashtruar në rregull.

Kërkesë që fletëparaqitja të merret në procedurë menjëherë

Neni 55

(1) Në rast kontesti në lidhje më të drejtën nga fletëparaqitja, parashtruesi i fletëparaqitjes mund të kërkojë që Enti ta marrë menjëherë fletëparaqitjen në procedurë.

(2) Kërkesë që fletëparaqitja të merret në procedurë menjëherë, nuk mund të parashtrohet para skadimit të 12 muajve, nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së patentës.

(3) Parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës, patjetër duhet në rast kontesti nga paragrafi (1) i këtij neni, të paraqesë dëshmi nga kontrolli i plotë i zbatuar në një nga institucion nga neni 63 i këtij ligji.

Kontrollimi i fletëparaqitjes në procedurë para Entit

Neni 56

(1) Gjatë kontrollit të fletëparaqitjes së patentës, Enti kontrollon:

1) a është shënuar shpikësi;

2) a është kërkuar njohje e së drejtës së përparësisë, në pajtim me nenet 37 dhe 38 të këtij ligji;

3) a është fletëparaqitja në pajtim me rregullën e unikatit të shpikjes, të paraparë në nenin 35 të këtij ligji;

4) a janë pjesët e veçanta të fletëparaqitjes, në pajtim me nenet 43, 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji dhe

5) a është lënda e fletëparaqitjes shpikje, e cila në shikim të parë mund të mbrohet me patentë, sipas nenit 25 paragrafi (3), nenit 26 nenit 27 paragrafi (3) dhe nenit 30 të këtij ligji.

(2) Në procedurën e kontrollit të fletëparaqitjes, Enti nuk kontrollon a është plotësuar kushti nga neni 29 i këtij ligji.

Mangësitë e fletëparaqitjes

Neni 57

(1) Enti me shkresë do ta njoftojë parashtruesin e fletëparaqitjes, nëse pas kontrollimit vërtetohet se nuk janë plotësuar kërkesat nga neni 56 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, dhe 4 nga ky ligj, dhe do ta thirrë që në afat prej 60 ditësh nga pranimi i njoftimit t'i mënjanojë mangësitë e përcaktuara.

(2) Në bazë të kërkesës së arsyetuar të parashtruesit të fletëparaqitjes, Enti mund ta vazhdojë afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, më së shumti për 60 ditë.

(3) Enti merr aktvendim për hedhje poshtë të fletëparaqitjes së patentës, nëse parashtruesi në afatin e përcaktuar nuk i mënjanon mangësitë nga njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni.

Aktvendimi për refuzimin e fletëparaqitjes së patentës

Neni 58

(1) Enti merr aktvendim për refuzim të fletëparaqitjes së patentës, nëse fletëparaqitja është parashtruar për shpikje, e cila nuk mund të mbrohet me patentë sipas nenit 56 paragrafi (1) pika 5) të këtij ligji.

(2) Aktvendim për refuzim të fletëparaqitjes së patentës, Enti nuk mund të miratojë nëse paraprakisht me shkrim nuk e ka njoftuar parashtruesin e fletëparaqitjes, për shkaqet për të cilat nuk mund të pranohet e drejta e kërkuar, edhe pse nuk e ka thirrë parashtruesin që në afat të arsyeshëm të deklarohet për ato shkaqe.

(3) Afati nga paragrafi (2) i këtij neni mundet me kërkesë të arsyetuar të parashtruesit të fletëparaqitjes, të vazhdohet deri në gjashtë muaj.

Pagesa e shpenzimeve dhe taksave

Neni 59

(1) Nëse në procedurën e kontrollit të fletëparaqitjes, Enti vërteton se janë plotësuar kërkesat dhe kushtet nga neni 56 i këtij ligji, do ta njoftojë parashtruesin dhe do ta thirrë që në afat prej 30 ditësh t'i paguajë shpenzimet për shpalljen e patentës në organin e Entit, shpenzimet për dhënie të dokumentit dhe taksën për mbajtje në vlefshmëri.

(2) Nëse parashtruesi nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti do të marrë aktvendim për refuzim të fletëparaqitjes.

Aktvendimi për pranimin e patentës

Neni 60

(1) Nëse janë plotësuar kushtet nga neni 56 dhe nëse parashtruesi i kërkesës në afatin e caktuar i paguan shpenzimet dhe taksat nga neni 59 paragrafi (1) i këtij ligji, Enti do të miratojë aktvendim për njohje të patentës.

(2) Të dhënat nga aktvendimi për njohje të patentës, shënohen në regjistrin e patentave në ditën e miratimit të aktvendimit, dhe publikohen në organin zyrtar të Entit në afat prej 90 ditëve nga dita e miratimit.

Kontrolli i fletëparaqitjes në bazë të kontrollit të plotë

Neni 61

(1) Në fletëparaqitjet për të cilat parashtruesi është deklaruar për zbatimin e procedurës për kontroll të plotë, zbatohen dispozitat nga nenet 54, 55, dhe 56 paragrafi (1) pikat nga 1), 2), 3), dhe 4) të këtij Ligji.

Dëshmia dhe procedura pas dëshmisë nga kontrolli i plotë

Neni 62

(1) Parashtruesi i kërkesës së patentës i cili është deklaruar për zbatimin e procedurës në pajtim me nenin 52 paragrafi (1) pikat 1), 2), të këtij ligji, më së voni deri në skadimin e dy viteve nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes së patentës në Ent, duhet të parashtrojë kërkesë për kontroll të plotë në një nga institucionet për kontroll nga neni 63 të këtij Ligji.

(2) Një ekzemplar nga kërkesa e parashtruar, personi nga paragrafi (1) i këtij neni e dorëzon në Ent.

(3) Parashtruesi i fletëparaqitjes nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që në afat prej gjashtë muajve nga data kur e ka marrë dëshminë nga kontrolli nga neni 64 i këtij ligji, në Ent ta dorëzojë dëshminë dhe përkthimin e dëshmisë në gjuhën maqedonase.

(4) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës nuk vepron në pajtim me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, Enti do të miratojë aktvendim për hedhje poshtë të fletëparaqitjes.

(5) Enti nuk mund të miratojë aktvendim nga paragrafi (4) i këtij neni, nëse paraprakishtme shkrim nuk e ka njoftuar parashtruesin e fletëparaqitjes, për shkaqet për të cilat hidhet poshtë fletëparaqitja, dhe nëse paraprakisht e ka thirrë në afat të arsyeshëm të deklarohet për ato shkaqe.

(6) Parashtruesi i fletëparaqitjes së patentës ose bartësi i të drejtës ekskluzive, është i obliguar që ta parashtrojë dëshminë nga kontrolli i plotë, edhe kur personi i tretë padit për shkak cenimit të së drejtës së patentës.

(7) Në rast nga paragrafi (6) i këtij neni, Enti në procedurë urgjente do të lëshojë njërin nga aktvendimet nga neni 66 i këtij ligji.

(8) Përmbajtja e dëshmisë nga kontrolli i plotë, përcaktohet me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Institucionet për kontroll të plotë

Neni 63

(1) Kontrolli i plotë i fletëparaqitjes së patentës nga neni 64 i këtij Ligji, zbatohet në:

1) njërin nga institucionet e zgjedhura të cilat sipas rregullës janë ente shtetërore dhe ndërshtetërore, të cilat në bazë të MBP-së kanë status të institucioneve të autorizuara për kërkim ndërkombëtar, gjegjësisht kontroll paraprak ndërkombëtar të fletëparaqitjeve ndërkombëtare të patentave, dhe

2) ndonjërin nga institucionet me të cilin është lidhur marrëveshje e veçantë, për kërkim dhe kontroll të plotë.

Përmbajtja e dëshmisë nga kontrolli i plotë

Neni 64

(1) Me dëshminë nga kontrolli i plotë, përcaktohet nëse shpikja i plotëson të gjitha kushtet për pranimin e të drejtës së patentës, gjegjësisht lënda e fletëparaqitjes a është:

-shpikje e cila mund të mbrohet me patentë, në pajtim me nenet 25 dhe 26 nga ky ligj;

-shpikje e cila është e përshkruar në mënyrë që eksperti nga lëmi, mund ta zbatojë në pajtim me nenin 27 paragrafi (2) nga ky ligj;

-shpikje e cila është në pajtim me rregullën për unikatin e shpikjes, nga neni 35 i këtij ligji dhe

-shpikje e cila është e re në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të këtij ligji, e cila ka kontribut inventiv në pajtim me nenin 29 të këtij ligji, dhe e cila është e zbatueshme në industri në pajtim me nenin 30 të këtij ligji.

Kontrollimi plotësues

Neni 65

(1) Enti miraton aktvendim nga neni 66 i këtij ligji, në bazë të dëshmive të parashtruara nga kontrolli i plotë nga neni 64 të këtij ligji, dhe në bazë të kontrolleve plotësuese nga ky nen.

(2) Me kontrollin plotësues të fletëparaqitjes së patentës, konfirmohet se a janë përmbushur kushtet për praninë, gjegjësisht lënda e fletëparaqitjes a është në pajtim me nenin 56 paragrafi (1) pika 5 të këtij ligji.

(3) Aktvendim nga neni 66 paragrafi (1) pika 2) ose 3) të këtij ligji, Enti nuk mund të miratojë nëse paraprakisht me shkrim nuk e ka njoftuar parashtruesin e fletëparaqitjes për shkaqet për të cilat nuk mund ta pranojë të drejtën e kërkuarë tërësi ose pjesërisht, dhe nëse paraprakisht nuk e ka thirrë në afat të caktuar të deklarohet për ato shkaqe.

(4) Afati nga paragrafi (3) i këtij neni mundet me kërkesë të arsyetuar të parashtruesit të fletëparaqitjes, të vazhdohet deri në gjashtë muaj.

Aktvendimet në bazë të dëshmisë nga kontrolli i plotë

Neni 66

(1) Në bazë të dëshmisë së parashtruar, Enti vërteton në çfarë mase përmbajtja dhe vëllimi i kërkesës së patentës për shpikjen përkatëse, i plotëson kushtet nga nenet 27, 29 dhe 30 të këtij ligji dhe do të lëshojë njërin nga aktvendimet si vijojnë:

1) aktvendim se shpikja sipas patentës së kërkuar, i plotëson të gjitha kushtet nga nenet 27, 29 dhe 30 të këtij ligji, dhe se atyre kushteve në tërësi u përgjigjen kërkesa e patentës ose kërkesat për patenta;

2) aktvendim se shpikja vetëm pjesërisht i plotëson kushtet nga nenet 27, 29, dhe 30 të këtij ligji, dhe me çfarë jepet vlefshmëri e kufizuar e mëtejshme e kërkesës së patentës ose kërkesave të patentave në masë në të cilën i plotëson kushtet dhe

3) aktvendim për shpallje të pavlefshmërisë kur shpikja nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së patentës, nuk i plotëson kushtet nga nenet 27, 29 dhe 30 të këtij ligji.

Regjistri i patentave

Neni 67

(1) Të dhënat nga aktvendimi për pranimin e të drejtës për patentë, me datën dhe numrin e shpalljes së këtij aktvendimi, regjistrohen në Regjistrin e patentave të cilin e mban Enti.

(2) Të dhënat nga aktvendimi për hedhjen poshtë të fletëparaqitjes dhe refuzimin e kërkesës për pranimin e patentës, regjistrohen në Regjistrin e fletëparaqitjeve të patentave.

(3) Përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrit të patentëve dhe të ekstraktit të regjistrave, përcaktohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Regjistrimi i ndryshimeve në Regjistër

Neni 68

(1) Në regjistrin e fletëparaqitjeve të patentëve dhe në regjistrin e patentëve, regjistrohen ndryshimet të cilat kanë të bëjnë me bartësin e fletëparaqitjes, bartësin e së drejtës dhe vetë të drejtën.

(2) Ndryshimet të cilat regjistrohen në regjistrin e patentëve, shpallen në gazetën zyrtare të Entit

(3) Ndryshimet të cilat regjistrohen, përmbajtja, forma e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e ndryshimeve, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Shpallja

Neni 69

(1) Të dhënat nga aktvendimi për pranimin e patentës, shpallen në organin zyrtar të entit, më së voni në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit.

(2) Bashkë me të dhënat nga aktvendimi i lëshuar në pajtim me nenin 60 të këtij ligji, shpallet dhe abstrakti i shpikjes.(3) Me të dhënat e aktvendimit të lëshuar në pajtim me nenin 66 të këtij ligji, shpallet kërkesa e parë për patentë dhe theksohet numri i kërkesave tjera të patentës.

(4) Përmbajtja e të dhënave të patentës së pranuar të cilat shpallen në organin zyrtar të Entit, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Dokumenti për patentë

Neni 70

(1) Enti bartësit të së drejtës për patentë i jep dokument për patentë, më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të aktvendimit për pranimin e së drejtës për patentë.

(2) Me kërkesën e bartësit të patentës, Enti lëshon shkresë për patentë.

(3) Përmbajtja e dokumentit për patentë dhe shkresa e patentës, përcaktohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Patenta sekrete

Neni 71

(1) Fletëparaqitjet për pranimin e patentës që kanë të bëjnë me mbrojtjen, konsiderohen si materiale sekretedhe i dorëzohen ministrit të mbrojtjes.

(2) Nëse ministri i mbrojtjes në procedurën e shqyrtimit të fletëparaqitjes së parashtruar konstaton se shpikja nuk është sekrete, fletëparaqitjen do t'ia parashtojë entit.

(3) Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në procedurën e pranimit të patentës si shpikje sekrete, përveç nëse me dispozitat e këtij ligji nuk është rregulluar ndryshe

(4) Nëse ministri i mbrojtjes në procedurën e shqyrtimit të fletëparaqitjes së parashtruar konfirmon se shpikja nuk është sekrete, fletëparaqitjen do t'ia parashtojë Entit.

(5) Nëse Enti gjatë procedurës së shqyrtimit të fletëparaqitjes vlerëson se bëhet fjalë për shpikje sekrete, fletëparaqitjen do t'ia lëshojë ministrit të mbrojtjes

(6) Nëse ministri i mbrojtjes konfirmon se shpikja ka pushuar të jetë sekrete, tërë lëndën do t'ia dorëzojë Entit

(7) Pas pranimit të lëndës Enti e regjistron patentën në regjistrin për patenta dhe bartësit të patentës i lëshon dokument dhe shkresë për patentë dhe i shpall të dhënat sipas nenit 60 të këtij ligji.

Shfytëzimi i shpikjes sekrete

Neni 72

(1) Ministria e Mbrojtjes ka të drejtë ekskluzive që ta shfrytëzojë shpikjen sekrete dhe të disponojë me atë shpikje.

(2) Për shpikjen sekrete të mbrojtur me patentë, bartësit të së drejtës i takon kompensim i njëhershëm, pa marrë parasysh nëse shpikja shfrytëzohet për nevojat e mbrojtjes dhe në çfarë mase.

(3) Lartësinë e kompensimit nga paragrafi (2) i këtij neni, me marrëveshje e përcaktojnë bartësi i së drejtës dhe ministri i mbrojtjes.

(4) Nëse nuk arrihet marrëveshje, bartësi i së drejtës së patentës sipas rregullave të procedurës jashtëprocesore, mund të kërkojë nga gjykata që ajo të caktojë lartësinë e kompensimit.

Veçoritë e patentës sekrete

Neni 73

- (1) Patenta për shpikje sekrete nuk shpallet.
- (2) Mbrojtje të shpikjes sekrete jashtë vendit, personat juridikë dhe fizikë të vendit mund të kërkojnë vetëm në bazë të miratimit me shkrim të ministrit të mbrojtjes.
- (3) Dispozitat nga nenet 71 dhe 72 të këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen në fletëparaqitjet e patentave, për pranimin e shpikjeve të cilat janë me interes për sigurinë e shtetit.
- (4) Për zgjidhjen e fletëparaqitjeve nga paragrafi (3) i këtij neni, është kompetent ministri i Punëve të Brendshme
- (5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përcakton se cilat shpikje konsiderohen sekrete sipas neneve 71 dhe 73 të këtij ligji, si dhe mënyrën e pranimit të patentës për shpikje të atilla.

Vlefshmëria e patentës

Neni 74

- (1) E drejta e patentës vlen 20 vjet duke llogaritur nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes
- (2) Vlefshmëria e të drejtës së patentës nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të vazhdohet mbi 20 vjet , por jo më tepër se 5 vjet, në rast kur lënda e patentit është produkt mjeksor, produkt për mbrojtjen e bimëve ose procedurat e fitimit të tyre, për të cilat para lëshimit në qarkullim është e nevojshme që të zbatohet procedura administrative juridike për miratim e përcaktuar me ligj..
- (3) E drejta për patentë e fituar në bazë të aktvendimit nga neni 60 i këtij ligji, zgjat 10 vjet nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes.

Certifikata për mbrojtje plotësuese

Neni 75

- (1) Vlefshmëria e të drejtës së patentës nga neni 74 paragrafi 2 i këtij ligji, mund të vazhdohet me dhënien e certifikatës.
- (2) Përmbajtja e kërkesës dhe përbërësve tjerë dhe shtojcave të kërkesës për dhënien e certifikatës për mbrojtjen e produkteve mjekësore dhe certifikatës për mbrojtjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve, më detalisht përcatohen me dispozita të cilat i miraton drejtori i Entit.

Kushtet për dhënien e certifikatës

Neni 76

Certifikata nga neni 75, paragrafi (1) i këtij ligji, lëshohet nëse në ditën e parashtrimit të kërkesës në Republikën e Maqedonisë:

1) ekziston patentë themelore e vlefshme për produktin;
2) produkti është lëshuar në qarkullim në bazë të lejes së dhënë me dispozitat me të cilat rregullohet vënia e barnave në qarkullim, gjegjësisht me dispozitat me të cilat rregullohet vënia e prodhimeve për mbrojtjen e bimëve në qarkullim;

3) produkti nuk ka qenë më parë lëndë e certifikatës ose nuk ekziston certifikatë e lëshuar paraprakisht për produktin e njëjtë si produkt mjekësor, gjegjësisht si produkte për mbrojtjen e bimëve dhe

4) leja nga pika 2) e këtij neni, është leja e parë për vënien e produktit në qarkullim në Republikën e Maqedonisë si produkt mjekësor, gjegjësisht si produktet për mbrojtjen e bimëve.

Lënda e mbrojtjes së certifikatës

Neni 77

(1) Certifikata jepet për produktin e mbrojtur me patentë themelore, për të cilën ekziston leja për vënien në qarkullim, dhe për cilindo përdorim të produktit mjekësor ose produktit për mbrojtjen e bimëve, të lejuar para skadimit të certifikatës.

(2) E drejta për të cilën është dhënë certifikata është identike me të drejtën e patentës bazë dhe i nënshtrohet kufizimeve dhe obligimeve të njëjta si dhe patenta bazë.

Subjektet e së drejtës nga certifikata

Neni 78

(1) Subjekte të së drejtës së certifikatës janë bartësi i patentës bazë ose trashëgimtari i tij juridik.

(2) Nëse ekziston një më tepër bartës të patentës bazë, procedurë për dhënien e certifikatës mund të ngritë përfaqësuesi i përbashkët, ose cilindo nga bartësit me pajtimin paraprakisht të bartësve tjerë ose trashëgimtarëve të tyre juridikë.

Ngritja e procedurës për dhënien e certifikatës

Neni 79

(1) Procedura për dhënien e certifikatit nga neni 75 i këtij ligji, ngritet me parashtrimin e kërkesës për dhënien e certifikatit, Entit.

(2) Kërkesa për dhënien e certifikatit parashtrohet në afat prej gjashtë muajsh nga data kur është dhënë leja e parë për vënien në qarkullim të produktit në Republikën e Maqedonisë, ose në afat prej gjashtë muajsh nga data e pranimit të patentës bazë, nëse leja që të vihet në qarkullim produkti është dhënë para pranimit të patentës bazë.

(3) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet në formularë.

Përmbajtja e kërkesës për dhënien e certifikatës

Neni 80

(1) Kërkesëa për dhënien e certifikatit nga neni 79, paragrafi (1) parashtrohet në formular.

(2) Kërkesës i bashkangjitet leja për vënie në qarkullim të produktit në territorin e Republikës së Maqedonisë, e dhënë nga organi kompetent.

(3) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, i bashkangjiten edhe pjesë dhe shtojca tjera.

(4) Përmbajtja dhe forma e formularit për dhënien e certifikatit, përcaktohen me dispozitë, të cilën e miraton drejtori i Entit.

Shqyrtimi formal i kërkesës për dhënien e certifikatës

Neni 81

(1) Në procedurë për shqyrtim formal Enti kontrollon:

1) nëse kërkesa i përmban pjesët dhe shtojcat nga neni 75, paragrafi (2) i këtij ligji;

2) nëse kërkesa është parashtuar në afatin nga neni 79 paragrafi (2) i këtij ligji dhe

3) nëse janë dorëzuar shtojcat nga neni 80, paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Nëse kërkesa nuk është parashtuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, Enti do ta ftojë parashtuesin në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë, duke llogaritur nga dita e pranimit të ftesës, që t'i mënjanojë mangësitë e e përcaktuara.

(3) Me kërkesë të arsyetuar të parashtuasit të kërkesës, afati nga paragrafi (2) i këtij neni për shkaqe të arsyeshme, mund të vazhdohet më së shumti edhe për 60 ditë.

(4) Nëse parashtuesi i kërkesës në afatin e përcaktuar nuk i mënjanon mangësitë nga paragrafi (2) i këtij neni, Enti merr aktvendim për hedhjen poshtë të kërkesës.

Procedura për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e certifikatës

Neni 82

Në procedurën e shqyrtimit për dhënien e certifikatës, Enti shqyrton nëse në ditën e parashtimit të kërkesës janë plotësuar kushtet për dhënien e certifikatës, të parapara në nenin 76 të këtij ligji.

Miratimi i kërkesës

Neni 83

(1) Nëse Enti konfirmon se janë plotësuar kushtet nga neni 76 i këtij ligji, do ta ftojë parashtruesin që në afat prej 30 ditësh t'i paguajë harxhimet për shpalljen e të dhënave nga certifikata, në organin e Entit dhe taksën për mbajtje në vlefshmëri.

(2) Nëse parashtruesi i kërkesës në afatin e caktuar i paguan harxhimet dhe tatimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti do të lëshojë aktvendim për certifikatë.

(3) Nëse parashtruesi nuk i paguan harxhimet nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti me aktvendim do ta anulojë kërkesën.

Vlefshmëria e certifikatës

Neni 84

(1) Certifikata fillon të jetë e vlefshme pas skadimit të periudhës ligjore të afatit të patentës bazë, për periudhë të njëjtë me kohën që ka kaluar nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes për patentë bazë dhe data e marrjes së lejes për vënien në qarkullim të produktit në Republikën e Maqedonisë, të zvogëluar për pesë vjet.

Refuzimi i kërkesës

Neni 85

(1) Nëse vërtetohet se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në nenin 76 të këtij ligji, ose nëse kërkesa nuk është parashtruar nga personi i paraparë në nenin 78 të këtij ligji, Enti, në formë të shkruar e njofton parashtruesin e kërkesës, për shkaqet për të cilat nuk mund të jepet certifikata dhe e fton që në afat të caktuar i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 6 muaj, të deklarohej për ato shkaqe.

(2) Nëse parashtruesi i kërkesës nuk deklarohej në afatin e caktuar, Enti me aktvendim do ta refuzojë kërkesën.

Pagesa e taksave dhe harxhimeve

Neni 86

(1) Në procedurën për pranimin dhe mbajtjen e së drejtës për patentë, paguhen taksat dhe harxhimet e e procedurës.

(2) Taksat vjetore për mbajtjen në vlefshmëri të së drejtës për patentë dhe të certifikatës, paguhen duke llogaritur nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes për patentë.

(3) Taksa vjetore për mbajtjen e së drejtës për patentë, paguhet deri në fillimin e vitit për të cilin paguhet taksa, gjegjësisht deri në datën e parashtrimit të fletëparaqitjes.

(4) Taksat dhe harxhimet mund t'i paguajë cildo person, pa miratimin e përfaqësuesit.

Shuarja e patentës para skadimit të vlefshmërisë

Neni 87

(1) E drejta e patentës pushon të vlejë para skadimit të afatit të vlefshmërisë, dhe atë në rastet si vijojnë:

1) nëse nuk paguhen taksat e përcaktuara – në ditën vijuese nga dita e lëshimit të afatit për pagesën e taksës;

2) nëse bartësi tërhiqet nga e drejta - në ditën vijuese nga dita e parashtrimit të parashtrësës për tërheqje, Entit;

3) në bazë të vendimit gjyqësor, gjegjësisht aktit të Entit në rastet e parapara me këtë ligj – me ditën e caktuar në atë vendim gjegjësisht në aktin dhe

4) nëse personi juridik i cili është bartës i të drejtës për patentë ka pushuar të punojë – me ditën e shuarjes, gjegjësisht nëse personi fizik i cili është bartës i të drejtës për patentë ka vdekur – nga dita e vdekjes, ose nëse personi i zhdukur i cili është bartës i të drejtës për patentë, është shpallur i vdekur - në ditën e plotfuqishmërisë së aktvendimit, përveç nëse ajo e drejtë ka kaluar te trashëgimtarët juridikë të personit juridik, gjegjësisht te trashëgimtarët e personit fizik.

(2) Enti merr aktvendim për shuarjen e vlefshmërisë së patentës, kur janë krijuar kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Të drejtat e personave të tretë

Neni 88

(1) Nëse në regjistrin e patentave është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër në dobi të personit të tretë, bartësi i patentës nuk mund të heqë dorë nga të drejtat e tij, pa pëlqimin me shkrim nga personi në emër të të cilit është regjistruar licenca, pengu ose e drejta tjetër.

(2) Nëse bartësi i patentës në afatin e caktuar nuk e paguan taksën e përcaktuar, ndërsa në regjistër është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër në dobi të personit të tretë, Enti do ta njoftojë atë person që taksa nuk është paguar dhe se mund ta paguajë në afat prej 6 muajsh, nga dita e njoftimit dhe me këtë ta mbajë të drejtën e regjistruar.

(3) Në rast kontesti për sigurimin e të drejtave të regjistruara për personin e tretë, nëse kjo është e domosdoshme për sigurimin e këtyre të drejtave, gjykata mund të vendosë që e drejta për patentë t'i bartet personit në emrin e të cilit është e regjistruar licenca, pengu ose e drejta tjetër, deri në sigurimin e kërkesave.

Të drejtat ekskluzive

Neni 89

(1) Bartësi i së drejtës ka të drejtë ekskluzive:

1) që ta shfrytëzoj në prodhim shpikjen e mbrojtur;

2) që të lëshojë në qarkullim produkte të përpunuara sipas shpikjes së mbrojtur dhe

3) të disponojë me patentë.

(2) Bartësi i patentës ka të drejtë që t'ua ndalojë shfrytëzimin e shpikjes së mbrojtur, në prodhim ose në qarkullim personave të tretë, të cilët për atë shfrytëzim nuk e kanë lejen e tij, nëse shfrytëzimi i atillë ka të bëjë me përpunimin, ofrimin në shitje, eksportin ose importin dhe depozitimin e produkteve për ato qëllime.

(3) Bartësi i patentës ka të drejtë t'ia ndalojë personit tjetër që pa pëlqimin e tij të ofrojë dhe dërgojë produkte, të cilat paraqesin elemente të rëndësishme të shpikjes, nëse ofruesi dhe dërguesi e kanë ditur ose nga rrethanat e rastit është dashur ta dijnë, që ai produkt është dedikuar për zbatimin e shpikjes së huaj.

(4) E drejta nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, ka të bëjë edhe me patentën për procedurë edhe me produktin e fituar drejtpërdrejt nga ajo procedurë.

Të drejtat e veçanta të patentave nga sfera e bioteknologjisë

Neni 90

(1) E drejta nga neni 89, paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, ka të bëjë me çdo material biologjik me karakteristika specifike, i cili është rezultat i shpikjes dhe përhapet mbi materialin biologjik i cili është nxjerrë nga ai material biologjik, me shumëzim ose multiplikim, në formë identike ose divergjente dhe i përmban karakteristikat e njëjta.

(2) E drejta nga neni 89, paragrafi (4) të këtij ligji, ka të bëjë me procedurën për fitimin e materialit biologjik me karakteristika specifike, të cilat janë rezultat i shpikjes dhe përhapet mbi materialin biologjik të fituar drejtpërdrejt nëpërmjet asaj procedure dhe mbi cilindo material biologjik të nxjerrë nga materiali biologjik me shumëzim ose multiplikim në formë identike ose divergjente dhe i përmban karakteristikat e njëjta.

(3) E drejta nga neni 89 paragrafi (3) i këtij ligji, ka të bëjë edhe me produktin i cili përmban ose përbëhet nga informacionet gjenetike dhe përhapet mbi të gjitha materialin biologjik, në të cilën informacionet gjenetike përmbahen dhe e kryejnë funksionin e vet, përveç mbi materialin nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji.

Shfrytëzimi i lirë

Neni 91

E drejta e bartësit të patentës nga neni 89 i këtij ligji, për shfrytëzim ekskluziv të shpikjes nuk ka të bëjë me:

- 1) shfrytëzimin e shpikjes për qëllime personale dhe komerciale;
- 2) ndërmarrjen e aktiviteteve për hulumtim dhe zhvillim të lëndës së shpikjes së mbrojtur, veçanërisht përpunimin, përdorimin, ofrimin për shitje, importin dhe eksportin e mbrojtur, duke përfshirë edhe aktivitete për fitimin e lejes për vënien në qarkullim të barnave për mjekësi humane dhe veterinare ose mjeteve për mbrojtjen e bimëve dhe

3) përgatitjen e drejpërdrejtë dhe individuale të barit në barnatore, në bazë të recetës individuale mjekësore dhe procedurave që kanë të bëjnë me barin e përgatitur në mënyrë të atillë.

Patenta për procedurë

Neni 92

(1) Nëse patenta është dhënë për procedurë, veprimi i saj shtrihet edhe mbi produktet dhe materiet e fituara drejtpërdrejt me atë procedurë.

(2) Në mungesë të dëshmive të kundërta do të llogaritet që produkti është fituar në procedurë të mbrojtur, dhe atë nëse produkti është i ri ose nëse ekziston dyshim i bazuar se produkti është fituar me procedurë të mbrojtur, dhe se bartësi i patentës nuk ka qenë në gjendje që edhe krahas punës së arsyeshme të dhënë, ta përcaktojë procedurën e cila është shfrytëzuar vërtetë.

(3) Ekziston dyshimi i bazuar sipas paragrafit (2) të këtij neni, se produkti është fituar me procedurë të mbrojtur, nëse procedura e mbrojtur është procedura e vetme e njohur.

(4) Barra e dëshmisë nga paragrafi (1), do të bie mbi kundërvajtësin e theksuar, vetëm nëse është plotësuar njëri nga kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni.

Forma e të drejtës ekskluzive

Neni 93

Sasia e të drejtave ekskluzive të bartësit të patentës është përcaktuar me tekstin e kërkesave për patentë, të cilat përfundimisht janë pranuar në procedurën për pranimin e patentës, me ç'rast përshkrimi dhe vizatimet shërbejnë për interpretimin e kërkesave për patentë.

E drejta në bazë të shfrytëzimit paraprak

Neni 94

(1) E drejta për patentë nuk vepron mbi personin, i cili para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për patentë, ose para datës së të drejtës së pranuar të përparësisë, shpikjen me vetëdije dhe jo publikisht e ka shfrytëzuar në Republikën e Maqedonisë, ose ka përgatitur gjithçka që është e nevojshme për shfrytëzimin e saj.

(2) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni ka të drejtë, pa lejen e bartësit të patentës, të vazhdojë me shfrytëzimin e shpikjes, në sasi në të cilën e ka shfrytëzuar ose përgatitur, deri në datën e parashtrimit të fletëparaqitjes për patentë për shpikjen e kërkuar.

Përrjashtimi nga e cenimi i së drejtës për patentë

Neni 95

Nuk konsiderohet për cenim të të drejtave ekskluzive të bartësit të patentës, nëse lënda eshpikjes ka të bëjë me produktet e përpunuara në bazë të patentës, të përdorura në konstruktimin ose pajisjen e anijeve, aeroplanëve ose automjeteve tokësore, të cilat i takojnë ndonjërit nga vendet e Unionit të Parisit ose të OTB-së, kur ai mjet transportues përkohësisht ose rastësisht do të gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, me kusht që produkti i ndërtuar të shërbejë ekskluzivisht për nevojat e atij mjeti transportues.

Përjashtimi nga cenimi i së drejtës për patentë nga sfera e biteknologjisë

Neni 96

(1) Pesoni i cili e shfrytëzon materialin bimor për shumëzim, në bazë të pëlqimit të bartësit të patentës, nuk e cenon të drejtën nga neni 90 i këtij ligji, që ka të bëjë me shitjen ose me lloj tjetër të eksploatimit komercial të materialit bimor për shumëzim, kur prodhimin e vet të grumbulluar e shfrytëzon për shumëzimin ose multikiplimin e për nevojat e veta dhe për pronën e tij.

(2) Personi i cili e shfrytëzon kafshën ose materialin tjetër reprodutiv të kafshëve në bazë të pëlqimit të bartësit të patentës, nuk e cenon të drejtën nga neni 90 i këtij ligji, e cila ka të bëjë me shitjen ose llojin tjetër të eksploatimit komercial, kur kafshën e mbrojtur e shfrytëzon për aktivitete bujqësore, duke i përfshirë edhe për prodhimin e kafshëve dhe materialit tjetër reprodutiv të kafshëve, për qëllimet e aktivitetit të vet bujqësor, por jo edhe për qëllime reprodutive komerciale.

Dhënia e lisencës së detyrueshme

Neni 97

(1) Nëse bartësi i patentës nuk e shfrytëzon shpikjen e mbrojtur me patentë, ose e shfrytëzon në sasi të pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të tregut vendor, dhe refuzon që të lidhë marrëveshje për licencë ose parashtron kushte jo si të tregut për lidhjen e asaj marrëveshjeje, me licencë të detyrueshme, e drejta e shfrytëzimit të shpikjes mund t'i jepet personit tjetër, me obligim për pagesën e kompensimit, të bartësit të patentës.

(2) Licenca e detyrueshme mund të jepet edhe nëse shfrytëzimi i shpikjes së mbrojtur me patentë është i domosdoshëm, për shkak të gjendjeve të jashtëzakonshme në shtet, mbrojtjes së interesit publik në sferën e shëndetësisë, ushqimit, mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit jetësor, ose është me interes të veçantë për degë të veçantë të ekonomisë, ose është e domosdoshme për zbatimin e procedurës gjyqësore dhe administrative për mbrojtjen e konkurrencës

(3) Lëshimet gjatë dhënies së licencës së detyrueshme nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të mundura nëse bëhet fjalë për gjendjet nga paragrafi (2) i këtij neni, për çfarë në afatin më të shkurtë të mundshëm, njoftohet bartësi i patentës.

(4) Kërkesë për dhënien e licencës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të parashtrohet para skadimit të afatit prej katër vitesh, nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes për patentë, gjegjësisht para skadimit të afatit prej tre vitesh nga dita pranimit të patentës, nëse ky afat skadon më vonë.

(5) Licencë e detyrueshme nuk jepet nëse bartësi i patentës dëshmon që ekzistojnë pengesa ligjore, të cilat e arsyetojnë mosshfrytëzimin ose shfrytëzimin e pamjaftueshëm të shpikjes së mbrojtur me patentë.

(6) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, licenca e detyrueshme mund të jepet edhe para skadimit të afatit nga paragrafi (4) i këtij neni.

Cilësitë e licencës së detyrueshme

Neni 98

(1) Licenca e detyrueshme nuk mund të jetë ekskluzive.

(2) Licenca e detyrueshme ka afat derisa zgjat shkaku për të cilin është dhënë.

(3) Me kërkesë të arsyetuar të personit të interesuar, licenca e detyrueshme do t'i hiqet, nëse pushojnë shkaqet për të cilat është dhënë, ndërsa nuk ekziston mundësia që të njëjtat të shkaktohen përsëri, me kusht që të mbrohen të drejtat legjitime të fituesit të lisencës së detyrueshme.

(4) Licenca e detyrueshme nuk mund të bartet, përveç nëse bartja bëhet bashkë me kapacitetin prodhues gjegjësisht me pjesë të tij në të cilin shfrytëzohet shpikjeshpikjei për të cilin është dhënë.

(5) Licencë e detyrueshme jepet për plotësimin e nevojave të tregut vendor, përveç nëse në procedurë kontestimore nuk dëshmohet se është në kundërshtim me mbrojtjen e konkurrencës së tregut.

Kompensimi

Neni 99

(1) Në rast të dhënies së licencës së detyrueshme, bartësi i patentës ka të drejtë për kompensim përkatës.

(2) Lartësinë e kompensimit e verifikojnë me marrëveshje bartësi i patentës dhe shfrytëzuesi të cilit i është dhënë licenca, gjegjësisht i cili e shfrytëzon shpikjen e mbrojtur me patentë.

(3) Lartësia nga paragrafi (2) i këtij neni, është adekuate me vlerën ekonomike të licencës dhe nevojën për harmonizim me procedurën për mbrojtje të konkurrencës.

(4) Nëse nuk arrihet marrëveshje për lartësinë e kompensimit nga paragrafi (2) i këtij neni, gjykata kompetente e përcakton lartësinë e kompensimit.

(5) Mosekzistimi i marrëveshjes gjegjësisht vendimit të gjykatës, nuk e pengon shfrytëzuesin të cilit i është dhënë licenca, që ta shfrytëzojë atë shpikje.

Licenca e detyrueshme e patentës së varur

Neni 100

(1) Licencë e detyrueshme mund të jepet edhe nëse shpikja e mbrojtur me patentë, nuk mund të shfrytëzohet në tërësi ose pjesërisht pa shfrytëzimin e shpikjes tjetër të mbrojtur me patentën e mëparëshme, ndërsa shpikja e mëvonshme, e cila paraqet përparim teknik më të rëndësishëm, është me rëndësi të veçantë për ekonominë ose për plotësimin e nevojave të përgjithshme.

(2) Nëse licenca e detyrueshme jepet sipas dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i patentës së mëparëshme mund të kërkojë licencë të detyrueshme, për shfrytëzimin e shpikjes pas patentës së mëvonshme për kompensim adekuat.

Kompetenca për dhënien e licencës së detyrueshme

Neni 101

(1) Për dhënien e licencës së detyrueshme, vendos gjykata e cila është kompetente për zgjidhjen e kontesteve, për të drejtat nga pronësia industriale në procedurë kontestimore

(2) Procedura për dhënien e licencës së detyrueshme, ngritet me padi kundër bartësit të patentës ose certifikatës për mbrojtje plotësuese, e cila përmban kërkesë për dhënien e licencës së detyrueshme

(3) Në procedurën për dhënien e licencës së detyrueshme, bartësi nga paragrafi (2) i këtij neni i cili është i regjistruar në regjistrin e patentëve, konsiderohet se është bartës i patentës.

Licenca e detyrueshme për nevojat e shëndetësisë publike

Neni 102

(1) Gjykata, cilitdo person i cili ka parashtruar kërkesë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund t'i japë licencë të detyrueshme për patentë gjegjësisht certifikatë për mbrojtje plotësuese, për nevojat e prodhimtarisë dhe shitjes së produkteve farmaceutike, kur produkti i tillë është i dedikuar për eksport në vendet importuese me probleme në shëndetësinë publike

(2) Gjatë vendimmarrjes për dhënie të licencës së detyrueshme, gjykata do ta ketë parasysh Vendimin e Këshillit të përgjithshëm të **OTB-së nga 30 gushti 2003**, për zbatimin e pikës 6 nga Deklarata e **Dohës** për **TRIPS** marrëveshjen dhe për shëndetësinë publike nga 14 nëntori 2001, në tekstin e mëtejshëm :Vendimi.

(3) Produkti farmaceutik nga paragrafi (1) i këtij neni, është çdo produkt i industrisë farmaceutike duke përfshirë edhe barnat për përdorim human, me të cilat nënkuptohet çdo substancë ose përzierje substancash, e cila është e dedikuar për mjekimin ose parandalimin e sëmundjeve të njerëzimit, duke përfshirë edhe çdo substancë ose përzierje substancash e cila mund të

përdoret te njerëzit përripërtrirjen, përmirësimin ose përshtatjen e funksioneve të tyre fiziologjike, me nxitjen e veprimeve farmakologjike, imunologjike dhe metabolike, ose dhënie të diagnozës mjekësore, duke përfshirë edhe përbërës aktivë dhe paisje për diagnostifikim jashtë trupit të gjallë të njeriut

Vendi importues

Neni 103

(1) Vend importues nga neni 102, paragrafi (1), është çdo vend në të cilin eksportohen produkte farmaceutike dhe mund të jetë:

1) cilido vend më pak i zhvilluar, i theksuar si i tillë në listën e Kombeve të Bashkuara (KB);

2) cilado anëtare e OTB-së, përveç vendit anëtar më pak të zhvilluar nga pika (1) e këtij paragrafi, e cila ka dërguar njoftim te Këshillit i TRIPS-it, për qëllimin që ta shfrytëzojë sistemin si vend importues, sidoqoftë nëse do ta shfrytëzojë sistemin në atë aspekt në tërësi ose pjesërisht;

3) cilido vend i cili nuk është anëtar i OTB-së, i cili nga ana e kuvendit për ndihmë dhe zhvillim të Organizatës për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik (OECD), është i shënuar në listën e vendeve me të ardhura të ulëta të produktit nacional bruto për banorë, që janë më të vogla se 745\$ dhe për të cilin Ministria e Ekonomisë është e njoftuar se ka për qëllim që ta shfrytëzojë sistemin si vend importues, pa marrë parasysh nëse në këtë mënyrë do ta shfrytëzojë sistemin në tërësi ose pjesërisht..

(2) Vendi anëtar i OTB-së nëse është deklaruar se nuk do ta shfrytëzojë këtë të drejtë, nuk i plotëson kushtet që ta shfrytëzojë sistemin si vend importues.

(3) Vendet importuese të cilat nuk janë anëtare të OTB-së, ndërsa janë vende më pak të zhvilluara dhe vende në zhvillim, dhe i plotësojnë kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet t'i përmbushin kërkesat plotësuese:

1) Vendi importues është i obliguar që t'i dërgojë njoftim drejtpërdrejt Ministrisë së Ekonomisë.

2) Vendi importues është i obliguar që në njoftim të theksojë se sistemin do ta shfrytëzojë për zgjedhjen e problemeve nga shëndetësia publike, por jo si mjet për arritjen e qëllimeve industriale ose tregtare, dhe se do t'i zbatojë masat nga pika 4 e Vendimit .

(4) Gjykata në bazë të padisë nga bartësi i sëë drejtës ose Ministrisë së Ekonomisë, mund ta heqë licencën e detyrueshme nëse vendi importues nuk i respekton obligimet nga paragrafi (3) pika 2) e këtij neni.

Padia për dhënie e licencës së detyrueshme për nevojat e shëndetësisë publike

Neni 104

(1) Padia e cila përmban kërkesë për dhënie të licencës së detyrueshme për nevojat e shëndetësisë publike, i parashtrohet gjykatës në pajtim me nenin 101 të këtij ligji, nëse në territorin e Republikës së

Maqedonisë ekziston patentë ose certifikatë për mbrojtje plotësuese, me të cilat përfshihen punët për prodhim dhe shitje për import.

(2) Parashtruesi i padisë për dhënie të licencës së detyrueshme, është i obliguar që padisë t'i bashkëngjese:

1) kërkesa për dhënie të licencave të detyrueshme në shtete tjera për produkt të njëjtë, me të dhëna për sasinë dhe për vendet importuese;

2) parashtruesi i kërkesës për dhënien e licencës së detyrueshme, e nëse është i caktuar përfaqësuesi, të dhënat për përfaqësuesin e tij;

3) emrin e produktit farmaceutik i cili nuk i nënshtrohet mbrojtjes, të cilin parashtruesi i kërkesës ka për qëllim ta prodhojë, në bazë të licencës së detyrueshme;

4) sasinë e produktit farmaceutik, të cilin parashtruesi i kërkesës ka për qëllim që ta prodhojë në bazë të licencës së detyrueshme;

5) të dhënat për vendin importues;

6) dëshminë për negociatat paraprake me bartësin e të drejtës, në pajtim me dispozitat nga paragrafi (5) i këtij neni dhe;

7) dëshminë për kërkesën e përfaqësuesit të autorizuar të vendit importues ose organizatës joqeveritare, e cila punon me autorizim të një apo më tepër vendeve importuese ose trupave të KB-së, ose organizatës tjetër shëndetësore ndërkombëtare e cila punon me autorizimin e e njëres ose më tepër vendeve importuese, në të cilën është theksuar sasia e produktit të nevojshëm.

Parakushtet për dhënien e licencës së detyrueshme

Neni 105

(1) Licencë e detyrueshme mund të jepet vetëm nëse parashtruesi i kërkesës pa sukses, në periudhë prej tredhjetë ditësh para parashtrimit të padisë, ka tentuar që nga bartësi i së drejtës, të marrë pëlqim për shfrytëzimin shpikjes së mbrojtur, në kushte dhe afate të arsyeshme të tregut.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk zbatohet në rast të gjendjes së nevojshme, ose rrethana tjera të nevojës së skajshme në shtet, ose në rast të përdorimit jokkomercial publik, në pajtim me nenin 31 pika b) nga Marrëveshja e **TRIPS-it**.

Njoftim i bartësit të së drejtës

Neni 106

Gjykatka pa prolongim do ta njoftojë bartësin e së drejtës për kërkesën e parashtruar, për dhënien e licencës së detyrueshme dhe do t'i japë mundësi që të deklarohet.

Veçoritë për dhënien e licencës së detyrueshme për nevojat e shëndetësisë publike

Neni 107

(1) Licenca e detyrueshme nuk mund të jetë e ekskluzive.

(2) Afati dhe vëllimi i licencës së detyrueshme të cilat theksohen në vendimin e gjykatës për dhënie të saj, ekskluzivisht varen nga afati i shkakut për çka është dhënë.

(3) Sasia e produkteve të cilat mund të prodhohen në bazë të licencës së detyrueshme, nuk guxon ta tejkalojë sasinë e duhur për përmbushjen e nevojave të vendit importues, gjegjësisht te vendeve importuese të theksuara në padinë, me ç'rast duke pasur parasysh edhe sasinë e produkteve të prodhuara në vende tjera, në bazë të licencës së detyrueshme.

(4) Licenca e detyrueshme mund të bartet vetëm bashkë me kapacitetin prodhues, gjegjësisht me pjesën e tij në të cilën shfrytëzohet shpikja për të cilin është dhënë.

Kushtet për dhënien e licencës së detyrueshme për nevojat e shëndetësisë publike

Neni 108

(1) Produkti i cili është i prodhuar ose i importuar në bazë të licencës së detyrueshme, nuk guxon të ofrohet për shitje ose të vëhet në treg në vend i cili nuk është theksuar në kërkesë, përveç kur vendi importues, në pajtim me pikën 6, nën-pika (i) nga Vendimi, eksporton në vendin bashkëkontraktues i marrëveshjes rajonale tregtare, me problem të njëjtë në sferën e shëndetësisë.

(2) Paketimi ose çfarëdo teksti përkatës, duhet patjetër të përmbajnë shenjë të qartë se produkti është lëndë e licencës së detyrueshme, emrin e gjykatës e cila e ka dhënë dhe numrin e lëndës, shenjë të qartë se produkti është i dedikuar ekskluzivisht për import dhe distribuim lidhur me vendin importues ose vendet importuese, dhe të dhënat detajore në lidhje me produktin për nevojat e organeve doganore të Republikës së Maqedonisë.

(3) Licencë e detyrueshme jepet për përmbushjen e nevojave të tregut vendor, përveç nëse në procedurë gjyqësore të dhënies, nuk dëshmohet se është në kundërshtim me mbrojtjen e konkurrencës së tregut.

(4) Nëse produkti për të cilin në Republikën e Maqedonisë është dhënë licencë e detyrueshme, është i mbrojtur me patentë në vendin importues të theksuar në kërkesë, produkti mund të eksportohet vetëm nëse ai vend ka dhënë licencë të detyrueshme për import, shitje dhe/ose distribuim të atij produkti.

(5) Kushtet në të cilat është dhënë licenca, nuk ndikojnë në mënyrën e distribuimit në vendin importues.

Procedura për dhënien e licencës së detyrueshme

Neni 109

(1) Gjatë vendosjes për kërkesat për dhënie të licencës së detyrueshme, gjykata kontrollon, nëse:

1) çdo vend importues i theksuar në kërkesë, i cili është anëtar i **OTB-së** i ka dërguar njoftim **OTB-së** në pajtim me Vendimin, gjegjësisht nëse çdo vend i mportues i theksuar i cili nuk është anëtarë i **OTB-së** e ka njoftuar Ministrinë e Ekonomisë, në pajtim me dispozitat e këtij neni, për çdo produkt të kërkesës pavarësisht nga mundësia që e kanë së paku vendet e zhvilluara në pajtim me Vendimin;

2) sasia e produktit të theksuar në kërkesë të mos e tejkalojë atë për të cilën vendi importues si anëtar i **OTB-së**, e ka njoftuar **OTB-në**, gjegjësisht Ministrinë e Ekonomisë;

3) sasia e përgjithshme e produkteve për të cilat është i lejuar prodhimi, në lidhje me cilindo vend importues, në mënyrë të konsiderueshme nuk e tejkalon sasinë për të cilën ai vend i ka dërguar njoftim OTB-së, gjegjësisht Ministrisë së Ekonomisë, duke i marrë parasysh licencat tjera të dhëna të detyrueshme;

(2) Në Vendimin e gjykatës theksohen veprimet për prodhimin e të cilave autorizohet parashtruesi i kërkesës, e të cilat janë të domosdoshme për prodhim, për eksport dhe distribuimin në vendin gjegjësisht në vendet e theksuara në kërkesë.

(3) Në Vendimin e gjykatës urdhërohet që prodhimet të jenë qartë të shënuara me etiketa ose shenja të veçanta, se janë të prodhuara në bazë të licencës së detyrueshme, ashtu që do të dallohen nga ato të cilat i prodhon bartësi i së drejtës dhe atë me paketim të veçantë dhe/ose me ngjyra dhe forma të veçanta, nëse dallimi i tillë është i mundur dhe nuk ka ndikim të madh në çmim.

(4) Gjykata në vendim, e urdhëron pranuesin e licencës që para dërgesës në vendin importues në ueb-faqe të fusë të dhëna për sasinë e produkteve, me të cilat i furnizon vendet importuese me produktet e fituara me licencën e detyrueshme, si dhe për mënyrën dhe llojin e shënimit të atyre produkteve dhe për adresën e asaj faqeje, ta informojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

(5) Gjykata, në bazë të propozimit për sigurimin e dëshmimeve, të parashtruar nga bartësi i të drejtës, mund ta kumtojë masën që të kryhet kontroll në librat punues dhe dokumente tjera për pranim të licencës, veçanërisht për shkak të kontrollit të destinacionit përfundimtar të produktit, me ç'rast librat punues dhe dokumentet doemos duhet të përmbajnë dëshmi për eksportin e produktit, në formë të deklaratës eksportuese të cilën e ka kontrolluar dogana, si dhe dëshmi për importin.

Kompensimi

Neni 110

(1) Në vendim, gjykata i dhëron parashtruesit të kërkesës që t'i paguajë kompensim bartësit të së drejtës, i cili përcaktohet në rast të rrezikut serioz për shëndetin e njerëzve, ose rrethanave tjera të nevojës së skajshme, ose në rast të përdorimit jokomercial publik të përcaktuar me nenin 31 (b) të Marrëveshjes TRIPS.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni, është më së shumti 4% nga çmimi përgjithshëm të cilin e paguajnë vendet importuese, ose i cili paguhet në dobi të tij.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, në të gjitha rastet tjera kompensimi përcaktohet duke pasur i parasysh vlerat ekonomike të përdorimit, për të cilin vendi gjegjës ose vendet importuese janë të autorizuara me licencë, si dhe rrethanat humanitare dhe jokomerciale lidhur me dhënien e licencës.

Refuzim i kërkesës për dhenie të licencës së detyrueshme

Neni 111

(1) Gjykata do ta refuzojë kërkesën për dhënie të licencës së detyrueshme, në rast se nuk i përmban elementet e duhura për vendimmarrje ose nëse nuk janë të plotësuara kushtet për dhënie të licencës së detyrueshme, nga nenet 105 dhe 108 të këtij ligji.

(2) Gjykata nuk do të miratojë vendim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse paraprakisht nuk e ka ftuar parashtruesin e kërkesës që të deklarohet për arsyet për shkak të cilave gjykata nuk mund të japë licencë të detyrueshme.

Shuarja ose shqyrtim i sërishëm i licencës së detyrueshme

Neni 112

(1) Bartësi i së drejtës ose pranuesi i licencës, mundet me padi të kërkojë nga gjykata që ta heqë licencën e detyrueshme, nëse konfirmon se pala e kundërt nuk e respekton vendimin për dhënie të licencës së detyrueshme.

(2) Në aktgjykimin me të cilin vendoset për shuarjen e licencës së detyrueshme, gjykata do të caktojë afat në të cilin pranuesi i licencës është i obliguar që me shpenzime të veta t'i ridedikojë të gjitha produktet të cilat janë në pronësi ose kompetencë të tij, ose t'i lejojë vendit importues që ta bëjë atë ose në mënyrë tjetër ti mënjanojë, në marrëveshje me bartësin e së drejtës.

(3) Posa vendi importues të japë njoftim se sasia e produkteve farmaceutike është bërë e pamjaftueshme për përmbushjen e nevojave të tij, pranuesi i licencës me padi mund të kërkojë ndryshimin e kushteve për dhënien e licencës, për prodhimin dhe importin e sasive shtesë të produkteve, deri në nivelin e sasive të nevojshme për përmbushjen e nevojave të vendit importues. Në raste të tilla gjykata vepron urgjentisht. Nëse sasia e kërkuar e produktit nuk i tejkalon 25% nga sasia e përgjithshme e ndarë me licencën bazë, nuk zbatohen dispozitat nga neni 109, paragrafi (1), pika 1) e këtij ligji.

Njoftimet

Neni 113

(1) Gjykata, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, do ta njoftojë Këshillin e TRIPS-it, për aktgjykimet e plotfuqishme për dhënien e licencës së detyrueshme, kushtet në të cilat është dhënë, shuarjen dhe ndryshimin e saj.

(2) Të dhënat të cilat dorëzohen janë:

- 1) emri dhe adresa e pranuesit të licencës;
- 2) produkti me të cilin ka të bëjë;
- 3) sasia e siguruar;
- 4) vendi importues;
- 5) afati i licencës;
- 6) adresa e ueb-faqes nga neni 109, paragrafi (5) i këtij ligji.

Ndalimi i importit

Neni 114

(1) Në Republikën e Maqedonisë është i ndaluar importi i produkteve të prodhuara në bazë të licencës së detyrueshme, të dhënë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, për shkak të lëshimit të lirë në qarkullim, importit të përsëritur, procedurave suspenduese ose vendosjes në zona të lira ose magazinë të lirë.

(2) Paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet në rast të eksportit të përsëritur në vendin importues, të theksuar në fletëparaqitje dhe të identifikuar në paketim dhe dokumentacionin shoqërues për produktin, ose vënies në procedurë në magazinë doganore ose transitore për shkak të eksportit të përsëritur në vendin importues.

Puna e doganës

Neni 115

(1) Nëse ekziston bazë për dyshim se produktet e prodhuara në bazë të licencës së detyrueshme të dhënë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, janë importuar në territorin e Republikës së Maqedonisë në kundërshtim me dispozitat nga neni 113, paragrafi (1) i këtij ligji, organet doganore për shkak të kontrollit do t'i mbajnë produktet konkrete aq sa është e nevojshme, por më së shumti 10 ditë pune. Nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme, organet doganore mund të vendosin për vazhdimin e afatit, më së shumti për 10 ditë pune shtesë.

(2) Për mbajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, organet doganore pa prolongim do ta njoftojnë bartësin e së drejtës dhe prodhuesin ose importuesin e atyre produkteve, dhe do ta ftojnë që të dorëzojë të dhëna dhe dëshmi për produktet.

(3) Nëse organet doganore në periudhën e mbajtjes, e konfirmojnë cenimin e licencës së detyrueshme në kundërshtim me ndalimin nga neni 114, paragrafi (1) i këtij ligji, do t'i konfiskojnë produktet dhe do t'i mënjanojnë nga qarkullimi, në pajtim me dispozitat doganore.

(4) Procedura për mbajtje dhe konfiskim është me harxhime të importuesit, në pajtim me dispozitat doganore. Në mënyrë solidare me importuesin, për shpenzime përgjigjet edhe secili person tjetër i cili ka tentuar të kryejë import të paligjshëm.

(5) Nëse konfirmohet se me importin e produkteve të cilat janë mbajtur në pajtim me dispozitat e këtij neni, është shkelur ndalimi nga neni 114, paragrafi (1) i këtij ligji dhe nëse janë respektuar dispozitat doganore, organet doganore do t'i lëshojnë produktet në qarkullim në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(6) Në lidhje me konfiskimin dhe asgjësimin e produkteve në pajtim me dispozitat e këtij neni, organet doganore do ta njoftojnë Ministrinë e Ekonomisë.

FLETËPARAQITJET TË CILAT PARA SHTROHEN SIPAS MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Fletëparaqitjet të cilat parashtrohen nëpërmjet Entit si ent pranues në pajtim me MBP-në

Neni 116

(1) Për fletëparaqitjet të cilat ndërkombëtarisht parashtrihen nëpërmjet Entit si ent pranues, zbatohen dispozitat nga MBP-ja dhe dispozitat e këtij ligji.

(2) Fletëparaqitjet nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrihen në gjuhën angleze.

(3) Përmbajtja e fletëparaqitjes dhe forma e kërkesës për fletëparaqitjet nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Fletëparaqitjet në të cilat Enti është zgjedhur ose caktuar ent në pajtim me MBP-në

Neni 117

(1) Për fletëparaqitjet të cilat i parashtrihen entit si ent i zgjedhur ose caktuar zbatohen dispozitat nga MBP-ja dhe dispozitat e këtij ligji.

(2) Përmbajtja e fletëparaqitjes dhe forma e kërkesës për fletëparaqitjet nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Fletëparaqitjet të cilat parashtrihen në pajtim me Marrëveshjen për zgjerim

Neni 118

(1) Për fletëparaqitjet të cilat parashtrihen në pajtim me Marrëveshjen për zgjerim, zbatohen dispozitat nga Marrëveshja për zgjerim dhe dispozitat e këtij ligji.

(2) Përmbajtja e fletëparaqitjes dhe forma e kërkesës për fletëparaqitjet nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

E drejta e cila zbatohet në fletëparaqitjet evropiane dhe patentat evropiane

Neni 119

Për patentat evropiane të cilat i pranon EEP-ja në pajtim me KEP-në dhe fletëparaqitjet evropiane të parashtruara në pajtim me KEP-në, për të cilat është kërkuar mbrojtje në Republikën e Maqedonisë zbatohen dispozitat e këtij ligji, nëse kjo nuk është rregulluar ndryshe me KEP-në.

Parashtrimi i fletëparaqitjeve evropiane

Neni 120

(1) Fletëparaqitjet evropiane, përveç fletëparaqitjeve të ndara evropiane, parashtrihen në cilëndo gjuhë.

(2) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të përmbajë shenjë të qartë se parashtrihet fletëparaqitje evropiane.

(3) Dispozitat nga nenet 71, 72 dhe 73, zbatohen edhe në fletëparaqitjet evropiane të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë.

Të drejtat e fletëparaqitjeve evropiane

Neni 121

(1) Fletëparaqitja evropiane për të cilën është kërkuar mbrojtje në Republikën e Maqedonisë dhe është vërtetuar data e parashtrimit në EEP, ka trajtim të fletëparaqitjes së rregullt nacionale të patentës, pa marrë parasysh rezultatit nga procedura.

(2) Fletëparaqitja evropiane e shpallur në pajtim me KEP-në për të cilën është kërkuar mbrojtje në Republikën e Maqedonisë, ka mbrojtje sipas nenit 301, paragrafi (5) i këtij ligji, duke llogaritur nga data në të cilën përkthimi i kërkesave për patentë të asaj fletëparaqitjeje i është parashtruar personit i cili e shfrytëzon shpikjen në Republikën e Maqedonisë.

Të drejtat e patentave evropiane

Neni 122

(1) Patenta evropiane për të cilën është kërkuar mbrojtje në Republikën e Maqedonisë në pajtim me paragrafët nga (2) deri në (4) të këtij neni, i ka të drejtat e njëjta nga neni 89 i këtij ligji me patentën nacionale, duke llogaritur nga data e pranimit në EEP.

(2) Bartësi i patentës evropiane është i detyruar që në afat prej 3 muajsh nga data e shpalljes së pranimit në EEP, fletëparaqitjes për pranimin e patentës në Ent t'i bashkëngjesë edhe përkthimin në gjuhën maqedonase të kërkesave për patentë dhe projektet, nëse fletëparaqitja përmban projekte, dhe t'i paguajë taksat e përcaktuara dhe harxhimet e procedurës.

(3) Obligimi dhe afati nga paragrafi (2) i këtij neni, zbatohet edhe në patentën evropiane e cila mbahet me sasi të ndryshuar të mbrojtjes, si rezultat i procedurës së kundërshtimit para EEP-së.

(4) Enti do t'i shpallë përkthimet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni në organin zyrtar.

(5) Patentat evropiane të cilat janë parashtruar në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, regjistrohen në regjistrin e Entit dhe publikohen në organin zyrtar të Entit.

(6) Nëse bartësi i patentës evropiane në afatin e caktuar nuk i dorëzon përkthimet nga paragrafët (2) dhe (3), ose nuk i paguan taksat dhe harxhimet e procedurës, Enti me aktvendim do ta hedhë poshtë fletëparaqitjen nga paragrafi (2) i këtij neni.

Gjuha e patentave evropiane

Neni 123

(1) Nëse përkthimi i kërkesave për patentë në gjuhën maqedonase nga nenet 121 paragrafi (2) dhe 122 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, ofron mbrojtje në sasi të zvogëluar lidhur me mbrojtjen e fletëparaqitjes evropiane

ose patentës evropiane në gjuhën e procedurës, përkthimi në gjuhën maqedonase do të zbatohet në të gjitha procedurat, përveç në procedurën e kundërshtimit para EEP-së.

(2) Parashtruesi gjegjësisht bartësi i patentës evropiane mund t'i dorëzojë korrigjimet e përkthimit nga paragrafi (1) i këtij neni, deri në përfundimin e procedurës së pranimit para EEP-së.

Mbajtja e patentave evropiane

Neni 124

(1) Për mbajtjen e patentave evropiane në Republikën e Maqedonisë, paguhen taksa për çdo vit i cili e pason vitin e shpalljes së pranimit të patentës evropiane, por jo më vonë se dy muaj nga data e shpalljes së pranimit të patentës evropiane, në pajtim me EEP-në.

(2) Për pagesën e mjeteve për mbajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë adekuate zbatohet neni 141 paragrafi (2) i EEP-së.

Konversioni në fletëparaqitjet nacionale

Neni 125

(1) Fletëparaqitja evropiane për të cilën është kërkuar mbrojtje në Republikën e Maqedonisë mund të konvertohet në fletëparaqitje nacionale, nëse e njëjta llogaritet e tërhequr në pajtim me nenin 77 paragrafi (5) i EEP-së, ose nëse përkthimi i kërkesave për patentë në pajtim me nenin 14 paragrafi (2) i EEP-së, nuk është parashtruar në afatin nga neni 90, paragrafi (3) i EEP-së.

(2) Parashtruesi i fletëparaqitjes nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar që Entit t'ia parashtrojë përkthimin e fletëparaqitjes në gjuhën maqedonase dhe t'i paguajë taksat dhe harxhimet e përcaktuara.

Mbrojtja paralele

Neni 126

Nëse patenta evropiane dhe patenta nacionale kanë datë të njëjtë të parashtrimit, ose nëse është kërkuar e drejta e përparësisë dhe data e njëjtë i është pranuar personit të njëjtë, ose trashëgimtarit të tij juridik, patenta nacionale nuk ka veprim juridik në sasi në të cilën shpikja e njëjtë është përfshirë me patentën evropiane, duke llogaritur nga data në të cilën ka skaduar afati për parashtrimin e kundërshtimit, ndërsa kundërshtimi nuk është parashtruar, ose nga data në të cilën në procedurë të kundërshtimit është marrë vendim përfundimtar, se patenta evropiane mbetet në fuqi.

PJESA E TRETË DIZAJNI INDUSTRIAL

Lënda e mbrojtjes

Neni 127

(1) Me të drejtën e dizajnit industrial, mbrohet dizajni i cili është i ri dhe ka karakter individual.

(2) Dizajni sipas paragrafit (1) të këtij neni, është pamja e jashtme e produktit në tërësi ose e pjesës së tij, e cila është përcaktuar nga veçoritë e tij, veçanërisht linjat, tiparet, konturat, ngjyrat, forma, tekstura dhe matrialet nga të cilat përbëhet ose zbukurohet produkti si dhe/ose ornamentet.

(3) "Produkt" sipas paragrafit (2) të këtij neni, është lënda industriale ose zejtare, duke përfshirë mes tjerash edhe pjesë të cilat janë të dedikuara për bashkim në produkt të kombinuar, paketim të produktit, simbolet grafike, shenjat tipografike, me përjashtim të programeve kompjuterike.

(4) "Produkt i kombinuar" sipas paragrafit (3) të këtij neni, është produkti i cili është i përbërë prej më shumë pjesëve të cilat mundë të zëvendësohen, ashtu që mundësojnë ndarjen dhe bashkimin e sërishëm të produktit.

(5) Dizajni i aplikuar në produkt ose i përmbajtur në produkt, i cili është pjesë përbërëse e produktit të kombinuar, llogaritet se është i ri dhe ka karakter individual, nëse:

1) pjesa përbërëse që është futur në produktin e kombinuar, mbetet e dukshme në kohën e shfrytëzimit të rëndomtë të produktit të ndërlikuar;

2) karakteristikat e dukshme të pjesës përbërëse, i plotësojnë kushtet e risisë dhe karakterit individual.

(6) Me "përdorim të rëndomtë" sipas paragrafit (5) pikës 2), nënkuptohet përdorimi nga ana e shfrytëzuesit përfundimtar, duke përjashtuar mirëmbajtjen, servisimin ose riparimin e produktit.

Risite e dizajnit

Neni 128

(1) Dizajni llogaritet si i ri, nëse dizajni identik nuk ka qenë i kapshëm në opinionin publik para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për njohjen e atij dizajni, ose nëse është kërkuar e drejta e përparësisë para datës së përparësisë së kërkuar, ose nëse nuk egziston fletëparaqitje e parashtruar më herët për njohjen e dizajnit identik.

(2) Dizajni llogaritet për identik edhe atëherë kur dallohet në pjesët e parëndësishme.

Karakterit individual

Neni 129

(1) Konsiderohet se dizajni ka karakter individual, nëse tërësia e përshtypjes që i bën shfrytëzuesit të informuar, dallohet nga përshtypja e përgjithshme që shfrytëzuesit i bën çfarëdo dizajni që është i kapshëm për opinionin, para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për dizajn industrial, ose nëse është kërkuar e drejta e përparësisë para datës së njohjes të së drejtës së përparësisë.

(2) Në vlerësimin e karakterit individual të dizajnit, patjetër duhet të merret parasysh shkalla e lirisë, të cilën autori e ka pasur gjatë krijimit të dizajnit.

Zbulimi i dizajnit

Neni 130

(1) Mendohet se dizajni i është bërë i kapshëm opinionit, sipas nenit 128 paragrafi (1) nga ky ligj, nëse është shpallur, ekspozuar, shfrytëzuar në qarkullim ose i zbuluar në mënyrë tjetër, para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për njohjen e dizajnit ose datës së përparësisë nëse është kërkuar, përveç se nga shkaqe të arsyeshme zbulimi nuk ka mund të jetë i njohur në punën e rregullt në sferat e specializuara në Republikën e Maqedonisë, para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për dizajn industrial, ose nëse është kërkuar e drejta e përparësisë para datës të përparësisë.

(2) Nuk llogaritet se dizajni është bërë i kapshëm për publikun sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse:

1) është zbuluar nga personi i tretë në kushte të qarta ose të supozuara të fshehtësisë.

2) është zbuluar nga ana e dizajnesit, pasuesit të tij juridik ose personit të tretë, në bazë të informatave ose aktiviteteve të ndërmarra nga ata, në kohën prej 12 muajsh, para datës së parashtrimit të fletëparaqitjes për dizajn industrial, ose nëse është e kërkuar e drejta e përparësisë, nga data e përparësisë.

Dizajni i kushtëzuar nga funksionet teknike dhe dizajni i elementeve të lidhura

Neni 131

(1) Me dizajnin industrial nuk mund të mbrohet dizajni:

1) i cili ekskluzivisht është përcaktuar nga funksionet teknike të prodhimit, ose

2) i cili patjetër duhet të jetë i riprodhuar në formën dhe dimensionet e saktë të tij, që të mundet prodhimi në të cilin përmbahet ose në të cilin zbatohet dizajni, të jetë i lidhur mekanikisht me prodhim tjetër ose i vendosur në, afër ose përreth prodhimit tjetër, që të munden të dy prodhimet ta kryejnë funksionin e tyre.

(2) Përderisa plotësohen kushtet nga nenet 128 dhe 129 nga ky ligj, pa marrë parasyshë dispoziën nga paragrafi (1) pika (2) e këtij neni, mund të mbrohet dizajni i cili mundëson kombinimose lidhshmëri të shumëfishtë, të prodhimeve të zëvendësueshme ndërmjet tyre në sistem modular.

Shkaqet absolute për refuzim

Neni 132

(1) Me të drejtë të dizajnit industrial, nuk mund të mbrohet dizajni i cili:

1) nuk është në pajtim me nenin 127 paragrafi (2) të këtij ligji;

2) është në kundërshtim me rendin publik ose moralin;

- 3) paraqet plan ose skicë teknike;
 - 4) paraqet vepër ekskluzive kartografike ose fotografike;
 - 5) përmban stemë shtetërore ose stemë tjetër publike , flamur ose amblemë, emër ose shkurtesë të emrit të ndonjë organizate ndërkombëtare, përveç me leje nga organi kompetent shtetit ose organizatës përkatëse;
 - 6) i cili përmbanë ose imiton personalitet ose emër të personit të njohur ose të vdekur historik të Republikës së Maqedonisë, përveç me leje të organit kompetent të administratës shtetërore ;
 - 7) i cili përmbanë ose imiton emër, formë ose pjesë tjetër njohëse, të trashigimisë së mbrojtur kulturore të Republikës së Maqedonisë, përveç me leje të organit kompetent të administratës shtetërore.
- (2) Organ kompetent për dhënien e lejes nga paragrafi (1) pikat 5) dhe 6) të këtij neni për Republikën e Maqedonisë, është Ministrina e Drejtësisë, kurse për dhënien e lejes nga paragrafi (1) pika 7), organ kompetent është Drejtoria për mbrojtje të trashigimisë kulturore.

Shkaqe relative për refuzim

Neni 133

- (1) Me të drejtën e dizajnit industrial nuk mund të mbrohet dizajni:
 - 1) i cili nuk është i ri sipas nenit 128 nga ky ligj;
 - 2) i cili nuk ka karakter individual sipas nenit 129 të këtij ligji;
 - 3) i cili mund të mbrohet në pajtim me neni 131 nga ky ligj;
- (2) Me dizajn industrial nuk mund të mbrohet dizajni, me të cilin cenohen të drejtat e arritura paraprakisht të:
 - 1) bartësit të së drejtës së mbrojtur të mëparshme, nga pronsia industriale;
 - 2) personit i cili ka të drejtë autorësie të veprës, që është identike ose e ngjashme me dizajnin.
- (3) Në shkaqet për përjashtimin nga mbrojtja e së drejtës së dizajnit industrial në pajtim me paragrafin (1) pika 4) nga ky nen, mund të thirret vetëm parashtruesi i fletëparaqitjes së parashtruar më parë ose bartësi i së drejtës së arritur më parë.
- (4) Dizajni industrial i paraqitur më parë, do të jetë arsye për refuzim vetëm nëse regjistrohet.

Parashtruesi i fletëparaqitjes

Neni 134

- (1) Procedurë për arritjen e së drejtës për dizajn industrial, mund të ngritë autori ose pasuesi i tij juridik.
- (2) Nëse dizajni është krejim i disa autorëve, atëherë të drejtë për ngritjen e procedurës nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë të gjithë autorët ose pasuesit e tyre juridikë.

(3) Nëse fletëparaqitja e dizajnit industrial nuk është parashtruar nga autori, llogaritet se është parashtruar në pajim me paragrafin (1) të këtij neni, derisa nuk dëshmohet e kundërta.

(4) Fletëparaqitje për dizajn industrial mund të parashtrojë edhe porositi, nëse dizajni është bërë në bazë të kontratës për porosi, përveç nëse me kontratë nuk është përcaktuar ndryshe.

(5) Fletëparaqitje për dizajn industrial mund të parashtrojë edhe punëdhënësi, nëse dizajni është bërë nga punonjës, në kuadër të kryerjes së obligimeve punuese, duke ndjekur udhëzimet nga punëdhënësi, përveç nëse me kontratë për punë nuk është përcaktuar ndryshe.

Autori

Neni 135

(1) Autor është person fizik i cili e ka krijuar dizajnin, me punën e tij krijuese.

(2) Nuk llogaritet për autor, ai i cili në krijimin e dizajnit ka ofruar vetëm ndihmë teknike.

Pasardhësi juridik

Neni 136

(1) Pasardhës juridik i autorit është personi juridik ose fizik arritja e së drejtës së dizajnit industrial të të cilit, bazohet në ligj, punë juridike, trashigimi dhe aktvendim gjyqësor.

Ngritja e procedurës

Neni 137

(1) Procedura për njohjen e të drejtës për dizajn industrial, ngritet me parashtrim të fletëparaqitjes për dizajn industrial, te Enti.

(2) Procedura për njohje të së drejtës së dizajnit industrial, mund të ngritet edhe me parashtrim të fletëparaqitjes në pajtim me Marrëveshjen e Hagës.

(3) Procedura për regjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial, në pajtim me dispozitat nga Marrëveshja e Hagës, ngritet me parashtrim të fletëparaqitjes për regjistrim ndërkombëtar të dizajnit industrial, drejtpërdrejt te Byroja ndërkombëtare e Organizatës botërore për pronësi intelektuale.

Veçantia e dizajnit

Neni 138

(1) Për çdo dizajn për të cilin kërkohet mbrojtje, parashtrohet fletëparaqitje e veçantë.

(2) Me një fletëparaqitje për njohjen e së drejtës për dizajn industrial, mund të kërkohet mbrojtje e më shumë dizajneve të prodhimeve (fletëparaqitje e shumëfishtë).

(3) Nëse është parashtruar fletëparaqitje e shumëfishtë, të gjithë dizajnet nga fletëparaqitja, patjetër duhet të dedikohen për zbatim të prodhimet e klasifikuara në të njëjtën klasë, sipas Klasifikimit të Lokarnës.

(4) Fletëparaqitja e shumëfishtë mund të përmbajë më së shumti njëqind dizajne.

E drejtja për përparësi

Neni 139

(1) Nga dita e pranimit të fletëparaqitjes së rregullt të dizajnit industrial në Ent, bartësi i fletëparaqitjes së dizajnit industrial ka të drejtë në përparësi ndaj çdo personi tjetër, cili për të njëjtin dizajn do të paraqesë fletëparaqitje.

(2) Përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, është kur janë plotësuar kushtet për parashtrim të fletëparaqitjes për dizajn industrial, të parapara në nenet 140 dhe 141 të këtij ligji.

E drejta e panairit në përparësi

Neni 140

(1) Personi i cili në ekspozitën e njohur oficiele, ose në panair me karakter ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë, ose në vend tjetër anëtar të Unionit të Parisit ose OTB-së ekspozon dizajn, mundet në afat prej tre muajsh nga dita e mbylljes së ekspozes (panairit), me fletëparaqitje të kërkojë të drejtë përparësie nga dita e parë e ekspozimit, gjegjësisht nga dita e përdorimit.

(2) Me fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni, patjetër duhet të parashtrohet vërtetim me shkrim, nga organi kompetent i vendit anëtar i Unionit të Parisit ose OTB-së, se bëhet fjalë për njohjeoficiale të ekspozitës (panairit), sipas Konventës për ekspozita ndërkombëtare, me shënimin e të dhënave për llojin e ekspozitës ose panairit, vendit e mbajtjes së tij, ditën e hapjes dhe ditën e mbylljes, gjegjësisht për ditën e përdorimit.

(3) Me njohjen e të drejtës së përparësisë nga ky nen, nuk vazhdojnë afatet nga neni 141 i këtij ligji.

E drejta e Unionit për përparësi

Neni 141

(1) Personit juridik ose fizik i cili në ndonjë nga vendet anëtare të Unionit të Parisit ose OTB-së ka parashtruar fletëparaqitje të rregullt për dizajn industrial, do t'i njihet e drejta e përparësisë në Republikën e Maqedonisë, nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë, nëse atë e kërkon në afat prej gjashtë muajsh, nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë.

(2) Për fletëparaqitje të rregullt nga paragrafi (1) i këtij neni, llogaritet fletëparaqitja datë e parashtrimit të së cilës, është përcaktuar në pajtim me

legjislacionin nacional të vendit anëtar të Unionit të Parisit ose të OTB-së, në të cilin është parashtruar ose në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura ndërmjet vendeve anëtare të Unionit, pa marrë parasysh fatin e mëvonshëm juridik të fletëparaqitjes.

Obligimet e parashtruesit të fletëparaqitjes me përparësi të unionit

Neni 142

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes për dizajn ndërkombëtar, që ka për qëllim ta shfrytëzojë të drejtën e përparësisë nga neni 141 i këtij ligji, është i obliguar që në fletëparaqitjen e parashtruar në Republikën e Maqedonisë, t'i shënojë të gjitha të dhënat për fletëparaqitjen në të cilën thirret, dhe në afat prej tre muajsh nga dita e parashtrimit të kërkesës për njohje të së drejtësë për përparësi, ta bashkëngjësë përshkrimin e fletëparaqitjes së parë, të verifikuar nga organi kompetent i vendit anëtar i Unionit të Parisit ose OTB-së, në të cilin është parashtruar fletëparaqitje e parë.

E drejta e shumëfishtë e përparësisë

Neni 143

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së dizajnit industrial, mund të thirret në të drejtën e shumëfishtë të përparësisë, në bazë të më shumë fletëparaqitjeve të parashtruara paraprakisht, në një ose më shumë vende anëtare të unionit të Parisit ose OTB-së.

(2) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes thirret në të drejtën e shumëfishtë të përparësisë, afatet të cilat sipas këtij ligji fillojnë të rrjedhin nga data e njohjes së të drejtës së parësisë, llogariten nga data e mëhershme e të drejtës së shumëfishtë të përparësisë.

Certifikata për të drejtë të përparësisë

Neni 144

(1) Enti me kërkesë të parashtruesit të fletëparaqitjes jep certifikatë për të drejtë të përparësisë, që llogaritet nga data e përcaktuar si datë e parashtrimit të fletëparaqitjes së dizajnit industrial.

(2) Përmbajtja e kërkesës dhe përmbajtja e certifikatës për të drejtën e përparësisë, përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Përmbajtja e fletëparaqitjes

Neni 145

(1) Fletëparaqitja e dizajnit industrial, doemos duhet të përmbajë:

- 1) kërkesë për njohjen e të drejtës së dizajnit industrial;
- 2) të dhëna për parashtruesin e fletëparaqitjes;
- 3) paraqitje të dizajnit për të cilin kërkohet mbrojtje.

(2) Me fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohen edhe pjesë dhe shtojca tjera.

(3) Nëse është parashtruar kërkesë për prolongimin e shpalljes së fletëparaqitjes së dizajnit industrial dydimensional, sipas nenit 155 paragrafi (1) nga ky ligj, me kërkesë mund të bashkëngjiten dhe ekzemplarë të lëndës ku dizajni është zbatuar në vend të paraqitjes së dizajnit.

(4) Përmbajtja dhe forma e fletëparaqitjes dhe pjesët dhe shtojcat tjera të fletëparaqitjes, më detalisht përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Data e parashtrimit të fletëparaqitjes

Neni 146

(1) Nëse fletëparaqitja nuk e ka përmbajtjen e paraparë me nenin 145 paragrafi (1) të këtij ligji, Enti do ta njoftojë parashtruesin se fletëparaqitja e tij nuk është e rregullt dhe nuk mund t'i pranohet data e parashtrimit.

(2) Nëse për fletëparaqitjen për dizajn industrial nuk mund të njihet data e parashtrimit, Enti do ta thirrë parashtruesin që në afat prej 30 ditëve nga pranimi i thirrjes, t'i menjanojë mangësitë e konfirmuara në pajtim me nenin 145 paragrafi (1) i këtij ligji.

(3) Nëse parashtruesi i menjanon mangësitë në afat të paraparë, Enti do ta caktojë datën e parashtrimit të fletëparaqitjes.

(4) Si datë e parashtrimit, do të merret data në të cilën parashtruesi i ka mënjanuar mangësitë e konfirmuara dhe ka vepruar në pajtim me njoftimin, ose në pajtim me nenin 145 paragrafi 1 i këtij ligji.

(5) Nëse parashtruesi në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni nuk i mënjanon mangësitë, do të llogaritet se fletëparaqitja është tërhequr dhe do të merret përfundim për ndërprerjen e procedurës.

Regjistrimi në regjistrin të fletëparaqitjeve

Neni 147

(1) Fletëparaqitja e dizajnit industrial, regjistrohet në regjistrin e fletëparaqitjeve të dizajnit industrial.

(2) Përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së regjistrin të fletëparaqitjeve të dizajnit industrial dhe ekstrakti nga regjistrimi, përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Ndarja e fletëparaqitjes së shumëfishtë

Neni 148

(1) Fletëparaqitja e shumëfishtë e dizajnit industrial mundet, me kërkesën e parashtruesit të fletëparaqitjes, gjatë procedurës për njohjen e të drejtës së dizajnit industrial, të ndahet në dy ose më shumë fletëparaqitje.

(2) Ndarja e fletëparaqitjes së dizajnit industrial është e lejuar deri në marrjen e aktvendimit për pranimin e të drejtës së dizajnit industrial.

(3) Fletëparaqitja e dizajnit industrial e bërë me ndarjen e fletëparaqitjes së shumëfishtë, e mban datën e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë dhe të drejtën e përparësisë nëse është kërkuar.

(4) Përmbajtja e kërkesës për ndarjen e fletëparaqitjes së dizajnit industrial, përcaktohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Fletëparaqitja e rregullt

Neni 149

Fletëparaqitja e dizajnit industrial është e rregullt, nëse është:

1) e përpiluar ashtu që i përmban të gjitha pjesët dhe shtojcat e nevojshme të parapara në nenin 145 të këtij ligji, dhe dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

2) parashtruar autorizimi i rregullt, nëse fletëparaqitja është parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit;

3) parashtruar përkthimi i fletëparaqitjes në gjuhën maqedonase, nëse fletëparaqitja është përpiluar në gjuhë të huaj;

4) paguar taksa e përcaktuar për fletëparaqitjen dhe parashtruar dëshmi për kryerjen e pagesës.

Shqyrtimi formal i fletëparaqitjes

Neni 150

(1) Pas regjistrimit të fletëparaqitjes së dizajnit industrial në regjistrin e fletëparaqitjeve, Enti e shqyrton se a është e rregullt sipas nenit 149 të këtij ligji.

(2) Nëse vërteton se fletëparaqitja e dizajnit industrial nuk është e rregullt, Enti do ta thirrë parashtruesin e fletëparaqitjes në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë, duke llogaritur nga dita e pranimit të njoftimit, që t'i mënjanojë mangësitë e përcaktuara .

(3) Me kërkesën e arsyetuar të parashtruesit të fletëparaqitjes, afati nga paragrafi (2) i këtij neni, mundet nga shkaqet e arsyeshme që të vazhdohet më së shumti edhe për 60 ditë.

(4) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afat të përcaktuar nuk i menjanon mangësitë nga paragrafi (2) i këtij neni, Enti me aktvendim ia refuzon fletëparaqitjen.

(5) Kur bartësi i fletëparaqitjes thirret në shtojca që nuk janë të përmbajtura në fletëparaqitje, Enti e njofton parashtruesin e fletëparaqitjes që t'i parashtrorë në afat të caktuar.

(6) Nëse parashtruesi nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, llogaritet se shtojcat nuk egzistojnë.

(7) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e përcaktuar e rregullon fletëparaqitjen, llogaritet se fletëparaqitja është parashtruar me rregull.

Shqyrtimi i kushteve për njohjen e së drejtës

Neni 151

Nëse fletëparaqitja është në rregull sipas nenit 149 të këtij ligji, Enti shqyrton se a janë plotësuar kushtet për njohjen e të drejtës së dizajnit industrial.

Aktvendim për refuzimin e fletëparaqitjes

Neni 152

(1) Nëse dizajni i paraqitur industrial nuk mund të pranohet për disa nga arsyet e shënuara në nenin 132 të këtij ligji, Enti merr aktvendim për refuzim të plotë ose të pjesërishtëm të fletëparaqitjes.

(2) Enti nuk mund të marrë aktvendim për refuzimin e fletëparaqitjes së dizajnit industrial, nëse paraprakisht me shkrim nuk e njofton parashtruesin e fletëparaqitjes, për arsyet për të cilat nuk mund të pranohet e drejta e kërkuar, gjegjësisht nuk mund ta njohë të drejtën në sasinë e kërkuar edhe nëse nuk e ka ftuar parashtruesin e fletëparaqitjes në afat të arsyeshëm që të deklarohet për ato arsye.

(3) Afati i paragrafit (2) të këtij neni mundet, me kërkesë të arsyetuar nga parashtruesi i fletëparaqitjes, të vazhdohet deri në gjashtë muaj.

(4) Parashtruesi i fletëparaqitjes gjatë deklarimit, nuk mundet në mënyrë plotësuesetë ndryshojë dizajnin.

Pagimi i shpenzimeve

Neni 153

(1) Nëse fletëparaqitja e dizajnit industrial i plotëson kushtet sipas nenit 149 të këtij ligji, dhe nëse dizajni nuk është përjashtuar nga mbrojtja sipas nenit 132 nga ky ligj, Enti do ta thirrë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afat të caktuar që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, t'i paguajë shpenzimet për shpallje të të dhënave nga fletëparaqitja në organin zyrtar të Entit.

(2) Nëse parashtruesi nuk i paguan shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti do të marrë aktvendim me të cilin do ta refuzojë fletëparaqitjen.

Shpallja e fletëparaqitjes së dizajnit industrial

Neni 154

(1) Nëse bartësi vepron në pajtim me nenin 153 paragrafi (1) të këtij ligji, Enti më së voni në afat prej 90 ditësh do t'i shpallë të dhënat nga fletëparaqitja në organin zyrtar të Entit.

(2) Të dhënat nga fletëparaqitja të cilat shpallen në organin zyrtar të Entit, përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Prolongimi i shpalljes të fletëparaqitjes të dizajnit industrial

Neni 155

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së dizajnit industrial mundet, në të njëjtën kohë me parashtrimin e fletëparaqitjes, të kërkojë prolongim të shpalljes në kohë prej 12 muajsh, duke llogaritur nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes, ose nëse është kërkuar e drejta e përparësisë, nga data e së drejtës së përparësisë.

(2) Nëse është kërkuar prolongimi i shpalljes së dizajnit industrial, në organin zyrtar të Entit do të shpallen të dhënat nga fletëparaqitja, në mënyrë të përcaktuar me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti pas skadimit të afatit për prolongimin e shpalljes së dizajnit industrial, ose në cilëndo datë të

mëparshme që është e shënuar në kërkesë të parashtruesit të fletëparaqitjes, do ta thirrë parashtruesin që në afat prej 30 ditësh, të parashtojë fotografi ose paraqitje grafike të dizajnit nga fletëparaqitja, sipas nenit 145 paragrafi (1) pika 3, dhe t'i paguajë shpenzimet nga neni 153 paragrafi (1) i këtij ligji.

(4) Nëse parashtruesi nuk vepron në pajtim me njoftimet nga paragrafi (3) i këtij neni, fletëparaqitja refuzohet me aktvendim.

(5) Nëse bëhet fjalë për fletëparaqitje të shumëfishtë, paragrafi (1) dhe paragrafi (3) të këtij neni, mund të zbatohen edhe vetëm në disa nga dizajnet e përmbajtura në atë fletëparaqitje.

Kundërshtimi

Neni 156

(1) Kundërshtim për fletëparaqitjen e shpallur të dizajnit industrial te Enti, në afat prej 90 ditësh duke llogaritur nga dita e shpalljes, mund të parashtojë:

1) parashtruesi i dizajnit industrial të paraqitur më parë dhe bartësi i të drejtës së njohur më parë të dizajnit industrial;

2) bartësi i të drejtës së mëparshme të pronësisë industriale, nëse lënda e asaj të drejte është identike ose e ngjajshme me dizajnin e shpallur industrial;

3) personi i cili ka të drejtë autorësie për veprën e cila është identike ose e ngjajshme, me dizajnin e shpallur industrial dhe

4) personi i interesuar i cili konsideron se dizajni i shpallur industrial, nuk i përmbush kërkesat për risi dhe karakter individual ose ekskluzivisht është i kushtëzuar nga karakteristikat funksionale të prodhimit, sipas nenit 133 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Afati për parashtrimin e kundërshtimit të përcaktuar në paragrafin (1) nga ky nen, nuk mund të vazhdohet.

(3) Për çdo fletëparaqitje të shpallur të dizajnit industrial, parashtrohet kundërshtimi i veçantë;

(4) Përmbajtja e kundërshtimit dhe mënyra e parashtrimit, përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Shqyrtimi i kundërshtimit

Neni 157

(1) Enti kontrollon se a është parashtruar kundërshtimi nga personi i cili ka të drejtë të parashtojë kundërshtim, sipas nenit 156 paragrafi (1) i këtij ligji, dhe vallë kundërshtimi është parashtruar në afat të përcaktuar.

(2) Nëse nuk janë përmbushur kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti miraton aktvendim për refuzim të kundërshtimit.

(3) Nëse janë të plotësuara kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti në afat prej 15 ditësh nga pranimi, e dorëzon kundërshtimin te parashtruesi i fletëparaqitjes së dizajnit industrial, dhe e fton në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë, të deklarohe për shkaqet e shënuara në kundërshtim.

(4) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afat të përcaktuar nga paragrafi (3) i këtij neni nuk deklarohe për arsyet e shënuara në kundërshtim, Enti do të vendosë në bazë të konstatimeve në kundërshtim.

Vendosja pas kundërshtimit

Neni 158

(1) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes së dizajnit industrial deklarohe për arsyet e shënuara në kundërshtim, dhe dërgon përgjigje pas kundërshtimit, Enti e shqyrton bazueshmërinë e kundërshtimit, duke i marrë parasysh shkaqet për kundërshtimin dhe përgjigjen e kundërshtimit.

(2) Nëse Enti konstaton se kundërshtimi është pa bazë, kundërshtimi refuzohet me aktvendim i cili i dërgohet parashtruesit të fletëparaqitjes dhe parashtruesit të kundërshtimit.

(3) Nëse Enti konstaton se kundërshtimi është i bazuar, miraton aktvendim për refuzim të fletëparaqitjes e cila i dorëzohet parashtruesit të fletëparaqitjes dhe parashtruesit të kundërshtimit.

Miratimi ivendimit dhe regjistrimi në Regjistrin e dizajnit industrial

Neni 159

(1) Nëse nuk është parashtruar kundërshtim në afat të caktuar ose nëse kundërshtimi është refuzuar, Enti do ta thirrë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të njoftimit ta paguajë taksën për mbajtje për pesë vitet e para të vlefshmërisë së dizajnit industrial, shpenzimet për shpalljet në organin e Entit dhe shpenzimet për dhënien e dokumentit për dizajn industrial.

(2) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afat të caktuar i paguan taksat dhe shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti miraton aktvendim për njohjen e të drejtës së dizajnit industrial dhe të drejtën e njohur do ta regjistrojë në regjistrin për dizajn industrial.

(3) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afat të paraparë nuk i paguan taksat dhe shpenzimet e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, Enti me aktvendim e hedh poshtë fletëparaqitjen.

(4) Përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së regjistrit të dizajnit industrial dhe ekstraktin nga regjistri, përcaktohen me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Regjistrimi i ndryshimeve në regjistra

Neni 160

(1) Në regjistrin e fletëparaqitjeve të dizajnit industrial dhe në regjistrin e dizajneve industriale, regjistrohen ndryshimet që kanë të bëjnë me parashtruesin e fletëparaqitjes, bartësin e së drejtës dhe vet të drejtën.

(2) Ndryshimet që regjistrohen në regjistrin e fletëparaqitjeve të dizajnit industrial pas shpalljes së fletëparaqitjes dhe ndryshimet që regjistrohen në Regjistrin e dizajnit industrial, shpallen në organin zyrtar të Entit.

(3) Ndryshimet të cilat regjistrohen, përmbajtjen dhe formën e kërkesës dhe procedurës për regjistrim të ndryshimeve, përcaktohen me dispozitë miraton drejtori i Entit.

Sasia e mbrojtjes

Neni 161

(1) Sasia e mbrojtjes së dizajnit industrial është e përcaktuar me karakteristikat e dizajnit të dhëna në pasqyrim dhetë cilat janë të përmbajtura në përshkrim nëse ekziston.

(2) Mbrojtja e cila rrjedh nga e drejta e dizajnit industrial, e përfshin dizajnin në sasi në të cilën shfrytëzuesit të informuar nuk i bën përshtypje tjetër.

(3) Gjatë vlerësimit të sasisë së mbrojtjes, merret parasysh liria e dizajnuetit të cilën dizajneri e ka pasur gjatë krijimit të dizajnit.

Marrja e së drejtës së dizajnit industrial

Neni 162

(1) E drejta e dizajnit industrial merret me ditën e miratimit të aktvendimit për njohjen e së drejtës dhe me regjistrim në regjistër.

(2) Data e regjistrimit në regjistër është e njëjtë me datën e miratimit të aktvendimit për njohjen e dizajnit industrial.

Shpallja e dizajnit industrial

Neni 163

(1) Të dhënat për dizajnin industrial shpallen në organin zyrtar të Entit, më së voni me afat prej 90 ditësh nga data e regjistrimit të dizajnit industrial në regjistër.

(2) Të dhënat të cillat shpallen në organin zyrtar të Entit, përcaktohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Dokumenti për dizajn industrial

Neni 164

(1) Bartësit të dizajnit industrial, Enti i jep dokument më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga data e miratimit të aktvendimit për njohjen e të drejtës të dizajnit industrial.

(2) Përmbajtja e dokumentit për dizajn industrial përcaktohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Të drejtat morale të autorit të dizajnit industrial

Neni 165

(1) Autori, pavarishtë nga ajo se a është parashtrues i fletëparaqitjes ose bartës i së drejtës, çdoherë ka të drejtë të shënohet si autor i dizajnit industrial në të gjitha dokumentet dhe shpalljet publike.

(2) E drejta morale e autorit është e pambartshme.

(3) Nëse më shumë autorë kanë marrë pjesë në krijimin e dizajnit industrial, të gjithë autorët kanë të drejta të njejta pavarishtë nga kontributi punimin e dizajnit industrial, ashtu që të gjithë duhet të jenë të evidentuar.

Të drejtat ekskluzive

Neni 166

(1) Bartësi i dizajnit industrial ka të drejtë ekskluzive që ta shfrytëzojë dizajnin industrial dhe t'i ndalojë personat e tretë që ta shfrytëzojnë dizajnin industrial pa pajtimin e tij.

(2) Shfrytëzimi, sipas paragrafit (1) të këtij neni, përfshin punim të posaçëm, ofertë, lëshim në qarkullim, eksport, import ose shfrytëzim të prodhimit në të cilin dizajni është i përmbajtur ose në të cilin dizajni është i zbatuar ose magazinimin e prodhimeve të tyre për qëllime të caktuara.

(3) Nëse shpallja e dizajnit industrial është prolonguar sipas nenet 155 të këtij ligji, për kohëzgjatjen e shpalljes së prolonguar, bartësi ka të drejtë që t'i pengojë personat etretë në marrjen e punëve nga paragrafi (2) i këtij neni, vetëm nëse ai shfrytëzim është rezultat i kopjimit të dizajnit industrial.

Përrjashtimi i cenimit të së drejtës për dizajnin industrial

Neni 167

Nuk llogaritet për cenim të të drejtave ekskluzive të bartësit të dizajnit industrial, nëse prodhimet e punuara sipas dizajnit industrial, janë përdorur në konstrukcion ose pajisje për anije, aeroplanë ose automjete tokësore që iu takojnë ndonjërit nga vendet e Unionit të Parisit ose të OTB-së, kur ky mjet transportues përkoëhësisht ose rastësisht do të gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, me kusht që prodhimi i futur të shërbejë ekskluzivisht për nevojat e atij mjeti transportues.

Kufizimet e të drejtave ekskluzive nga dizajni industrial

Neni 168

Të drejtat ekskluzive nga neni 166 i këtij ligji, nuk zbatohen gjatë shfrytëzimit të dizajnit industrial për:

- 1) qëllimet private dhe jokomerciale;
- 2) informimin e opinionit ose për qëllime të arsimimit, nëse ajo është në pajtim me zakonet e mira afariste dhe nuk i dëmton interesit e bartësit të së drejtës dhe autorit;
- 3) qëllimet eksperimentale dhe shkencore.

E drejta në bazë të shfrytzimit paraprak

Neni 169

(1) Bartësi i së drejtës nuk mund të thirret në të drejtat ekskluzive ndaj personit të tretë, i cili e ka shfrytëzuar dizajnin e njëjtë, ose i ka kryer të gjitha përgatitjet për shfrytëzimin e dizajnit të njëjtë të prodhimit, para ditës së parashtrimit të fletëparaqitjes në Ent, ose para të drejtës së fituar të përparësisë, nëse është kërkuar me kusht që personi i tretë ta ketë punuar prodhimin pa ditur për ekzistimin e dizajnit industrial, i cili në atë kohë nuk ka qenë i kapshëm për opinionin.

(2) Personi i tretë nuk mund ta shfrytzojë dizajnin nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë që i kalon kufijtë e veprimtarive të rregullta prodhuese.

(3) Personi i cili ka të drejtë në bazë të shfrytëzimit të mëparshëm, nuk mund t'i japë licencë personit të tretë për shfrytëzim të dizajnit

(4) E drejta e shfrytëzimit të mëparshëm nuk mund të bartet, vetëm nëse ëbashë me të drejtën e bartjes bartet edhe ndërmarrja ose punëtorja në të cilën është e përgaditur gjegjësisht ka filluar shfrytëzimi i atij dizajni.

Tolerimi i përdorimit

Neni 170

(1) Bartësi i dizajnit të njohur të mëparshëm, nuk do të ketë të drejtë të kërkojë anulimin e dizajnit të njohur industrial të mëvonshëm, në bazë të së drejtës së vet në përparësi as të ndalojë përdorimin e dizajnit industrial të pranuar të mëvonshëm të njëjtë ose të ngjajshëm, , nëse në kohën prej pesë vitesh me vetëdije e ka toleruar atë përdorim, përveç nëse dizajni i mëvonshëm industrial është mbrojtur në mënyrë të pandërgjegjshme.

(2) Bartësi i dizajnit industrial të mëvonshëm, nuk ka të drejtë t'ia ndalojë përdorimin bartësit të dizajnit industrial të pranuar paraprakisht.

Shterja e së drejtës

Neni 171

Bartësi i të drejtës së dizajnit industrial nuk ka të drejtë që ta ndalojë qarkullimin e prodhimeve në të cilat është aplikuar dizajni, nëse ai vet i ka lëshuar në tregun vendor, ose nëse ato janë lëshuar në treg me miratimin e tij, përveç nëse vjen te ndryshimi i karakterit të dizajnit.

Vlefshmëria e dizajnit industrial

Neni 172

(1) Dizajni industrial vlen pesë vite nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes.

(2) Vlefshmëria e dizajnit industrial mund të vazhdohet në periudha prej pesë vitesh, por jo më shumë se 25 vite.

(3) Bartësi i dizajnit industrial parashtron kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë, gjatë vitit të fundit nga vlefshmëria e mbrojtjes dhe parashtron

dëshmi për pagesën e taksës së përcaktuar dhe shpenzimeve të procedurës për vazhdim.

(4) Kërkesa për vazhdim mund të parashtrohet edhe në afat prej gjashtë muaj, pas skadimit të vlefshmërisë, me pagesë të taksës plotësuese.

(5) Vlefshmëria e re për mbrojtje fillon të rrjedhë në ditën e ardhshme pas skadimit të vlefshmërisë së periudhës së mëparshme, regjistrohet në regjistër dhe shpallet në organin zyrtar të Entit.

(6) Forma dhe përmbajtja e kërkesës për vazhdim, përcaktohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Shuarja e vlefshmërisë e së drejtës së dizajnit industrial

Neni 173

(1) E drejta për dizajn industrial pushon të vlejë:

1) nëse skadon afati për vlefshmëri të dizajnit industrial, në pajtim me nenin 172 të këtij ligji;

2) në bazë të deklaratës me shkrim të bartësit të së drejtës me të cilën tërhiqet nga e drejta e dizajnit industrial, edhe atë ditën e ardhme nga dita e parashtrimit në Ent dhe;

3) nëse personi juridik që është bartës i së drejtës së dizajnit industrial, e ka pushuar me punën nga dita e shuarjes, përkatësisht nëse personi fizik i cili është bartës i së drejtës së dizajnit industrial ka vdekur-me ditën e vdekjes, ose nëse personi i zhdukur i cili është bartës i së drejtës së dizajnit industrial është shpallur i vdekur - nga dita të plotfuqishmërisë së aktvendimit, përveç nëse ajo e drejtë ka kaluar te pasardhësit juridikë të personit juridik, përkatësisht te pasardhësit e personit fizik.

(2) Shuarja e vlefshmërisë së dizajnit industrial, regjistrohet në Regjistrin për dizajn industrial.

Të drjetat e personave të tretë

Neni 174

(1) Nëse në regjistrin e dizajnit industrial është regjistruar licenca , pengu ose ndonjë e drejtë tjetër në dobi të personit të tretë, bartës i dizajnit industrial , nuk mund të tërhiqet nga të drejtat e tij pa pëlqim me shkrim nga personi në emër të të cilit është regjistruar licenca, pengu ose e drejta tjetër.

(2) Nëse bartësi i dizajnit industrial në afat të caktuar nuk e paguan taksën e përcaktuar, kurse në regjistër është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër në dobi të personit të tretë, Enti do ta lajmërojë atë person se taksa nuk është e paguar dhe se mundet ta paguajë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e lajmërimit dhe me atë ta mbajë të drejtën e regjistruar.

(3) Në rast të kontestit për sigurimin e të drejtave të regjistruara të personit të tretë, gjyqi mundet, nëse ajo është e domosdoshme për ato të drejta, të vendosë që e drejta e dizajnit industrial ta bartet te personi në emër të të cilit është regjistruar licenca, pengu ose e drejta tjetër ,deri në sigurimin e kërkesave.

PJESA E KATËRT

MARKA TREGTARE

Lënda e mbrojtjes

Neni 175

(1) Me markë tregtare mbrohet shenja e cila mund të paraqitet grafikisht dhe që është e përshtatshme për dallimin e mallrave dhe shërbimeve të një pjesëmarrësi në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve të pjesëmarrësit tjetër në qarkullim.

(2) Me markën tregtare mbrohen shenjat e përshtatshme për dallim siç janë: fjalët, shkronjat, numrat, pikturat, vizatimet, kombinime të ngjyrave, forma tredimensionale, dukepërfshirë edhe forma të mallrave ose paketime të tyre, si dhe kombinime të të gjitha shenjave të shënuara më parë.

(3) Fjalët dhe shkronjat nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të shkruhen në cilëndo gjuhë dhe me cilëndo shkrim.

Distinktiviteti

Neni 176

(1) Shenja është e përshtatshme për të dalluar nëse mallërave ose shërbimeve të njëlojta ose të ngjashme u jep karakter distinktiviteti të veçantë.

(2) Gjatë vlerësimit vallë ndonjë shenjë është e përshtatshme për të dalluar, merren parasysh të gjitha rrethanat, e veçanërisht koha dhe sasia e përdorimit të tij të deriatëhershëm në qarkullim.

Arsyet absolute për refuzim

Neni 177

(1) Me markë tregtare nuk mund të mbrohet shenja:

- 1) shpallja ose përdorimi i së cilës është në kundërshtim me rendin publik ose moralin;
- 2) e cila nuk mund të paraqitet grafikisht;
- 3) e cila nuk është distinktive, përkatsisht e përshtatshme për dallimin e mallrave dhe shërbimeve në qarkullim;
- 4) e cila e shënon vetëm llojin e mallrave, përkatsisht shërbimeve, dedikimin e tyre, kohën ose mënyrën e prodhimit, prejardhjen gjeografike, kualitetin, çmimin, sasinë dhe peshën;
- 5) e cila është bërë e rëndomtë në të folmen e përditshme ose në praktikën e vendosur tregtare për shënimin e llojit të caktuar të mallrave, përkatsisht shërbimeve;
- 6) e cila përbëhet ekskluzivisht nga forma që rrjedh nga lloji i mallrave ose forma e mallrave e nevojshme për arritje të rezultatit të caktuar teknik, ose forma e cila u jep vlerë thelbësore mallrave;
- 7) e cila me pamjen e saj mund të shkaktojë huti në qarkullim, e veçanërisht ta hutojë konsumuesin mesatar në aspekt të

prejardhjes gjeografike, llojit, kualitetit ose llojeve të tjera të mallrave dhe shërbimeve;

- 8) e cila përmban ose përbëhet nga shenja gjeografike e cila shërben për shënimin e verërave ose të pijeve të forta alkoolike, nëse shenja e paraqiturka të bëjë me verëra dhe pije të forta alkoolike të cilat nuk janë nga ai territor gjeografik;
- 9) e cila mban vulë ose vulë katrore, shenja oficiele dhe vula metalike për kontroll dhe garanci të kualitetit ose i imiton;
- 10) e cila përmban tjetër stemë shtetërore ose tjetër publike, flamur ose emblemë, emër ose shkurtesë emri të ndonjë organizate ndërkombëtare si dhe imitimet e tyre, sipasnenit 6-ter nga Konventa e Parisit, përveç me leje të organit kompetent të shtetit ose organizatës përkatëse;
- 11) e cila përmban emrin ose shkurtesën e emrit, stemën shtetërore, flamurin, amblemin ose shenjën tjetër zyrtare të Republikës së Maqedonisë, si dhe imitimin e tyre, përveç me leje nga organi kompetent i administratës shtetërore;
- 12) e cila përmban ose imiton personalitet ose emër të personit historik të famshëm ose personalitetit të vdekur nga Republika e Maqedonisë, përveç me leje nga organi kompetent i administratës shtetërore;
- 13) e cila përmban ose imiton emër, formë ose pjesë tjetër të njohur të trashigimisë së mbrojtur kulturore të Republikës së Maqedonisë, përveç me leje të organit kompetent të administratës shtetërore;
- 14) që përmban simbole religjioze ose i imiton.

(2) Shenjat e shënuara në pikat 3), 4), 5) nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të mbrohen si markë tregtare vetëm nëse parashtruesi i fletëparaqitjes, shenja ka arritur distinktivitet gjatë përdorimit shumëvjeçar.

(3) Organ kompetent për dhënie të lejës nga paragrafi (1) pika 11) dhe 12) të këtij neni, është Ministria e Drejtësisë.

(4) Organ kompetent për dhënie të lejes nga paragrafi (1) pika 13) e këtij neni është Drejtoria për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

Arsyet relative për refuzim

Neni 178

(1) Me markë tregtare nuk mund të mbrohet asnjë shenjë:

- 1) që është identike me markën tregtare të paraqitur më herët ose të regjistruar të personit tjetër për llojin e njëjtë të mallrave ose të shërbimeve, dhe
- 2) që është identike me markën tregtare të paraqitur më herët ose të regjistruar të personit tjetër për llojin e njëjtë ose të ngjashëm të mallrave, përkatësisht shërbimeve nëse kjo ngjashmëri nuk mund të krijojë huti te konsumuesi mesatar, duke përfshirë edhe mundësinë nga asociacioni me markën tregtare të paraqitur ose të regjistruar më herët.

(2) Marka tregtare e paraqitur më herët do të jetë arsyeja për refuzim në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni vetëm nëse do të jetë e regjistruar.

(3) Me nocionin "markë tregtare e paraqitur ose e regjistruar më herët " nënkuptohet:

- 1) markat tregtare të cilat gëzojnë të drejtën e përparësisë sipas dispozitave të këtij ligji;
- 2) markat tregtare ndërkombëtare të regjistruara më herët me veprim në Republikën e Maqedonisë, dhe
- 3) markat tregtare të cilat gjatë kohës së parashtrimit të fletëparaqitjes së markës tregtare për shenjën nga paragrafi (1) të këtij neni janë mirë të njohura në Republikën e Maqedonisë në kornizë të rëndësisë së nenit 6-bis nga Konventa e Parisit përkatësisht nenit 16 (2) të Marrëveshjes TRIPs.

(4) Me markën tregtare nuk mund të mbrohet asnjë shenjë e cila është identike ose e ngjashme me markën tregtare të regjistruar më herët të personit tjetër për mallra përkatësisht shërbime të cilat nuk janë të identike, as të ngjashme me mallrat, përkatësisht shërbimet për të cilat shënja është paraqitur, nëse marka tregtare e regjistruar më herët ka reputacion në Republikën e Maqedonisë dhe nëse përdorimi i kësaj shenje pa shkaqe të arsyeshme do të paraqiste konkurrencë jolojale ose do ta dëmtonte karakterin e distinktiv ose reputacionin e markës tregtare.

(5) Me markë tregtare nuk mund të mbrohet as shenja me të cilën cenohen të drejtat e fituara më parë të:

- 1) bartësi i markës tregtare e regjistruar në ndonjë vend anëtar i Unionit të Parisit ose të OTB, për të cilën në Republikën e Maqedonisë përfaqësuesi i saj, përkatësisht përfaqësuesi parashtron fletëparaqitje pa pëlqimin e tij;
- 2) personi fizik emri, mbiemri ose personalitet i tij është identik ose i ngjashëm me shenjën e shpallur;
- 3) bartësi i së drejtës të mbrojtur më parë nga pronësia industriale, nëse lënda e kësaj të drejte është identike ose e ngjashme me shenjën e shpallur, dhe
- 4) personi i cili ka të drejtë autoriale të veprës e cila është identike ose e ngjashme me shenjën e shpallur.

(6) Me markë tregtare nuk mund të mbrohet as shenja e cila është identike ose e ngjashme me markën tregtare validiteti i së cilës ka pushuar për shkak të afatit të skaduar të validitetit, kurse bartësi i së drejtës në afatin e paraparë nuk paraqitur kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë dhe nuk e ka paguar kompensimin e caktuar, nëse fletëparaqitja e markës tregtare është paraqitur para kalimit të nëntë muajve, duke llogaritur nga dita e pushimit të validitetit të markës tregtare përveç nëse mbrojtjen e kësaj shenje nuk e kërkon bartësi në emër të të cilit marka tregtare ka qenë e regjistruar ose trashëgimtari i tij juridik.

(7) Në shkaqet për përjashtimin nga mbrojtja me markën tregtare sipas këtij neni mund të thirret vetëm bartësi i fletëparaqitjes së parashtruar më parë ose bartësi i së drejtës së fituar më parë.

Parashtruesi i fletëparaqitjes

Neni 179

Procedurë për fitimin e të drejtës së markës tregtare mund të mbajë personi juridik dhe fizik.

Mbajtja e procedurës

Neni 180

(1) Procedura për njohjen e markës tregtare mbahet me parashtrimin e fletëparaqitjes së markës tregtare në Ent.

(2) Procedura për njohjen e së drejtës të markës tregtare mund të mbahet edhe me parashtrimin e fletëparaqitjes në pajtueshmëri me Marrëveshjen e Madridit dhe me Protokollin e Madridit.

(3) Për secilën shenjë për të cilën kërkohet mbrojtje parashtrohet fletëparaqitje e veçantë.

(4) Me një fletëparaqitje të njëjtë të markës tregtare për një shenjë të njëjtë mund të kërkohet mbrojtje për më shumë prodhime dhe shërbime.

Përmbajtja e fletëparaqitjes

Neni 181

(1) Fletëparaqitja e markës tregtare patjetër duhet të përmbajë:

- 1) kërkesën për njohjen e së drejtës së markës tregtare;
- 2) të dhënat për parashtruesin e fletëparaqitjes;
- 3) pamjen e shenjës për të cilën kërkohet mbrojtje, dhe
- 4) listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat kërkohet mbrojtje.

(2) Ndaj fletëparaqitjes nga paragrafi (1) të këtij neni parashtrohet edhe pjesë përbërëse dhe shtojca të tjera.

(3) Përmbajtja dhe forma e fletëparaqitjes dhe pjesëve përbërëse dhe shtojcave të tjera ndaj fletëparaqitjes përcaktohen me dispozitë të cilët e miraton drejtori i Entit.

Data e parashtrimit të fletëparaqitjes

Neni 182

(1) Nëse fletëparaqitja nuk e ka përmbajtjen e paraparë në nenin 181 paragrafi (1) të këtij ligji, Enti do ta njoftojë parashtruesin se fletëparaqitja e tij nuk është në rregull dhe nuk mund të njihet data e parashtrimit.

(2) Nëse për fletëparaqitjen e markës tregtare nuk mund të njihet data e parashtrimit, Enti do të thërrasë parashtruesin që në afat prej 30 ditësh nga pranimi i njoftimit t'i eliminojë mangësitë e vërtetuara në pajtueshmëri me nenin 181 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Nëse parashtruesi i eliminon mangësitë në afatin e paraparë, Enti do të verifikojë datën e parashtrimit të fletëparaqitjes.

(4) Si datë e parashtrimit do të llogaritet data në të cilën parashtruesi i ka eliminuar mangësitë e vërtetuara, përkatësisht ka vepruar në pajtim me njoftimin, në kuptim të nenit 181 paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Nëse parashtruesi në afatin nga paragrafi (2) të këtij neni nuk i eliminon mangësitë, do të konsiderohet se fletëparaqitja është tërhequr dhe do të miratohet konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

Ndryshime në fletëparaqitjen e markës tregtare të cilat nuk lejohen

Neni 183

Në fletëparaqitjen e markës tregtare në të cilën është e vërtetuar data e parashtrimit nuk mund të ndryshohet në mënyrë plotësuese ligji, e as të plotësohet lista e prodhimeve, përkatësisht shërbimeve.

Regjistrimi i fletëparaqitjes në Regjistrin e fletëparaqitjeve të markave tregtare

Neni 184

(1) Fletëparaqitja e markës tregtare regjistrohet në Regjistrin e fletëparaqitjeve të markave tregtare.

(2) Përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të fletëparaqitjeve të markave tregtare dhe të akstraktit nga regjistri verifikohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Ndarja e fletëparaqitjes së markës tregtare

Neni 185

(1) Fletëparaqitja e markës tregtare, me kërkesën e parashtruesit gjatë procedurës për njohjen e së drejtës së markës tregtare mund të ndahet dy ose më shumë fletëparaqitje në lidhje me listën e propozuar të mallrave dhe shërbimeve.

(2) Fletëparaqitjet e ndara mbajnë të drejtën e përparësisë nga fletëparaqitja e parë.

(3) Kërkesa për ndarjen e fletëparaqitjes lejohet në rast kur parashtruesi n fletëparaqitjen e parë ka parashtruar kërkesë për mbrojtje e një shenje për më shumë mallra ose shërbime nga Klasifikimi ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve.

(4) Kërkesa për ndarjen e fletëparaqitjes mund të parashtroj më së voni deri në miratimin e aktvendimit për njohjen e së drejtës së markës tregtare.

(5) Për ndarjen e ndarjen e fletëparaqitjes së markës tregtare Enti do të miratojë aktvendim të posaçëm dhe do ta regjistrojë fletëparaqitjen e ndarë të markës tregtare në Regjistrin e fletëparaqitjeve të markave tregtare.

(6) Përmbajtja e kërkesës për ndarjen e fletëparaqitjes verifikohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

E drejta e përparësisë

Neni 186

Nëse fletëparaqitja e markës tregtare është parashtruar në pajtueshmëri me nenin 181 paragrafi (1) të këtij ligji, parashtruesi i fletëparaqitjes fiton të drejtën e përparësisë nga data e parashtrimit të fletëparaqitjes në lidhje me çdo tjetër i cili për shenjë identike ose të ngjashme

dhe për prodhime ose shërbime të identike ose të ngjashme më vonë do të parashtrorjë fletëparaqitje.

E drejta përparësisë së Unionit

Neni 187

(1) Personit fizik ose juridik i cili në ndonjërin nga vendet anëtare të Unionit të Parisit ose të OTB ka parashtruar fletëparaqitje në mënyrë të rregullt, në Republikën e Maqedonisë do t'i njihet e drejta e përparësisë nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë, nëse këtë e kërkon në afat prej gjashtë muajsh nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes së parë.

(2) Ai i cili ka për qëllim ta shfrytëzojë të drejtën e përparësisë nga paragrafi (1) të këtij neni, është i obliguar që në fletëparaqitjen e parashtruar në Republikën e Maqedonisë t'i evidentoj të gjitha të dhënat për fletëparaqitjen në të cilën thirret (shtetin, datën dhe numrin e fletëparaqitjes) dhe në afat prej 90 ditësh nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes të deponojë kopje të fletëparaqitjes së parë të verifikuar nga organi kompetent i vendit anëtar i Unionit Parisit ose të OTB në të cilën është parashtruar fletëparaqitja e parë, si dhe përkthimin e fletëparaqitjes së parë të gjuhës maqedonase.

E drejta e përparësisë së panairit

Neni 188

(1) Personi i cili në ekspozitë zyrtarisht të pranuar ose panair me karakter ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë ose në ndonjë vend anëtar të Unionit të Parisit ose të OTB ekspozon prodhime ose shërbime të shënuara me shenjë të caktuar, në afat prej tre muajsh nga dita e mbylljes së ekspozitës (panairit), me fletëparaqitjen mund të kërkojë të drejtën e përparësisë nga dita e parë e ekspozimit të prodhimeve, përkatësisht dhënies së shërbimeve.

(2) Ndajë fletëparaqitjes nga paragrafi (1) të këtij neni patjetër duhet të dorëzohet vërtetim me shkrim nga organi kompetent i vendit anëtar të Unionit të Parisit ose të OTB se është në pyetje ekspozita e zyrtarisht e njohur (panair), në kuptim të Konvencës për ekspozita ndërkombëtare me theksimin e të dhënave për llojin e ekspozitës (panairit), vendi i mbajtjes së saj, dita e hapjes dhe dita e mbylljes dhe për ditën e parë të ekspozimit të prodhimeve ose të shërbimeve të evidentuara në fletëparaqitje.

(3) Me njohjen e së drejtës së përparësisë nga ky nen, nuk vazhdojnë afatet nga neni 187 të këtij ligji.

Vërtetimi për të drejtën e përparësisë

Neni 189

(1) Enti me kërkesën e parashtruesit të fletëparaqitjes lëshon vërtetim për të drejtën e përparësisë i cili llogaritet nga dita e caktuar si datë e parashtrimit të fletëparaqitjes së markës tregtare.

(2) Përmbajtja e kërkesës dhe e vërtetimit të së drejtës së përparësisë verifikohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Renditja e veprimit ndaj fletëparaqitjeve

Neni 190

(1) Fletëparaqitjet e markës tregtare merren në procedurë sipas renditjes së caktuar me datën e parashtrimit të tyre.

(2) Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi (1) të këtij neni, fletëparaqitja mund të merret në procedurë menjëherë kur:

1) ekziston kontest në lidhje me të drejtën nga fletëparaqitja;

2) është parashtruar kundërshtimi ndaj fletëparaqitjes së shpallur të markës tregtare, ndërsa baza e kundërshtimit më herët paraqitur marka tregtare, dhe

3) në pajtueshmëri me dispozita tjera është e domosdoshme të kryhet regjistrimi i parakohshëm i markës tregtare.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) pikat 1 dhe 3 të këtij neni, parashtrohet kërkesë për marrjen e fletëparaqitjes menjëherë në procedurë dhe paguhet taksë.

Fletëparaqitje e rregullt

Neni 191

Fletëparaqitja e markës tregtare është e rregullt nëse është:

1) përpiluar ashtu që i përmban të gjitha pjesët e nevojshme përbërëse dhe shtojcat e parapara me nenin 181 të këtij ligji dhe dispozitën që e miraton drejtori i Entit;

2) autorizimi i parashtruar në mënyrë të rregullt, nëse fletëparaqitja është parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit, dhe

3) taksa e paguar në mënyrë të rregullt për fletëparaqitjen dhe dëshmia për pagesën e kryer.

Kontrolli formal i fletëparaqitjes

Neni 192

(1) Pas regjistrimit të fletëparaqitjes së markës tregtare në regjistrin e fletëparaqitjeve, Enti kontrollon se a është në rregull sipas nenin 191 të këtij ligji.

(2) Nëse dëshmon se fletëparaqitja nuk është në rregull, Enti e thërret parashtruesin e fletëparaqitjes që në afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë duke llogaritur nga dita e pranimit të thirrjes, t'i mënjanojë parregullësitë e dëshmuara.

(3) Me kërkesën e arsyetuar të parashtruesit të fletëparaqitjes, afati nga paragrafi (1) të këtij neni, për shkaqë të arsyeshme mund të vazhdohet më së shumti edhe për 60 ditë.

(4) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e përcaktuar e rregullon fletëparaqitjen, do të konsiderohet se fletëparaqitja është parashtruar në mënyrë të rregullt.

(5) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e caktuar nuk i mënjanon të gjitha mangësitë që ka qenë i obliguar t'i mënjanojë sipas paragrafit 1 të këtij neni, fletëparaqitja me aktvendim do të hedhet poshtë.

Kontrolli i kushteve për pranimin e së drejtës

Neni 193

Nëse fletëparaqitja është në rregull sipas nenit 191 të këtij ligji, Enti kontrollon se a janë plotësuar kushtet për njohjen e së drejtës së markës tregtare.

Aktvendimi për anulimin e fletëparaqitjes

Neni 194

(1) Nëse shenja e paraqitur nuk mund të njihet në lidhje me të gjitha ose në lidhje me disa prodhime të prodhimeve ose shërbime të përmendura për shkaqet e përmendura në nenin 177 të këtij ligji, Enti merr aktvendim për anulimin e fletëparaqitjes.

(2) Aktvendim për anulimin e fletëparaqitjes nuk mund të merret nëse paraprakisht, me shkrim, nuk e ka njoftuar parashtruesin e fletëparaqitjes me shkaqet për shkak të së cilave nuk mund të njihet e drejta e kërkuar, përkatësisht nuk mund të njihet e drejta në sasinë e kërkuar dhe nëse nuk e ka thërritur që në afatin e caktuar të deklarohet për këto shkaqe.

(3) Nëse shenja e paraqitur nuk përmban element që nuk është distinktiv, as i përshtatshëm për dallimin e mallrave, përkatësisht të shërbimeve në qarkullimin dhe nëse përfshirja e këtij elementi mund të shkaktojë dyshim në lidhje me sasinë e mbrojtjes së markës tregtare, Enti mund ta thërrasë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afatin e caktuar të parashtrorë deklaratë me shkrim se nuk kërkon të drejta të ekskluzive të këtij elementi.

(4) Afati nga paragrafi 2 i këtij neni, me kërkesën e arsyetuar nga parashtruesi i kërkesës mund të vazhdohet më së shumti deri në 6 muaj.

Pagesa e shpenzimeve dhe shpallja e fletëparaqitjes

Neni 195

(1) Nëse fletëparaqitja e markës tregtare i plotëson kushtet nga neni 191 të këtij ligji, dhe nëse shenja nuk është përjashtuar nga mbrojtja në kuptim të nenit 126 të këtij ligji, Enti do ta thërrasë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afatin e caktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, t'i paguajë shpenzimet për shpalljen e të dhënave nga fletëparaqitja në fletoren zyrtare të Entit.

(2) Nëse parashtruesi nuk i paguan harxhimet nga paragrafi (1) të këtij neni, Enti do të marrë aktvendim për hedhjen poshtë të fletëparaqitjes.

(3) Nëse parashtruesi vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, Enti më së voni në afat prej 90 ditësh do t'i shpallë të dhënat nga fletëparaqitja në Fletoren zyrtare të Entit.

(4) Të dhënat nga fletëparaqitja të cilat shpallen në fletoren zyrtare të Entit, përcaktohen me dispozitë, të cilën e miraton drejtori i Entit.

Vërejtjet nga personat e tretë

Neni 196

(1) Pas shpalljes së fletëparaqitjes çdo personjuridik ose fizik Entit mund t'i parashtojë vërejtje me shkrim në të cilat do t'i arsyetojë shkaqet në kuptim të nenit 177 paragrafi (1) për shkak të së cilave konsideron se shenja e paraqitur nuk mund të njihet.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk janë palë në procedurë.

(3) Vërejtjet nga paragrafi (1) i këtij neni Enti ia dërgon parashtruesit të fletëparaqitjes, i cili mund të dërgojë përgjigje për vërejtjet.

Kundërshtimi

Neni 197

(1) Kundërshtim ndaj fletëparaqitjes së shpallur të markës tregtare Entit në afat prej 90 ditësh nga dita e shpalljes mund të parashtojë:

1) parashtruesi i markës tregtare të paraqitur më parë dhe bartësi i firmës së regjistruar më parë në kuptim të nenit 178 paragrafët nga (1) deri në (4) të këtij ligji;

2) bartësi i markës tregtare të regjistruar në ndonjë vend anëtar të Unionit të Parisit ose të OTB, për të cilën në Republikën e Maqedonisë përfaqësuesi i saj, përkatësisht përfaqësuesi ka parashtruar fletëparaqitje pa pëlqimin e tij;

3) personi fizik emri, mbiemri ose fytyra e të cilit është identike ose e ngjashme me shenjën e shpallur;

4) bartësi i së drejtës së mbrojtur më parë nga pronësia industriale, nëse lënda e kësaj të drejte është identike ose e ngjashme me shenjën e shpallur,

5) personi i cili ka të drejtën e autorit të veprës i cili është identik ose i ngjashëm me shenjën e shpallur; dhe

6) bartësi markës tregtare vlefshmëria e së cilës ka pushuar për shkak të afatit të skaduar të vlefshmërisë në kuptim të nenit 178 paragrafi (6) të këtij ligji.

(2) Afati për parashtrimin e kundërshtimit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të vazhdohet.

(3) Për çdo fletëparaqitje të shpallur të markës tregtare parashtrohet kundërshtim i veçantë.

(4) Përmbajta e kundërshtimit dhe mënyra e parashtrimit të kundërshtimit përcaktohen më dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Kontrollimi i fletëparaqitjes

Neni 198

(1) Enti kontrollon se kundërshtimi a është parashtruar nga personi i cili ka të drejtë për parashtrimin e kundërshtimit sipas nenit 197 paragrafi (1) të këtij ligji dhe kundërshtimi a është parashtruar në afatin e caktuar.

(2) Nëse nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi (1) të këtij neni, Enti merr aktvendim për hedhjen poshtë të kundërshtimit.

(3) Nëse janë plotësuar kushtet nga paragrafi (1) të këtij ligji, Enti e lajmëron parashtruesin e kundërshtimit të markës tregtare për shkaqet e përmendura në kundërshtimin dhe e thërret që në afat të caktuar i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë të deklarohet për shkaqet e përmendura.

(4) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e paraparë nga paragrafi (3) të këtij neni nuk deklarohet për shkaqet e përmendura në kundërshtim, Enti do të vendosë në bazë të provave në kundërshtim.

Vendosja ndaj kundërshtimit

Neni 199

(1) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes deklarohet për shkaqet e përmendura në kundërshtim, Enti e kontrollon arsyen e kundërshtimit, duke i marrë parasysh shkaqet ndaj kundërshtimit dhe përgjigjen ndaj kundërshtimit.

(2) Nëse Enti vërteton se kundërshtimi është i pabazë, kundërshtimi me aktvendim refuzohet.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (2) të këtij neni dorëzohet parashtruesit të fletëparaqitjes dhe parashtruesit të kundërshtimit.

(4) Nëse Enti në procedurën e kontrollimit të kundërshtimit konstaton se kundërshtimi është themelore bazë, e hedh poshtë fletëparaqitjen e markës tregtare dhe për këtë i dorëzon aktvendim parashtruesit të fletëparaqitjes dhe parashtruesit të kundërshtimit.

Marrja e vendimit dhe regjistrimi në regjistrin e markave tregtare

Neni 200

(1) Nëse shkaqet e parapara në nenet 177 paragrafi (1) dhe 178 paragrafët nga (1) deri në (6) të këtij ligji nuk paraqesin pengesë për njohjen e së drejtës së markës tregtare, Enti do ta lajmërojë parashtruesin e fletëparaqitjes se janë plotësuar kushtet për njohjen e së drejtës dhe do ta thërrasë që në afat prej 30 ditësh ta paguajë taksën për mbajtjen e së drejtës së markës tregtare në vlefshmëri për dhjetëvjeçarin e parë, shpenzimet për shpalljen e markës tregtare në fletoren e Entit dhe shpenzimet për lëshimin e dokumentit të markës tregtare.

(2) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e caktuar i paguan taksën dhe shpenzimet nga paragrafi (1) të këtij neni, Enti do të marrë aktvendim për njohjen e së drejtës së markës tregtare dhe të drejtën e njohur do ta regjistrojë në regjistrin e markave tregtare.

(3) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes nuk i paguan taksat dhe shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij ligji, Enti do të marrë aktvendim me të cilën do ta hedhë poshtë fletëparaqitjen.

(4) Përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të markës tregtare, si dhe përmbajtja dhe forma e certifikatës nga regjistri verifikohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit

Regjistrimi i ndryshimeve në regjistër

Neni 201

(1) Në regjistrin e fletëparaqitjeve të markave tregtare dhe në regjistrin e markave tregtare regjistrohen ndryshimet të cilat kanë të bëjnë me parashtruesin e fletëparaqitjes, bartësin e së drejtës dhe me atë të drejtë.

(2) Ndryshimet të cilat regjistrohen në regjistrin e fletëparaqitjeve të markave tregtare pas shpalljes së fletëparaqitjes dhe ndryshimeve të cilat regjistrohen në regjistrin e markave tregtare shpallen në fletoren zyrtare të Entit.

(3) Ndryshimet të cilat regjistrohen, përmbajtja dhe forma e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e ndryshimeve përcaktohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Fitimi i së drejtës së markës tregtare

Neni 202

(1) E drejta e markës tregtare fitohet me marrjen e aktvendimit për njohjen e së drejtës dhe me regjistrimin e markës tregtare në regjistër.

(2) Data e regjistrimit të markës tregtare në regjistër është e njëjtë me datën e marrjes së aktvendimit për njohjen e markës tregtare.

Shpallja e markës tregtare

Neni 203

(1) Të dhënat për markën tregtare shpallen në fletoren zyrtare të Entit më se voni në afat prej 90 ditësh nga data e regjistrimit të markës tregtare në regjistër.

(2) Të dhënat të cilat shpallen në fletoren zyrtare të Entit verifikohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Dokumenti për markën tregtare

Neni 204

(1) Bartësit të së drejtës së markës tregtare, Enti i lëshon dokument më se voni në afat prej 6 muajsh nga data e miratimit të aktvendimit për njohjen e së drejtës së markës tregtare.

(2) Përmbajtja e dokumentit për markën tregtare verifikohet me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Ndarja e markës tregtare të regjistruar

Neni 205

(1) Marka tregtare e regjistruar me kërkesën e bartësit mund të ndahet në dy ose më shumë marka tregtare lidhur me listën e propozuar të prodhimeve dhe shërbimeve.

(2) Kërkesa për ndarjen e markës tregtare të regjistruar mund të parashtrohet gjatë gjithë periudhës së mbrojtjes.

(3) Markat tregtare të regjistruara të ndara mbajnë të gjitha të drejtat nga marka e parë tregtare e regjistruar .

(4) Kërkesa për ndarjen e markës tregtare të regjistruar lejohet në rastin kur bartësi ka mbrojtur një markë tregtare për më shumë mallra ose shërbime nga klasifikimi ndërkombëtar u prodhimeve dhe shërbimeve.

(5) Për ndarjen markës tregtare të regjistruar Enti do të miratojë aktvendim të posaçëm dhe do ta regjistrojë markën tregtare të ndarë në regjistrin e markave tregtare.

(6) Përmbajtja e kërkesës për ndarjen e markës tregtare të regjistruar verifikohet me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Të drejtat ekskluzive

Neni 206

(1) Bartësi i markës tregtare ka të drejtë ekskluzive që ta shfrytëzojë markën në qarkullimin për t'u vënë shenja mallrave, përkatësisht shërbimeve të veta.

(2) Bartësi i markës tregtare ka të drejtë që krahas markës tregtare ta përdorë simbolin "R"

(3) Bartësi i markës tregtare ka të drejtë të ndalojë shfrytëzimin në qarkullim nga ana e personave të tretë pa pëlqimin e tij të shenjës e cila është:

1) identike me markën tregtare për prodhime ose shërbime identike;

2) identike ose ngjashme me markën tregtare për prodhime ose shërbime identike ose të ngjashme nëse kjo ngjashmëri mund të krijojë huti te konsumatori mesatar, duke përfshirë edhe mundësinë nga asociacioni ndërmjet shenjës dhe markës tregtare;

3) identike ose ngjashme me markën tregtare për prodhime ose shërbime të ndryshme, nëse marka tregtare ka reputacion në Republikën e Maqedonisë dhe nëse përdorimi i kësaj shenje pa shkaqe të arsyeshme paraqet konkurrencë jolojale ose e dëmton karakterin distinktiv ose reputacionin e markës tregtare.

(4) Ndalesa nga paragrafi (3) të këtij neni përfshin edhe:

1) vënien e shenjës në prodhimet ose në paketimet e tyre;

2) dhënien e shërbimeve ose lëshimin në qarkullim prodhime të shënuara më këtë shenjë ose magazinimin e prodhimeve me këtë qëllim;

3) importi ose eksporti i prodhimeve me këtë shenjë, dhe

4) shfrytëzimi i shenjës gjatë korrespondimit, shpalljes dhe reklamimit.

Kufizimi i së drejtës

Neni 207

(1) Marka tregtare nuk i jep të drejtë bartësit t'u ndalojë personave të tretë përdorimin në qarkullimin tregtar të emrave, mbiemrave, shenjave të tyre ose emrave tregtarë, adresave, vendqëndrimeve, të dhënave që kanë të bëjnë me llojin, kualitetin, sasinë, qëllimin, vlerën, prejardhjen gjeografike, datën e prodhimit të mallrave ose dhënien e shërbimeve, ose çfarëdo shënimi tjetër të mallrave, pa marrë parasysh faktin që këto të dhëna janë identike ose të ngjashme me markën tregtare, ose paraqesin pjesë të tyre me kusht që të shfrytëzohen në pajtim me traditat e mira afariste dhe mos të sjellin deri te konkurrenca jolojale.

(2) Marka tregtare nuk i jep të drejtë bartësit që t'u ndalojë personave të tretë përdorimin në qarkullim të shenjës që është identike ose e ngjashme me markën tregtare, nëse ajo është e nevojshme për shkak të shënimit të dedikimit të prodhimeve, posaçërisht të pjesëve të tyre rezervë ose llojit të shërbimeve të cilat jepen me kusht që ligji të shfrytëzohet në pajtim me traditat e mira afariste dhe të mos sjellin deri te konkurrenca jo lojale.

Tolerimi i përdorimit

Neni 208

(1) Bartësi i markës tregtare të regjistruar më parë nuk do të ketë të drejtë të kërkojë asgjësimin e markës së mëvonshme tregtare në bazë të së drejtës së tij të mëparshme të përparësisë, as të ndalojë përdorimin e markës tregtare të mëvonshme në lidhje me mallrat dhe shërbimet për të cilat marka e mëvonshme është shfrytëzuar nëse për kohën e pesë vitet të fundit me vetëdije e ka toleruar këtë përdorim, vetëm nëse marka e mëvonshme tregtare është e mbrojtur në mënyrë të pandërgjegjshme.

(2) Bartësi i markës tregtare me të drejtë të mëvonshme me përparësi nuk ka të drejtë t'ia ndalojë përdorimin e tij bartësit të markës tregtare të regjistruar më parë.

Shterimi i së drejtës

Neni 209

Bartësi i së drejtës së markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e markës tregtare për mallra ose shërbime të cilat ai vetë i ka lëshuar në tregun e vendit ose ato janë lëshuar në treg ose ato janë lëshuar në treg me lejen e tij, përveç nëse janë bërë ndryshime të rëndësishme të mallrave ose keqësimi i vetive, ose ndryshimi i karakterit të mallrave ose shërbimeve pas lëshimit të tyre në qarkullim.

Reproduksioni i markës tregtare në publikime

Neni 210

Nëse reproduksioni i markës tregtare të regjistruar në fjalorë, enciklopedi ose publikime të ngjashme krijon përshtypje se është emër

gjenetik i prodhimeve ose shërbimeve për të cilat marka është e regjistruar, botuesi i publikimit, me kërkesën e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, do të mundësojë që në botimin e parë të ardhshëm të publikimit, reproduksioni i markës tregtare të jetë i shoqëruar me shenjën se marka është e regjistruar.

Vlefshmëria e markës tregtare

Neni 211

(1) Marka tregtare vlen dhjetë vjet nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes.

(2) Vlefshmëria e markës tregtare mund të vazhdohet në numër të pakufizuar edhe atë për periudhën nga dhjetë vjet, me kusht që bartësi i së drejtës gjatë vitit të fundit nga dhjetëvjeçari i vlefshmërisë ose më së voni nëntë muaj nga skadimi i vlefshmërisë Entit t'i dorëzojë kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së markës tregtare dhe t'i paguaj taksat dhe shpenzimet përkatëse të procedurës.

(3) Periudha e re e mbrojtjes fillon ditën e ardhshme pas skadimit të ditës së fundit të periudhës së kaluar të mbrojtjes dhjetëvjeçare.

(4) Kur kërkesa për vazhdimin e vlefshmërisë së markës tregtare përfshin vetëm pjesë nga mallrat, përkatësisht shërbimet për të cilat marka tregtare është e regjistruar, vlefshmëria e markës tregtare do të vazhdohet vetëm për ato mallra, përkatësisht shërbime.

(5) Përmbajtja dhe forma e kërkesës për vazhdimin e vlefshmërisë së markës tregtare përcaktohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Shfrytëzimi i markës tregtare

Neni 212

(1) Bartësi i markës tregtare është i detyruar që për shkak të mbajtjes së markës tregtare në vlefshmëri, ta shfrytëzojë në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve për të cilat ajo është e regjistruar, përveç nëse ekzistojnë shkaqe serioze për mosshfrytëzim, pavarësisht nga vullneti i bartësit.

(2) Shfrytëzimi i markës tregtare në formë të ndryshuar në mënyrë të pa konsiderueshme me të cilën nuk ndryshohet karakteri distinktiv i markës tregtare dhe përdorimi i markës së prodhimeve dhe paketimeve ekskluzivisht me qëllim që të eksportohet, po ashtu konsiderohet për përdorim.

(3) Shfrytëzimi i markës tregtare nga ana e personit tjetër me leje nga bartësi i së drejtës do të konsiderohet për përdorim nga vetë bartësi.

Pushimi i vlefshmërisë së markës tregtare

Neni 213

(1) Marka tregtare pushon të vlejë:

1) kur bartësi i së drejtës pa shkaqe të arsyeshme nuk e shfrytëzon markën tregtare për për t'u vënë shenja prodhimeve, përkatësisht shërbimeve me të cilat ajo ka të bëjë më shumë se pesë vjet pandërprerë nga dita e

regjistrimit të markës tregtare në regjistrin e markave tregtare, përkatësisht nga dita kur marka tregtare për herë të fundit është shfrytëzuar:

2) kur për shkak të mosaktivitetit të bartësit të së drejtës është shndërruar në emër të zakonshëm në qarkullim për prodhimet, përkatësisht shërbimet për të cilat është regjistruar;

3) kur për shkak të mënyrës së përdorimit nga ana e bartësit të së drejtës ose me lejen e tij, për mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar, opinionin mund ta sjellë në mashtrim sa i përket llojit, kualitetit ose prejardhjes gjeografike të këtyre mallrave ose shërbimeve, dhe

4) kur marka tregtare kolektive shfrytëzohet në kundërshtim me aktin e përgjithshëm ose me marrëveshjen për markën tregtare kolektive.

(2) Përmbajtja e kërkesës për pushimin e vlefshmërisë nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohen me dispozitën të cilën e miraton drejtori I Entit.

Procedura ndaj kërkesës për pushimin e vlefshmërisë së markës tregtare

Neni 214

(1) Procedura pas kërkesës për pushimin e vlefshmërisë të markës tregtare nga neni 21 paragrafi (1) i këtij ligji udhëhiqet me kërkesën e personit të interesuar.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni i parashtrohet në formë të shkruar Entit.

(3) Enti është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës t'ia parashtroj kërkesën bartësit të së drejtës dhe ta thërras të deklarohet në afat të caktuar i cili nuk mundë të jetë më i gjatë se 60 ditë nga pranimi i njoftimit.

Aktvendimi për pushimin e së drejtës

Neni 215

(1) Pas procedurës së zbatuar nga neni 214 i këtij ligji, Enti miraton aktvendim për pushimin e vlefshmërisë së markës tregtare ose për anulimin e kërkesës.

(2) Marka tregtare pushon të vlejë me ditën e plotfuqishmërisë së aktvendimit për pushim të cilin e miraton Enti.

(3) Aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni regjistrohet në regjistrin e markave tregtare dhe shpallet në fletoren zyrtare të Entit.

Specifiteti i procedurës për shlyerjen e markës tregtare Për shkak të mosshfrytëzimit

Neni 216

(1) Në procedurën ndaj kërkesës për shlyerjen e markës tregtare për shkak të mosshfrytëzimit, bartësi i së drejtës është i obliguar të dëshmojë se e shfrytëzon markën tregtare.

(2) Aktvendimi për ndërprerjen e markës tregtare për shkak të mosshfrytëzimit nuk do të miratohet nëse shfrytëzimi i markës tregtare ka filluar ose ka vazhduar pas skadimit të periudhës pesëvjeçare të mosshfrytëzimit, por para parashtrimit të kërkesës për ndërprerjen e vlefshmërisë për shkak të mosshfrytëzimit, përveç nëse shfrytëzimi ka filluar ose ka vazhduar në periudhën prej tre muajsh para parashtrimit të kërkesës për ndërprerjen e markës tregtare, pasi bartësi i së drejtës ka kuptuar se do të parashtrohet kërkesë për ndërprerjen e markës tregtare.

Pushimi i vlefshmërisë së markës tregtare në baza të tjera

Neni 217

(1) Marka tregtare pushon të vlejë përveç në rastet nga neni 213 të këtij ligji edhe në rastet në vijim:

1) nëse skadon afati e vlefshmërisë, ndërsa bartësi i së drejtës në afatin e paraparë nuk parashtron kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së markës tregtare dhe nuk e paguan kompensimin e përcaktuar në pajtim me nenin 154 të këtij ligji-ditën vijuese nga dita e lëshimit të afatit për pagesë;

2) në bazë të deklaratës me shkrim të bartësit të së drejtës me të cilën heq dorë nga e drejta e markës tregtare – ditën vijuese nga dita e parashtrimit Entit;

3) nëse ka pushuar personi juridik i cili është bartës i së drejtës së markës tregtare – me ditën e pushimit, përkatësisht nëse personi fizik ka vdekur i cili është bartës i së drejtës së markës tregtare – me ditën e vdekjes, ose nëse personi i zhdukur i cili është bartës i së drejtës së markës tregtare është shpallur i vdekur – me ditën e plotfuqishmërisë së aktvendimit, përveç nëse kjo e drejtë ka kaluar mbi pasardhësit juridikë, përkatësisht mbi pasardhësit e personit fizik, dhe

4) në bazë të vendimit gjyqësor, përkatësisht aktit të Entit në rastet e parapara me këtë ligj – me ditën e caktuar në këtë vendim, përkatësisht akt.

Të drejtat e personave të tretë

Neni 218

(1) Nëse në regjistrin e markës tregtare është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër në dobi të personit të tretë, bartësi i markës tregtare nuk mund të heqë dorë nga të drejtat e veta pa pëlqimin me shkrim të personit në emrin e të cilit është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër.

(2) Nëse bartësi i markës tregtare në afatin e caktuar nuk e paguan taksën e përcaktuar, kurse në regjistër është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër në dobi të personit të tretë, Enti do ta njoftojë atë person se taksa nuk është paguar dhe se mund ta paguajë në afat prej 6 muajsh nga dita e njoftimit dhe me atë ta mbajë të drejtën e regjistruar.

(3) Në rast të kontestit për sigurimin e të drejtave të regjistruara të personit të tretë gjykata, nëse kjo është e domosdoshme për sigurimin e këtyre të drejtave, mund të vendosë që e drejta e markës tregtare t'i bartet

personit në emër të të cilit është regjistruar licenca, pengu ose ndonjë e drejtë tjetër, deri në sigurimin e kërkesave.

Lënda e mbrojtjes së markës kolektive

Neni 219

(1) Me markën kolektive mbrohet shenja e cila dedikohet për shënimin e përbashkët të prodhimeve ose shërbimeve nga ana e shoqatës ose asociacionit tjetër të personave fizikë dhe juridikë.

Parashtruesi i fletëparaqitjes së markës kolektive

Neni 220

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së markës kolektive mund të jetë shoqatë e vendit ose asociacion tjetër të personave fizikë dhe juridikë.

(2) Nën kushtet e këtij ligji, e në pajtim me konventat ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar ose ndaj të cilave ka aderuar Republika e Maqedonisë, parashtruesi i fletëparaqitjes së markës kolektive mund të jetë edhe person juridik i huaj.

Përmbajtja e fletëparaqitjes së markës kolektive

Neni 221

(1) Fletëparaqitjes së markës kolektive i bashkëngjitet akti i përgjithshëm ose marrëveshja për markë kolektive.

(2) Akti i përgjithshëm ose marrëveshje nga paragrafi (1) të këtij neni patjetër duhet të përmbajë: firmën përkatësisht emrin e parashtruesit të fletëparaqitjes dhe emrin e organit, përkatësisht të personit të autorizuar që ta përfaqësojë parashtruesin, dispozitat për pamjen e shenjës dhe për prodhimet, përkatësisht shërbimet me të cilat ka të bëjë shenja, dispozitat për atë se cili ka të drejtë ta përdorë markën kolektive dhe nën cilat kushte, dispozita për të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesve të markës kolektive në rast të cenimit të markës tregtare, si dhe dispozita për masat dhe pasojat në rast të mospërmbajtjes së dispozitave nga akti i përgjithshëm ose marrëveshja.

Regjistrimi i ndryshimeve të marrëveshjes për markën kolektive

Neni 222

(1) Me kërkesë të parashtruesit të fletëparaqitjes ose të bartësit të markës kolektive, Enti në regjistër e regjistron çdo ndryshim ose plotësim të marrëveshjes me të cilën përcaktohet përdorimi i markës kolektive.

(2) Të drejtat të cilat dalin nga marka kolektive nuk mund të barten as nuk mundë të jenë lëndë e licencës.

Lënda e mbrojtjes së markës së certifikuar

Neni 223

(1) Me markë të certifikuar mbrohet shenja që e shfrytëzojnë disa shoqata tregtare nën mbikëqyrje të bartësit të markës së certifikuar dhe shërben për mbrojtjen e kualitetit, prejardhjen, mënyrën e prodhimit ose karakteristika tjera të përbashkëta të mallrave ose shërbimeve të këtyre shoqatave tregtare

(2) Dispozita nga neni 177 paragrafi (4) të këtij ligji nuk do të zbatohet në markën e certifikuar.

Përmbajtja e fletëparaqitjes së markës së certifikuar

Neni 224

(1) Fletëparaqitjes së markës së certifikuar i bashkëngjiten dispozitat për shfrytëzimin e markës së certifikuar të cilat përmbajnë dispozita për: kualitetin, vetitë dhe karakteristikat e tjera të mallrave apo shërbimeve, masat për kontroll të cilat parashtruesi të fletëparaqitjes së markës së certifikuar do t'i shfrytëzojë dhe sanksionet të cilat do t'i zbatojë.

(2) Bartësi i së drejtës së markës së certifikuar nuk mund ta shfrytëzojë këtë markë për shënimin e mallrave dhe shërbimeve të cilat ai vetë i prodhon.

Regjistrimi ndërkombëtar

Neni 225

(1) Bartësi i markës tregtare, përkatësisht parashtruesi i fletëparaqitjes për njohjen e markës tregtare mund të parashtrojë fletëparaqitje për regjistrim ndërkombëtar të markës tregtare në pajtim me Marrëveshjen e Madridit dhe Protokollin e Madridit për të cilat ka aderuar Republika e Maqedonisë.

(2) Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar me Marrëveshjen e Madridit dhe Protokollin e Madridit do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

(3) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) të këtij neni parashtrohet përmes Entit në procedurën e verifikuar me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

(4) Për nevojat e regjistrimit ndërkombëtar të markave tregtare, sipas Marrëveshjes së Madridit dhe Protokollit të Madridi, shpallja e fletëparaqitjes së përcaktuar në nenin 195 të këtij ligji zëvendësohet me shpalljen e regjistrimit ndërkombëtar në fletoren zyrtare të Organizatën Botërore për Pronësi Intelektuale.

(5) Afati për parashtrimin e kundërshtimit kundër njohjes së markës së regjistruar tregtare ndërkombëtare për Republikën e Maqedonisë, rrjedh nga dita e parë në muajin i cili vijon pas muajit të botimit të fletores zyrtare të Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale në të cilën ajo markë tregtare është shpallur.

PJESA E PESTË

EMRI GJEOGRAFIK

Lënda e mbrojtjes

Neni 226

(1) Emri gjeografik mbrohet me shënimin e prejardhjes së prodhimit dhe emrin gjeografik.

(2) Me emër gjeografik shënohen produktet të cilat i prodhojnë personat fizikë ose juridikë në rajon të caktuar gjeografik.

Shenja e prejardhjes

Neni 227

Shenja e prejardhjes është emri gjeografik i shtetit, rajonit ose vendit me të cilën shënohet produkti që rrjedh nga ai rajon dhe kualiteti dhe cilësitë e të cilit ekskluzivisht ose kryesisht janë kushtëzuar nga mjedisi gjeografik, duke përfshirë edhe faktorët natyrorë dhe njerëzorë dhe prodhimi, përpunimi dhe përgatitja e të cilave në tërësi zhvillohen në rajon të caktuar të prejardhjes.

Shenja gjeografike

Neni 228

(1) Shenjë gjeografike është emri gjeografik i shtetit, rajonit ose vendit me të cilën shënohet prodhimi, kualiteti, autoriteti ose karakteristika tjera të të cilit në esencë mund t'i përshkruhen prejardhjes gjeografike.

(2) Shenja gjeografike, për një prodhim mund të mbrohet me kusht që prodhimtaria dhe/ose procedura dhe/ose përgatitja e prodhimit të zhvillohet në vendin e caktuar të prejardhjes.

(3) Emrat gjeografikë të cilat nuk i plotësojnë kushtet për mbrojtje si shenjë të prejardhjes mund të mbrohen si shenja gjeografike.

Prejardhja e lëndëve të para

Neni 229

Me përjashtim të verës dhe pijeve të tjera alkoolike, produkti mund të shënohet me shenjën e prejardhjes edhe kur lëndët e para për prodhimin e tij kanë prejardhje nga rajoni më i gjerë ose jashtë rajonit të përpunimit me kusht që:

1) rajoni i caktuar për prodhimin e lëndëve të para të jetë i kufizuar ose të ekzistojnë kushte të veçanta për prodhimin e lëndëve, dhe

2) për kualitetin dhe cilësitë e veçanta të produktit të jetë vendimtare mënyra tradicionale e prodhimtarisë, gjegjësisht faktori njeri.

Emrat tradicionale

Neni 230

Emër gjeografik do të konsiderohet edhe emri që nuk përmban emër gjeografik të shtetit, rajonit ose vendit të caktuar, i cili me përdorimin e gjatë në qarkullim njihet si emër tradicional për produktin i cili rrjedh nga ai territor, si dhe emri historik i atij territori i cili orienton në prejardhjen e caktuar të produktit, ndërsa i plotëson kushtet nga neni 227, përkatësisht nenit 228 paragrafi (2) të këtij ligji.

Rajoni i mbrojtjes

Neni 231

Emri gjeografik mund të përdoret për shënimin e produkteve natyrore, produkteve bujqësore, produkteve industriale, produkteve zejtare dhe produkteve nga artizanalet shtëpiake.

Përjashtimi nga mbrojtja

Neni 232

Me shenjën gjeografike, përkatësisht me shenjën e prejardhjes nuk mund të mbrohet emrin e produktit i cili:

- 1) nuk i plotëson kushtet e caktuara me këtë ligj;
- 2) është në kundërshtim me ligjin dhe moralin;
- 3) me përmbajtjen e tij mund të shkaktojë huti në pikëpamje të llojit prejardhjes, kualitetit, mënyrës së prodhimit ose vetive të tjera të prodhimit;
- 4) është i njëjtë me emrin e llojit e bimës ose racës së kafshëve, në rast kur ajo opinionin do ta sillte në huti në pikëpamje të prejardhjes gjeografike;
- 5) paraqet emër të saktë të shtetit, rajonit ose vendit prej nga e ka prejardhjen produkti, por te konsumatori shkakton pamje të rrejshme se produkti e ka prejardhjen nga ndonjë shtet, rajon ose vend tjetër;
- 6) nuk është i mbrojtur në shtetin e prejardhjes ose është ndërprerë të shfrytëzohet në vendin e prejardhjes, dhe
- 7) është identik ose i ngjashëm me emrin gjeografik ose markën tregtare të regjistruar më herët për produktet identike ose të ngjashme, kur ekziston gjasa që te konsumatorët të shkaktohet huti.

Ndalesa për mbrojtje

Neni 233

(1) Me shenjën gjeografike, përkatësisht me shenjën e prejardhjes nuk mund të mbrohet emri i vendit të prejardhjes i cili së pari është shfrytëzuar për shënimin e prodhimeve nga ai vend i prejardhjes, por i cili me përdorim të gjatë në qarkullim është bërë gjenerik, përkatësisht përgjithësisht i njohur për shënimin e llojit të caktuar të produkteve.

(2) Emri i vendit të prejardhjes i mbrojtur me shenjën gjeografike, përkatësisht me shenjën e prejardhjes, nuk mund të bëhet gjenerik.

Homonimet

Neni 234

Nëse emrat e dy ose më tepër vendeve të prejardhjes së produkteve janë të njëjta ose thujse të njëjta në formë të shkruar, mbrojtja e emrave të tillë me shenjë gjeografike ose shenjën e prejardhjes, do t'u lejohet të gjithë personave të cilët i plotësojnë kushtet të parapara me këtë ligj dhe nëse ato emra janë shfrytëzuar në pajtim me zakonet e mira afariste, si dhe mbi principet e barazisë së prodhuesve të tregut dhe informimin e vërtetë të konsumatorit, me përjashtim kur kjo do të shkaktonte huti të opinionit në pikëpamje të prejardhjes gjeografike.

Mbrojtja ndërkombëtare

Neni 235

(1) Emri gjeografik i cili veç më është i mbrojtur me shenjën gjeografike, përkatësisht me shenjën e prejardhjes në Republikën e Maqedonisë mund të mbrohet edhe jashtë vendit në bazë të marrëveshjes bilaterale për mbrojtje të ndërsjellë ose marrëveshje ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

(2) Fletëparaqitje për mbrojtje jashtë vendit mund të parashtrojnë vetëm shfrytëzuesit e shenjave gjeografike të cilat janë regjistruar në regjistrin e emrave gjeografik të mbrojtur të Entit.

(3) Emër gjeografik mund të mbrojtë edhe personi fizik ose juridik i huaj ose grup prodhuesish dhe të kryejë regjistrimin e shfrytëzuesit të autorizuar të emrit gjeografik të mbrojtur në rast kur kjo del nga marrëveshjet ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë ose në bazë të marrëveshjeve bilaterale për mbrojtje të ndërsjellë nëse kështu është paraparë me dispozitat e shtetit nga cili ka prejardhjen personi.

Mbajtja e procedurës

Neni 236

Procedura për mbrojtjen e emrit gjeografik, përkatësisht për njohjen e së drejtës së shfrytëzimit të emrit të mbrojtur gjeografik mbahet me fletëparaqitje e cila përmban kërkesën për mbrojtjen e emrit gjeografik, përkatësisht kërkesën për njohjen e së drejtës për shfrytëzimin e emrit të mbrojtur gjeografik dhe shtojca të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Fletëparaqitja e personit të huaj

Neni 237

Personat e huaj të cilët parashtrojnë fletëparaqitje, bashkë me kërkesën për njohjen e emrit gjeografik, përkatësisht kërkesën për njohjen e së drejtës së shfrytëzimit, bashkëngjisin kopje të dokumentit publik ose akt tjetër juridik në gjuhën zyrtare të shtetit të prejardhjes, i lëshuar nga organi kompetent në shtetin e prejardhjes, si dëshmi se emri gjeografik është i mbrojtur në atë shtet, përkatësisht se është e njohur e drejta e shfrytëzuesit të

autorizuar, në pajtim me legjislacionin nacional në shtetin e prejardhjes, si dhe përkthimin e verifikuar në gjuhën maqedonase.

Veçantia e fletëparaqitjes

Neni 238

Me një fletëparaqitje mund të kërkohet mbrojtja, përkatësisht e drejta e shfrytëzimit vetëm të një emri gjeografik i cili ka të bëjë vetëm me një lloj të produktit.

Parashtruesi i kërkesës

Neni 239

Fletëparaqitje për mbrojtjen e emrit gjeografik mund të parashtrojnë:

- 1) persona fizikë dhe juridikë të cilët në rajon të caktuar prodhojnë produkte që shënohet me emrin e atij rajoni, dhe
- 2) grupi i prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve të njëjta pavarësisht nga përbërja dhe forma e bashkimit;
- 3) organi shtetëror, njësia e vetadministrimit lokal dhe odat e interesuar për mbrojtjen e emrave gjeografikë të rajonit të veprimit të tyre;
- 4) persona të huaj dhe persona fizikë, përkatësisht grupe të huaja të prodhuesve, vetëm nëse e drejta e shfrytëzuesit të autorizuar për emrin gjeografik të mbrojtur u është njohur në shtetet e prejardhjes dhe nëse i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj.

Përmbajtja e fletëparaqitjes

Neni 240

(1) Fletëparaqitja për mbrojtjen e emrit gjeografik përmban kërkesë për mbrojtje të emrit gjeografik me shenjën se kërkohet mbrojtja me shenjën e prejardhjes ose me shenjë gjeografike.

(2) Fletëparaqitja për mbrojtjen e emrit gjeografik me shenjën e prejardhjes ose shenjë gjeografike, përveç kërkesës për mbrojtjen e emrit gjeografik, përmban elaborat për produktin i cili do të shënohet me emrin gjeografik.

(3) Përmbajtja dhe forma e fletëparaqitjes nga paragrafi (1) i këtij neni, elaborati dhe pjesët përbërëse dhe shtesat tjera verifikohen në mënyrë detale me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

Elaborati dhe kontrollimi

Neni 241

(1) Elaboratin e përpunon institucioni i cili i plotëson kushtet e parapara me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

(2) Kontrollin e vetive të veçanta të produktit mund ta kryejë institucioni e cila e ka përpunuar elaboratin ose me kërkesën njërës nga palët, institucioni

tjetër që i plotëson kushtet të parapara me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit, për çka lëshon vërtetim.

(3) Institucioni i cili e ka përpunuar elaboratin në afat prej 90 ditësh nga njohja e emrit gjeografik duhet të formojë Komision për kontrollin e kualitetit dhe vetive të veçanta të produktit i cili shënohet me emrin gjeografik.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni përbëhet prej pesë anëtarësh të cilët kanë marrë pjesë gjatë përpunimit të elaboratit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe/ose persona të tjerë me njohuri nga sfera së cilës i takon produkti i dhënë. Së paku një anëtar i komisionit duhet të jetë prodhues.

(5) Mënyra dhe puna e Komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni verifikohet me rregullore të cilën e miraton institucioni.

Ndërrimi i komisionit për kontroll

Neni 242

(1) Nëse institucioni i cili e ka përpunuar elaboratin në afatin e paraparë nuk mund të formojë komision për kontrollin e kualitetit dhe cilësive të veçanta të produktit, do të propozojë institucion tjetër përkatës, jo më vonë se 90 ditë nga njohja e emrit gjeografik.

(2) Nëse institucioni i cili e ka përpunuar elaboratin në afatin e paraparë nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) nga ky ligj, Enti do të kërkojë mendim nga institucione profesionale varësisht nga lloji i produktit ose nga grupi i prodhuesve të produktit të dhënë, për propozim të institucionit të ri për shkak të kontrollit të produktit.

(3) Nëse për shkaqe të caktuara ndërpriten kushtet për kontroll të produktit nga institucioni i cili e ka përpunuar elaboratin ose institucioni tjetër i cili ka kryer kontrollin e produktit, zbatohen dispozitat nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni.

Ndryshime në elaborat

Neni 243

(1) Personat fizikë dhe juridikë dhe shoqatat e personave fizikë dhe juridikë të cilët i përmbushin kushtet të parapara në nenin 239 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të këtij ligji dhe të cilët kanë interes juridik mund të kërkojnë ndryshim dhe plotësim të elaboratit si rezultat i ndryshimeve të bëra në pikëpamje të zhvillimit të shkencës dhe njohurive teknike ose për shkak të ridefinimit të kufijve të rajonit gjeografik.

(2) Kërkesa për ndryshime dhe plotësime të elaboratit i parashtrohet institucionit i cili ka e përpunuar të njëjtin ose institucionit tjetër i cili i plotëson kushtet të parapara me dispozitën të cilën e miraton drejtori i Entit.

(3) Kërkesa për ndryshime dhe plotësime të elaboratit duhet t'i përmbajë arsyet për ndryshimet e kërkuara.

(4) Parashtruesi i kërkesës Entit duhet t'ia dorëzojë ndryshimin dhe plotësimin e elaboratit.

(5) Si ndryshim në elaborat konsiderohet edhe ndërrimi i institucionit për kontrollin e produktit.

Regjistrat

Neni 244

(1) Enti mban regjistrin e fletëparaqitjeve për mbrojtjen e emrave gjeografikë dhe regjistrin e fletëparaqitjeve për shfrytëzimin e emrave gjeografikë të mbrojtur, regjistrin e emrave gjeografikë dhe regjistrin e shfrytëzuesve të emrave gjeografikë të mbrojtur.

(2) Përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrave nga paragrafi (1) i këtij neni verifikohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

(3) Me kërkesën me shkrim nga personat e interesuar, Enti lëshon kopje të dokumenteve, vërtetime dhe ekstrakte nga regjistrat.

Fitimi i së drejtës

Neni 245

(1) Mbrojtja e emrit të shtetit të prejardhjes për prodhimet me shenjë gjeografike, përkatësisht me shenjë e prejardhjes bëhet me miratimin e aktvendimit dhe regjistrimin e emrit gjeografik të produktit dhe llojit të produktit të cilit i dedikohet ai emër në Regjistrin e emrave gjeografikë të mbrojtur.

(2) E drejta e shfrytëzimit të emrave gjeografikë të mbrojtur fitohet me lëshimin e aktvendimit për njohjen e së drejtës dhe me regjistrimin në regjistrin e shfrytëzuesve të emrave gjeografikë të mbrojtur.

Afati i së drejtës

Neni 246

(1) Mbrojtja e emrit gjeografik është e pakufizuar.

(2) E drejta e shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur vlen pesë vjet, duke llogaritur nga dita e miratimit të aktvendimit.

(3) Vlefshmëria e së drejtës për shfrytëzim mund të vazhdohet në numër të pakufizuar dhe atë në periudhë prej pesë vjetësh, me kusht që bartësi i së drejtës gjatë vitit të pestë të vlefshmërisë, Entit t'i parashtrojë kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë të drejtës së shfrytëzimit të emrit të mbrojtur gjeografik.

(4) Përmbajtja dhe forma e kërkesës për vazhdimin e vlefshmërisë verifikohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

(5) E drejta e shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur do të vazhdohet nëse plotësohen kushtet për njohjen e kësaj të drejte, në të kundërtën e drejta ndërpritet të vazhdojë ditën e ardhshme nga dita e kalimit të vitit të pestë nga vlefshmëria e saj.

E drejta e shfrytëzimit

Neni 247

(1) Shenja e prejardhjes është e drejtë kolektive dhe mund ta shfrytëzojnë ekskluzivisht personat fizikë dhe juridikë dhe shoqata të personave fizikë dhe juridikë, të cilët:

1) prodhojnë ose përpunojnë produkt, emri i të cilit është i mbrojtur me shenjën e prejardhjes;

2) procesin e prodhimit tërësisht e kryejnë në rajonin gjeografik i cili është definuar në mënyrë të saktë në elaborat, dhe;

3) janë të regjistruar në regjistrin e shfrytëzuesve si shfrytëzues të kësaj shenje të prejardhjes.

(2) Shenja gjeografike është e drejtë kolektive dhe mund ta shfrytëzojnë persona fizikë dhe juridikë, të cilët:

1) prodhojnë produkt emri gjeografik i të cilit është i mbrojtur me shenjën gjeografike;

2) prodhimtarinë dhe/ose përpunimin dhe/ose përgatitjen e produktit e kryejnë në rajonin gjeografik që është definuar saktësisht në elaborat, dhe

3) janë të regjistruar në regjistrin e shfrytëzuesve si shfrytëzues të kësaj shenje gjeografike.

Përmbajtja e fletëparaqitjes për shfrytëzim

Neni 248

(1) Fletëparaqitja për njohjen e së drejtës së shfrytëzimit përmban:

1) kërkesë për njohjen e së drejtës së shfrytëzimit të emrit të mbrojtur gjeografik;

2) dëshmi për kryerjen e veprimtarisë së caktuar dhe

3) dëshmi për kontrollin e kryer.

(2) Përmbajtja dhe forma e fletëparaqitjes nga paragrafi (1) i këtij neni dhe përbërësit dhe shtesat tjera verifikohen me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Kontrollimi i fletëparaqitjeve

Neni 249

(1) Nëse fletëparaqitja nuk i përmban të gjitha shtesat dhe pjesët përbërëse të nevojshme në pajtim me këtë ligj dhe dispozitë të cilin e miraton drejtori i Entit, Enti e thërret parashtruesin e fletëparaqitjes në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të thirrjes t'i eliminojë të mangësitë e verifikuara.

(2) Ndaj kërkesës së arsyetuar nga parashtruesi i fletëparaqitjes për shkaqe të arsyeshme afati nga paragrafi (1) i këtij neni mund të shtyhet edhe për 30 ditë.

(3) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e përcaktuar nuk e rregullon fletëparaqitjen ose nuk i paguan shpenzimet të cilat është i detyruar t'i paguajë për rregullimin e fletëparaqitjes, Enti me aktvendim do ta refuzojë fletëparaqitjen për mbrojtjen e emrit gjeografik, përkatësisht fletëparaqitja për njohjen e të drejtës së shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur.

Plotësimi i kushteve

Neni 250

Nëse në pajtim me këtë ligj dhe dispozitën të cilin e miraton drejtori i Entit, Enti verifikon se fletëparaqitja është në rregull, vazhdon me kontrollimin e fletëparaqitjes në pikëpamje se a i plotëson kushtet e parapara me ligj për mbrojtjen e emrit gjeografik mbrojtës, përkatësisht për njohjen e së drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar.

Procedura ndaj fletëparaqitjes dhe vendimmarrja

Neni 251

(1) Nëse Enti verifikon se fletëparaqitja nuk i plotëson kushtet për mbrojtjen e emrit gjeografik, përkatësisht për njohjen e së drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar të emrit të mbrojtur gjeografik, me shkrim do ta njoftojë parashtruesin e fletëparaqitjes për arsyet për të cilat nuk mund ta mbrojë emrin gjeografik, përkatësisht ta njohë të drejtën e shfrytëzuesit të autorizuar dhe do ta thërrasë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit të deklarohet për arsyet.

(2) Ndaj kërkesës së arsyetuar nga parashtruesi i fletëparaqitjes për shkaqe të arsyeshme afati nga paragrafi (1) i këtij neni mund të vazhdohet më së shumti edhe për 90 ditë.

(3) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e paraparë nuk deklarohet fare, ose nëse deklarohet, kurse Enti verifikon se nuk mund të mbrohet emri gjeografik, përkatësisht të njihet e drejta e shfrytëzuesit të autorizuar të emrit të mbrojtur gjeografik, me aktvendim do ta refuzojë fletëparaqitjen për mbrojtjen e emrit gjeografik, përkatësisht fletëparaqitjen për njohjen e së drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar të emrit gjeografik.

(4) Nëse në rastin e paragrafit (3) të këtij neni është në pyetje fletëparaqitja për mbrojtjen e emrit gjeografik me shenjën e prejardhjes e cila i plotëson kushtet që të jetë e mbrojtur me emër gjeografik, Enti do ta njoftojë parashtruesin e fletëparaqitjes dhe me pëlqimin e tij emri gjeografik do ta mbrojë me shenjën gjeografike.

Miratimi i aktvendimit

Neni 252

(1) Nëse fletëparaqitja për mbrojtjen e emrit gjeografik i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj, Enti do të miratojë aktvendimi për mbrojtjen e emrit gjeografik dhe të njëjtin e regjistron në Regjistrin e emrave gjeografikë të mbrojtur.

(2) Nëse fletëparaqitja për njohjen e së drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar të emrit gjeografik i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj, Enti do ta thërrasë parashtruesin e fletëparaqitjes që në afat prej 30 ditësh ta paguajë taksën për njohjen e së drejtës për shfrytëzues të autorizuar të emrit gjeografik për pesë vitet e para, shpenzimet për publikimin e të dhënave për njohjen e së drejtës së shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur, si dhe për lëshimin e dokumenti dhe të parashtrë dëshmi për pagesat e kryera.

(3) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes në afatin e përcaktuar nga paragrafi (2) i këtij neni nuk parashtron dëshmi për pagesat e bëra, Enti me aktvendim do ta refuzojë fletëparaqitjen për njohjen e së drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar të emrit gjeografik të mbrojtur.

Regjistrimi në regjistrat

Neni 253

Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes paraqet dëshmi për pagesën e kryer nga neni 252 paragrafi (2) i këtij ligji, Enti miraton aktvendimin për njohjen e të drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar dhe e regjistron në regjistrin e shfrytëzuesve të emrave gjeografik të mbrojtur dhe në regjistrin për emrat e mbrojtur gjeografikë.

Shpallja e emrit gjeografik të mbrojtur

Neni 254

(1) Shpallja e emrit gjeografik të mbrojtur në fletoren e Entit bëhet me obligim zyrtar.

(2) Të dhënat për emrin gjeografik të mbrojtur të cilat publikohen në fletoren zyrtare verifikohen me dispozitë të cilin e miraton drejtori i Entit.

Shpallja e të dhënave për shfrytëzuesin e autorizuar

Neni 255

(1) Pas pagesës së kryer të harxhimeve për publikim nga ana e bartësit të së drejtës për shfrytëzues të autorizuar, Enti i publikon të dhënat për njohjen e së drejtës së shfrytëzuesit të autorizuar në fletore.

(2) Të dhënat për të drejtën e njohur të shfrytëzuesit të autorizuar të cilat publikohen në fletore zyrtare verifikohen me dispozitë të cilin e miraton drejtori i Entit.

Dokumenti

Neni 256

(1) Shfrytëzuesit të autorizuar të emrit të mbrojtur gjeografik, Enti i lëshon dokument për të drejtën e njohur të shfrytëzuesit të autorizuar në afat prej gjashtë muaj nga dita e marrjes së aktvendimit.

(2) Përmbajtja e dokumentit nga paragrafi (1) i këtij neni verifikohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Të drejtat e shfrytëzuesit

Neni 257

(1) Shfrytëzuesi i emrit të gjeografik të mbrojtur ka të drejtë që të njëjtin ta shfrytëzojë ekskluzivisht për shënimin e atij lloji të produktit i cili është i regjistruar në Regjistrin e emrave gjeografikë të mbrojtur të Entit.

(2) E drejta e shfrytëzimit i dedikohet edhe shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur ndaj mjeteve për paketim, materialeve reklamuese,

dokumenteve afariste dhe dokumentacionit tjetër afarist, si dhe gjatë importit dhe eksportit të produkteve të shënuara me emër gjeografik.

(3) Shfrytëzuesit e autorizuar të emrit gjeografik të mbrojtur kanë ekskluzivisht të drejtën që prodhimet e tyre t'i shënojnë me "shenjën e kontrolluar të prejardhjes" nëse janë autorizuar për shfrytëzimin e shenjës së prejardhjes ose "shenjën gjeografike të kontrolluar" nëse janë të autorizuar për shfrytëzimin e shenjës gjeografike.

Mosndryshimi

Neni 258

(1) E drejta e shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur me marrëveshje nuk mund të bartet, të transferohet dhe të jepet peng.

(2) Nëse emri gjeografik i mbrojtur është objekt i markës tregtare të regjistruar ose të paraqitur më parë, dhe marka e tillë nuk mund të bartet, të transferohet, të jepet peng.

Ndalesa

Neni 259

(1) Shfrytëzuesit e emrave gjeografikë mund të parashtrojnë kërkesë që të ndalohet;

1) shfrytëzimi direkt ose indirekt i paautorizuar i emrit gjeografik të mbrojtur për produkte të njëjta ose të ngjashme për arsye të fitimit të interesit pronësor;

2) shënimi i produkteve të cilat nuk kanë prejardhjen nga vendi i prejardhjes i shënuar me emrin gjeografik të mbrojtur edhe atëherë kur është shënuar prejardhja e vërtetë, kur është shfrytëzuar përkthimi i tij ose kur shfrytëzohet në shoqërim të shprehjeve plotësuese, siç janë, "stili", "tipi", "në mënyrë", "si i prodhuar në", "imitimi" dhe ngjashëm;

3) secila formë e shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur e cila i shkakton dëm autoritetit ose e shfrytëzon autoritetin e emrit gjeografik të mbrojtur;

4) çdo shfrytëzim i informacionit të pavërtetë i cili do të shpinte në huti konsumatorin në pikëpamje të prejardhjes gjeografike, kualitetit ose vetive të produktit, ndërsa vihet në paketim, dokumentet afariste ose dokumente të tjera, me çka lë përshtypje të gabuar për prejardhjen e vërtetë dhe

5) çdo përdorim tjetër që do ta shpinte konsumatorin në huti në lidhje me prejardhjen gjeografike të produktit.

(2) Nëse emri gjeografik i mbrojtur përveç termit gjeografik përmban edhe termin gjenerik, përdorimi i atij termi gjenerik të produkteve adekuate nuk i nënshtrohet ndalesës nga paragrafi (1), pika 1) dhe 2) të këtij neni.

Shfrytëzimi i lirë

Neni 260

(1) Shfrytëzuesit e autorizuar të emrave gjeografikë të mbrojtur nuk mund të kërkojnë ndalesë për arsye të shkeljes së të drejtës kur emri

gjeografik i mbrojtur shfrytëzohet me qëllim për informimin dhe edukimin e opinionit në mënyrë që nuk i dëmton interesat e tyre.

(2) Shfrytëzimi i emrave gjeografikë për qëllime nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet pa kompensim.

Ndryshimet në regjistër

Neni 261

(1) Me kërkesë me shkrim të personave fizikë dhe juridikë dhe shoqatave të tyre të cilat i plotësojnë kushtet të paraparë në nenin 242, pika 1) nga ky ligj, Enti i regjistron ndryshimet në regjistrin për emrat gjeografikë të mbrojtur, të krijuara me ndryshimet dhe plotësimet e elaboratit.

(2) Me kërkesë me shkrim të parashtruesit të fletëparaqitjes ose të shfrytëzuesit të autorizuar të emrit gjeografik të mbrojtur, Enti i regjistron në regjistrin përkatës të gjitha ndryshimet të cilat janë lidhje me të drejtën e pranuar të shfrytëzuesit të autorizuar të cilat janë krijuar pas parashtrimit të fletëparaqitjes ose pas njohjes së të drejtës, me kusht ato të jenë identikë e gjendjen e vërtetë.

(3) Nëse kërkesa u dedikohet ndryshimeve të rëndësishme në sasinë e prodhimit, me kërkesën dorëzohet edhe dëshmia nga neni 241 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, jo më e vjetër se gjashtë muaj.

(4) Nëse ndryshimet i dedikohen të dhënave për institucion të ri për kontroll, Enti mund t'i regjistrojë edhe me detyrë zyrtare.

(5) Ndryshimet e regjistruara në Regjistrin e emrave gjeografikë të mbrojtur edhe në regjistrin e shfrytëzuesve të autorizuar publikohen në fletoren zyrtare të Entit.

(6) Përmbajtja dhe forma e kërkesës për regjistrim e ndryshimeve verifikohet me dispozitë të cilën e miraton drejtori i Entit.

Kushte për shfuqizimin e së drejtës së shfrytëzimit

Neni 262

Aktvendimin për njohjen e të drejtës së shfrytëzimit të emrit gjeografik të mbrojtur mund të shfuqizohet nëse vërtetohet se kanë pushuar së ekzistuari kushtet për njohjen e së drejtës për shfrytëzimin e emrit gjeografik të mbrojtur të paraparë me këtë ligj. Në procedurën, me kërkesën për shfuqizimin e aktvendimit për njohjen e së drejtës për shfrytëzim të emrit gjeografik të mbrojtur, shfrytëzuesi i autorizuar emrit gjeografik të mbrojtur është i detyruar të dëshmojë se ekzistojnë kushte për njohjen e së drejtës.

Kërkesa për shfuqizimin e aktvendimit

Neni 263

(1) Aktvendimi për njohjen e së drejtës për shfrytëzimin e emrit gjeografik të mbrojtur mund të shfuqizohet me detyrë zyrtare, me kërkesën e personit ose shoqatës së interesuar në kuptim të nenit 239 paragrafi (1) pika 2) të këtij ligji, si dhe me propozimin e prokurorit publik.

(2) Kërkesa për shfuqizimin e aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij ligji i paraqitet në formë të shkruar Entit.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (2) të këtij neni, parashtruesi është i detyruar t'i parashtojë argumente të duhura.

(4) Enti është i detyruar që në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga pranimi i kërkesës ta dorëzojë kërkesën bartësit të së drejtës për shfrytëzim dhe ta thërrasë të deklarohet në afat prej tridhjetë ditësh nga pranimi i informimit.

(5) Përmbajtja e kërkesës për shfuqizimin e aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni verifikohet me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Vazhdimi i procedurës për shfuqizimin e aktvendimit

Neni 264

(1) Nëse parashtruesi i kërkesës për shfuqizimin e aktvendimit për njohjen e së drejtës për shfrytëzim të emrit të mbrojtur gjeografik gjatë procedurës heq dorë prej kërkesës, Enti mund të vazhdojë me procedurën me detyrë zyrtare.

(2) Personit i cili është i regjistruar si shfrytëzues i autorizuar në regjistrat përkatës i pushon e drejta për shfrytëzimin e emrit gjeografik të mbrojtur ditën e vijuese nga dita e aktvendimit të plotfuqishëm për shfuqizimin e kësaj të drejte.

PJESA E GJASHTË

VAZHDIM I PROCEDURËS DHE KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARËSHME

Vazhdim I procedurës

Neni 265

(1) Nëse parashtruesi i fletëparaqitjes ka lëshuar që afatin e caktuar të kryejë ndonjë veprim në procedurën para Entit, për çka mund të humbë të drejtë të caktuar nga fletëparaqitja ose të drejtën e njohur, mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e procedurës.

(2) Enti do të lejojë vazhdimin e procedurës nëse parashtruesi:

1) parashtron kërkesë për vazhdimin e procedurës, i kryen veprimet e lëshuara dhe i bashkëngjijtë të gjithë të parashtruesit në afatin e caktuar; dhe

2) i paguan të gjithë taksat dhe shpenzimet në procedurë në pajtueshmëri me nenin 24 nga ky ligj;

3) Për kërkesën për vazhdimin e procedurës paguhet taksë administrative përkatëse.

Afati për paraqitjen e kërkesës për vazhdimin e procedurës

Neni 266

(1) Kërkesa për vazhdimin e procedurës mund të paraqitet në afat prej 2 muajsh nga dita kur parashtruesi kupton për pasojat nga neni 265 të këtij ligji.

(2) Pas skadimit të gjashtë muajve nga dita e lëshimit nuk mund të kërkohet vazhdimi i procedurës.

(3) Nëse veprimet e lëshuara nuk kryhen në afatin nga paragrafi (1) të këtij neni ose nëse nuk janë paguar taksat dhe shpenzimet e procedurës nga neni 24 të këtij ligji, Enti miraton konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

Kur nuk mund të kërkohet vazhdimi i procedurës

Neni 267

Kërkesë për vazhdimin e procedurës nuk mund të parashtrohet nëse është lëshuar afati:

- 1) nga nenet 265 dhe 266 të këtij ligji;
- 2) për parashtrimin e kërkesës nga neni 52 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 3) për parashtrimin e propozimit nga nenet 268 dhe 269 të këtij ligji; dhe
- 4) për të gjitha procedurat para Entit ku marrin pjesë më shumë palë.

Kthimi në gjendjen e mëparshme

Neni 268

(1) Parashtruesit të fletëparaqitjes ose bartësit të së drejtave nga ky ligj do t'i lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, nëse edhe përveç kujdesit të detyrueshëm e ka lëshuar afatin e përcaktuar me këtë ligj të kryejë ndonjë veprim në procedurën para Entit për çka do të humbte ndonjë të drejtë, nëse:

- 1) dorëzon propozim për kthim në gjendjen e mëparshme dhe i kryen të gjitha veprimet e lëshuara në afatin e përcaktuar;
- 2) i shënon rrethanat për të cilat ka qenë i penguar që në afatin e caktuar të kryejë veprimin e lëshuar; dhe
- 3) i ka paguar taksat dhe shpenzimet në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.

(2) Për kërkesën e kthimit në gjendjen e mëparshme paguhet taksë administrative përkatëse.

Afati për parashtrimin e propozimit për kthim në gjendjen e mëparshme

Neni 269

(1) Propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme paraqitet në afat prej tre muajsh duke llogaritur nga dita kur pushon arsyeja të cilën e shkakton lëshimi, por nëse parashtruesi më vonë ka mësuar për lëshimin, atëherë nga dita kur ai ka kuptua për të.

(2) Pas skadimit të një viti nga dita e lëshimit nuk mund të kërkohet kthim në gjendjen e mëparshme.

(3) Nëse lëshimi i afatit ka të bëjë me pagesën e taksave nga neni 24 paragrafi (3) të këtij ligji, ky afat përlogaritet në afatin nga paragrafi (3) të këtij neni.

Kur nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme

Neni 270

(1) Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk mund të kërkohet për shkak të lëshimit të afateve për veprimet në vijim:

1) parashtrimi i propozimit nga nenet 268 dhe 269 paragrafi (1) të këtij ligji;

2) parashtrimi i kërkesës për vazhdimin e procedurës nga nenet 265 dhe 266 të këtij ligji;

3) parashtrimi i njëres nga kërkesat nga neni 52 të këtij ligji;

4) parashtrimi i kundërshtimit nga nenet 156 dhe 197 të këtij ligji;

5) parashtrimi i kërkesës për vazhdimin e afateve të përcaktuara me këtë ligj;

6) dorëzimi i përkthimit nga neni 18 paragrafi (4) dhe 122 paragrafët (2) dhe (3) nga ky ligj; dhe

7) për të gjitha procedurat para Entit në të cilat marrin pjesë më tepër palë.

(2) Çdo person i cili me qëllim të mirë e shfrytëzon ose ka bërë përgatitje serioze për shfrytëzimin e zbulimit i cili është objekt i fletëparaqitjes së patentës ose patentës, në periudhën ndërmjet humbjes së të drejtës nga neni 265 paragrafi (1) të këtij ligji dhe shpalljes së të dhënave nga aktvendimi për kthim në gjendjen e mëparshme nga regjistri adekuat, pa kompensim të dëmit mund të vazhdojë me këtë shfrytëzimin për qëllimet e punës së vet dhe nevojat lidhur me këtë punë.

PJESA E SHTATË

NDRYSHUESHMËRIA E TË DREJTAVE NGA PRONËSIA INDUSTRIALE

Marrëveshja për bartje

Neni 271

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së të drejtës nga pronësia industriale dhe bartësi i së drejtës, me marrëveshje në tërësi ose pjesërisht mund ta bartin të drejtën e vet nën kushtet e parapara me këtë ligj dhe me dispozita të tjera.

(2) Marrëveshja për bartje e së drejtës patjetër duhet të jetë e përpiluar në formë me shkrim dhe nënshkrimet e palëve të kontraktuara të jenë të verifikuara nga noteri.

(3) Kontrata nga paragrafi (2) të këtij neni me kërkesën e njëres nga palët e kontraktuara regjistrohet në regjistrin përkatës të cilin e mban Enti.

(4) Marrëveshja nga paragrafi (2) të këtij neni që nuk është përpiluar në formë me shkrim dhe nuk është verifikuar nga noteri, nuk prodhon veprim juridik.

(5) Marrëveshja për bartjen e së drejtës që nuk është regjistruar në regjistrin përkatës të Entit, nuk prodhon veprim ndaj personave të tretë.

Marrëveshja për licencë

Neni 272

(1) Parashtruesi i fletëparaqitjes së të drejtës së pronësisë industriale dhe parashtruesi i së drejtës me marrëveshjen për licencë mund ta bartin këtë të drejtë të shfrytëzimit, nën kushtet e parapara me këtë ligj dhe me dispozita të tjera.

(2) Marrëveshja për licencë patjetër duhet të përpilohet në formë me shkrim.

(3) Nëse fletëparaqitje të patentës kanë parashtruar më shumë persona ose nëse bartës të patentës janë shumë persona, për lidhjen e marrëveshjes për licencë është i nevojshëm pajtimi i të gjithë këtyre personave.

(4) Nëse nuk ekziston pajtim për lidhjen e marrëveshjes për licencë nga paragrafi (3) të këtij neni për bartjen e së drejtës për shfrytëzim zbatohen rregullat e pronësisë.

(5) Marrëveshja për licencë e cila nuk është e përpiluar në formë me shkrim nuk prodhon veprim juridik.

(6) Marrëveshja për licencë me kërkesën e njërës palë kontraktuese regjistrohet në regjistrin përkatës të cilin e mban Enti.

(7) Marrëveshja për licencë e cila nuk është e regjistruar në regjistrin përkatës të Entit, nuk prodhon veprim ndaj personave të tretë.

Anulimi i marrëveshjes për licencë

Neni 273

Në marrëveshjen për licencë e anuluar është çdo dispozitë e cila shfrytëzuesit të licencës i vë përkufizim të cilat nuk dalin nga e drejta që është lëndë e marrëveshjes ose që nuk është nevojshme për ruajtje e kësaj të drejte, ose nëse janë në kundërshtim me dispozitat për përkufizimin e konkurrencës.

Zbatimi i Ligjit për marrëdhëniet obligative

Neni 274

Për marrëveshjet e neneve 271 dhe 272 të këtij ligji përveç dispozitave nga ky ligj zbatohet edhe Ligji për marrëdhënie obligative

PJESA E TETË

SHPALLJA E AKTVENDIMIT TË ANULUAR PËR NJOHJEN E SË DREJTAVE NGA PRONËSIA INDUSTRIALE

Neni 275

Aktvendimi për njohjen e së drejtave të pronësisë industriale do të shpallet i anuluar nëse verifikohet se nuk kanë ekzistuar kushtet e parapara me nenet 25 paragrafi (3), 26, 27 paragrafi (3), 30, 74, 132, 133, 177, 178, 232 dhe 233 paragrafi (1) i këtij ligji për njohjen e kësaj të drejte.

Procedura me propozim

Neni 276

(1) Aktvendimi për njohjen e së drejtës mund që të shpallet për të anuluar për gjithë kohëzgjatjen e mbrojtjes dhe atë me obligim zyrtar ose me propozim të personit të interesuar.

(2) Me përjashtim nga dispozita prej paragrafit (1) të këtij neni, propozim për shpallje për të anuluar të aktvendimit për njohjen e së drejtës së markës tregtare nuk mund të parashtrë bartësi i markës tregtare të regjistruar më parë, nëse gjatë pesë viteve një pas një para parashtrimin të propozimit ka ditur për shfrytëzimin e markës së mëvonshme tregtare.

(3) Propozimi për shpalljen e aktvendimit të anuluar i parashtrëhet në formë me shkrim Entit.

(4) Ndaj propozimit nga paragrafi (2) të këtij neni parashtruesi është i obliguar që t'i paraqesë dëshmitë e nevojshme.

(5) Enti është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga pranimi i propozimit t'ia dorëzojë propozimin bartësit të së drejtës dhe ta thërrasë të deklarohet në afat të përcaktuar që nuk mund të jetë më shumë se gjashtë muaj nga pranimi i lajmërimit.

Aktvendimi me propozim

Neni 277

Aktvendimi me të cilin shpallet i anuluar aktvendimi për njohjen e së drejtës nga pronësia industriale regjistrohet në regjistrin gjegjës dhe shpallet në fletoren zyrtare të Entit.

Heqja dorë nga propozimi

Neni 278

Nëse parashtruesi i propozimit heq dorë gjatë procedurës nga propozimi i tij që të shpallet për aktvendim të anuluar për njohjen e së drejtës, Enti mund ta vazhdojë procedurën me detyrë zyrtare.

PJESA E NËNTË

PËRFAQËSIMI

Personat që mund të kryejnë përfaqësim

Neni 279

(1) Në procedurat për mbrojtjen e së drejtave nga pronësia industriale, përfaqësimin e palëve para Entit mund të kryejnë persona juridikë dhe fizikë të cilët janë të regjistruar në Regjistrin që e mban Enti edhe atë:

1) person fizik;

-shtetas i Republikës së Maqedonisë;

-i cili është i regjistruar për kryerje veprimtarisë përfaqësim në sferën e pronësisë industriale;

-me fakultet të kryer juridik, një nga fakultetet teknike dhe fakultetin e farmacisë;

-i cili e ka dhënë provimin e posaçëm profesional të dhënë në pajtim me dispozitat e këtij ligji; dhe

-i cili ka njohuri së paku një nga gjuhët oficiale të organizatave nga sfera në të cilat Republika e Maqedonisë është anëtare.

2) avokati i cili është i regjistruar në Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë dhe që i plotëson kushtet nga pika 1) të këtij paragrafi dhe shoqata e avokatëve ose zyra e avokatëve që janë regjistruar në Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë dhe të cilët kanë person të punësuar i cili i plotëson kushtet nga pika 1) të këtij paragrafi; dhe

3) person juridik:

- me seli në Republikën e Maqedonisë;

- që është i regjistruar për përfaqësim në sferën e mbrojtjes së pronësisë industriale; dhe

- i cili ka të punësuar së paku një person që i plotëson kushtet nga pika 1) të këtij paragrafi.

(2) Përfaqësimin nga paragrafi (1) të këtij neni mund ta kryejë përfaqësues nga shteti tjetër nën kushte të reciprocitetit, nëse:

- është përfaqësues i shtetit të tij; dhe

- e njeh gjuhën maqedonase.

Provimi profesional

Neni 280

(1) Me provimin profesional nga neni 279 paragrafi (1) pika 1 alineja 1 i këtij ligji kontrollohet dituria e kandidatëve në sferën e pronësisë industriale.

(2) Provimi profesional jepet në Ent.

(3) Provimi profesional mbahet së paku një herë në vit.

(4) Provimi profesional jepet me shkrim dhe me gojë.

(5) Personat që e kanë dhënë provimin profesional për përfaqësues evidentohen në Ent.

(6) Përmbajtja dhe programi i provimit profesional, përmbajtja e fletëparaqitjes për dhënien e provimit profesional, procedura për mbajtjen e provimit profesional dhe riprovim , si dhe përmbajtja e evidencës së personave që e kanë dhënë provimin verifikohen me dispozitë të cilin e miraton drejtori i Entit.

Komisioni për provim

Neni 281

(1) Provimi profesional jepet para komisionit për provim të përbërë prej kryetarit, katër anëtarëve, zëvendësve të tyre dhe sekretarit.

(2) Kryetarin, anëtarët, zëvendësit dhe sekretarin e komisionit me aktvendim i emëron dhe shkarkon drejtori i Entit dhe atë me mandat prej tre vjetësh, kurse pas skadimit të afatit anëtarët mundë të emërohen përsëri edhe për një mandat prej tre vjetësh.

(3) Në aktvendimin për emërimin e anëtarëve dhe zëvendësve të komisionit për provim caktohen dhe lëndët për të cilat ata i zbatojnë ligjëratat dhe provimin.

(4) Kryetari dhe anëtarët e komisionit mund të jenë persona që kanë njohuri profesionale dhe shkencore nga lëmi.

(5) Kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit të komisionit u takon kompensim për punën në komision, lartësinë e së cilës e verifikon drejtori i Entit, e cila duhet t'i mbulojë shpenzimet reale për punën e komisionit, në bazë të numrit të kandidatëve që i ndjekin ligjëratat, përkatësisht e japin provimin, numrit të ligjëratave, numrit të provimeve të mbajtura të pjesë me shkrim dhe me gojë.

Fitimi i së drejtës për kryerjen e veprimit përfaqësim

Neni 282

E drejta për kryerjen e përfaqësimit para Entit fitohet me ditën e shënimit në Regjistrin e përfaqësuesve.

Regjistrimi në regjistër

Neni 283

(1) Procedura për regjistrim në regjistrin e përfaqësuesve mbahet me parashtrimin e kërkesës për regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve.

(2) Me kërkesën për regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve dorëzohet edhe dokumentacioni përkatës për plotësimin e kushteve për regjistrim nga neni 279 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji.

(3) Dokumentet me të cilat dëshmohet e baza juridike për plotësimin e kushteve për regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve parashtrohet në origjinal ose kopje të verifikuara, në tërësi ose vetëm një pjesë nga e cila del qartë se baza është e përmbushur.

(4) Përmbajtja dhe forma e kërkesës për regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve, procedura për regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve dhe dokumentacioni përkatës nga paragrafi (2) të këtij neni verifikohet me dispozitën që e miraton drejtori i Entit.

Përtëritja e regjistrimit në regjistër

Neni 284

(1) Regjistrimi në Regjistrin e përfaqësuesve përtëritet para skadimit të një vitit nga dita e regjistrimit, përkatësisht nga dita e përtëritjes së regjistrimit në Regjistër.

(2) Përmbajtja, forma si dhe procedura për kërkesën për përtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e përfaqësuesve verifikohet me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Taksat administrative dhe shpenzimet në procedurën për përfaqësim

Neni 285

(1) Taksat administrative paguhen për regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve, për përtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e përfaqësuesve, gjatë reregjistrimit në Regjistër, për ndryshimet në Regjistër dhe lëshimin e vërtetimit.

(2) Shpenzimet paguhen për mbajtjen e provimit për përfaqësues, për riprovim dhe për publikimin në fletoren zyrtare të Entit.

(3) Lartësia e taksave administrative përkatësisht shpenzimeve, është përcaktuar në Ligjin për taksat administrative dhe Tarifën e Entit.

Regjistri i përfaqësuesve

Neni 286

(1) Regjistrin e përfaqësuesve e mban Enti.

(2) Përmbajtja e Regjistrit të përfaqësuesve verifikohet me dispozitën që e miraton drejtori i Entit.

Shlyerja nga Regjistri

Neni 287

(1) Përfaqësimi shlyhet nga Regjistri i përfaqësuesve, nëse:

1) nuk kërkon përtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e përfaqësuesve në afatin nga neni 284 të këtij ligji;

2) dorëzon kërkesë për shlyerje nga Regjistri;

3) me vendim gjyqësor është ndaluar kryerja e përfaqësimit;

4) nuk dorëzon dëshmi se i plotëson kushtet për përtëritjen e regjistrimit në Regjistër;

5) personi fizik shlyhet nga Regjistri i përfaqësuesve në rast të vdekjes dhe ose humb aftësinë afariste;

6) humb shtetësinë e Republikës së Maqedonisë;

7) personi juridik shlyhet nga Regjistri i përfaqësuesve me pushimin e personit juridik; dhe

8) nuk ka më seli në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Nëse janë plotësuar kushtet për shlyerje nga Regjistri i përfaqësuesve nga paragrafi (1) të këtij neni, Enti miraton aktvendim për shlyerje nga Regjistri i përfaqësuesve.

(3) Në fletoren e Entit me detyrë zyrtare publikohen të dhënat për shlyerjen e përfaqësuesve nga Regjistri i përfaqësuesve

Riregjistrimi në Regjistrin e përfaqësuesve

Neni 288

Përfaqësuesi që një herë është shlyer nga Regjistri i përfaqësuesve mund të dorëzojë kërkesë për regjistrim edhe gjatë çdo riregjistrimi në Regjistrin e përfaqësuesve merr numër rendor të ri dhe i parashtron dëshmitë e njëjta si edhe gjatë regjistrimit në Regjistër.

Regjistrimi i ndryshimeve në Regjistrin e përfaqësuesve

Neni 289

(1) Në Regjistrin të përfaqësuesve regjistrohen të gjitha ndryshimet e mëvonshme të adresës së personit fizik, përkatësisht të selisë së personit juridik, ndryshimet në listën e personave të punësuar të cilët i plotësojnë kushtet për përfaqësim të personat juridikë, pushimi i kryerjes së veprimtarisë së përfaqësimit dhe ndryshimet tjera të personat fizikë dhe juridikë.

(2) Përmbajtja, forma e kërkesës si dhe procedura ndaj kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin e përfaqësuesve, verifikohet me dispozitë që e miraton drejtori i Entit.

Shpallja e të dhënave në fletoren zyrtare

Neni 290

(1) Në fletoren zyrtare të Entit, pas pagesës së taksave dhe shpenzimeve përkatëse, shpallen të dhënat për:

- 1) regjistrim në Regjistrin e përfaqësuesve;
- 2) regjistrimi i ndryshimeve në Regjistrin e përfaqësuesve; dhe
- 3) shlyerja nga Regjistri i përfaqësuesve.

(2) Ekstrakti nga Regjistri i përfaqësuesve shpallet një herë në vit në numrin e parë të fletores së Entit me detyrë zyrtare.

PJESA E DHJETË

MBROJTJA GJYQËSORE

SHKELJA E TË DREJTAVE

Realizimi i mbrojtjes së të drejtës

Neni 291

(1) Personi e drejta e fituar me këtë ligj e të cilit është shkelur, ka të drejtë në mbrojtjen e së drejtës me parashtrimin e padisë para gjyqit, i cili është kompetent për zgjidhjen e kontesteve për të drejtat nga pronësia industriale.

(2) Si shkelje e të drejtave të paraqitura dhe të njohura, të përcaktuara me këtë ligj, konsiderohet çdo shfrytëzim i pautorizuar, dispozicion, përkufizim, imitim, asociacion, shqetësim i të drejtave dhe ngjashëm që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Për imitim, në kuptim të paragrafit (2) nga ky nen, konsiderohet nëse blerësi mesatar i mallrave, përkatësisht shërbimeve, pa marrë parasysh llojin e mallrave, mund ta shohë dallimin vetëm nëse i kushton vëmendje të veçantë, përkatësisht nëse te marka tregtare është fjala për përkthim ose transkripsion, përkatësisht transliteracion.

Personi i autorizuar për mbrojtje

Neni 292

Padi për realizimin e mbrojtjes së të drejtës nga neni 291 paragrafi (1) nga ky ligj mund të parashtrijë:

- parashtruesi i fletëparaqitjes për mbrojtjen e së drejtës,
- bartësi i së drejtës,
- fituesi i licencës ekskluzive, në sasi që e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit në bazë të punës juridike ose ligjit, dhe
- shfrytëzuesi i autorizuar i shenjës gjeografike, përkatësisht i shenjës së prejardhjes së mallit, dhe
- shfrytëzuesi i autorizuar i markës kolektive dhe të certifikuar tregtare.

Solidariteti i palëve

Neni 293

Kur ndonjë e drejtë e caktuar me këtë ligj është shkelur, secili nga bartësit e kësaj të drejte, në raport me personit të tretë mund të kërkojë mbrojtjen e së drejtës sikur është bartës i vetëm. Kur personi i cili e ka shkelur të drejtën i ka përmbushur kërkesat e njërit nga bartësit e së drejtës, detyrimi i tij pushon edhe ndaj bartësve të tjerë të së drejtës. Nëse bëhet fjalë për procedurë gjyqësore e cila është në rrjedhë, bartësit e të drejtës së njëjtë konsiderohen si bashëkontestues të vetëm.

Përmbajtja e kërkesës së padisë

Neni 294

(1) Personi e drejta e të cilit është shkelur me padi nga gjyqi mund të kërkojë:

- 1) verifikim e ekziston shkelje e së drejtës;
- 2) ndalim të veprimeve të cekura në padi me të cilat shkelet e drejta;
- 3) kompensim të dëmit që është shkaktuar me shkeljen e së drejtës me qëllim ose nga moskujdesi;

4) sekuestrim dhe shkatërrim të mallrave të cilat janë krijuar ose lëshuar në qarkullim me shkeljen e së drejtës dhe mjeteve të përdorura për prodhimin e tyre;

5) i padituri të japë informata për identitetin e personave të tretë të përfshirë në prodhimin dhe distribuimin e mallrave ose të shërbimeve me të cilat shkelen të drejtat, si dhe për kanalet e tyre për distribuim;

6) paraqitjen e dokumentacionit dhe të dhënat nga personi i cila ka shkelur të drejtën;

7) dënimi civil;

8) shpallja e aktgjykimit në shpenzim të të paditurit; dhe

9) kërkesa tjera.

Afati për parashtrimin e padisë

Neni 296

Padi për shkeljen e të drejtave të rregulluara me këtë ligj, mund të parashtrohet në afat prej tre vjetësh nga dita kur paditësi ka kuptuar për shkeljen si dhe për kryerësin, e më së voni në afat prej pesë vjetësh nga dita e shkeljes së kryer.

Urgjenca e procedurës

Neni 296

(1) Procedura ndaj padisë për shkeljen e të drejtave, kontestimi i të drejtave, masat e përkohshme dhe masat e tjera të sigurimit të rregulluara me këtë ligj është urgjente.

(2) Ndaj procedurave për mbrojtjen e të drejtave zbatohen dispozitat për procedurë kontestimore, përkatësisht për sigurimin e kërkesave.

Ndërprerja e procedurës gjyqësore

Neni 297

(1) Procedurën për shkak të shkeljes së të drejtës nga patenta e paraqitur, dizajni industrial, marka tregtare dhe shfrytëzimi i shenjës gjeografike, përkatësisht shenjës për prejardhjen e prodhimit, gjykata mund ta ndërpresë deri në marrjen e aktvendimit për njohjen e së drejtës adekuate nga Enti.

(2) Me padinë e cila ka të bëjë me shkeljen e së drejtës nga patenta, paditësi është i obliguar të parashtrojë dëshmi gjegjëse me shkrim në pajtueshmëri me nenin 62 paragrafi (6) nga ky ligj.

(3) Gjykata mund ta caktojë afatin në të cilin paditësi duhet ta parashtrojë dëshminë nga paragrafi (2) të këtij neni.

(4) Nëse dëshmia nga paragrafi (3) i këtij neni nuk parashtrohet në afatin që e ka caktuar gjykata, padia do të hedhet poshtë.

(5) Paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni do të zbatohen në fletëparaqitjet e shpallura evropiane në EPZ për shfrytëzimin e zbulimit në periudhën nga shpallja e fletëparaqitjes evropiane deri në njohjen e patentës evropiane si dhe patentës evropiane e cila është regjistruar në regjistrin e

Entit llogaritur nga data në të cilën EPZ e ka shpallur njohjen në pajtueshmëri me EPK.

Verifikimi dhe ndërprerja e shkeljes

Neni 298

(1) Kundër personave të cilët në mënyrë të paautorizuar kanë ndërmarrë disa veprime me të cilët kryhet shkelje e së drejtave të fituara në bazë të këtij ligji, me padinë mund të kërkohet verifikimi i i shkeljes, ndërprerja e shkeljes dhe ndalimi për shkelje të njëjta dhe të ngjashme.

(2) Kur me ndërmarrjen e veprimeve të caktuara do të shkaktohet kërcënim serioz për shkeljen e të drejtave të fituara në bazë të këtij ligji, me padinë mund të kërkohet ndërprerja e këtyre veprimeve dhe ndalimi për shkeljen e së drejtës.

(3) Padi nga paragrafët (1) dhe (2) nga ky nen mund të parashtrohet edhe kundër personave të cilët në kryerjen e veprimtarisë së vet ekonomike japin shërbime të cilat shfrytëzohen te subjektet të cilët i shkelin të drejtat, përkatësisht te të cilët ekziston kërcënim serioz për shkeljen e të drejtave.

Kompensimi i dëmit, kompensimi i zakonshëm dhe përfitimi i fituar pa bazë

Neni 299

(1) Personi i cili do t'i shkelë të drejtat nga pronësia industriale të rregulluara me këtë ligj përgjigjet për dëm sipas rregullave të përgjithshme për kompensim të dëmit nga Ligji për marrëdhënie obligative.

(2) Me padinë mund të kërkohet pagimi i kompensimit në shumë, e cila duke marrë parasysh rrethanat mund të kërkohet në marrëveshjen për licencë nëse e njëjta është lidhur.

(3) Kundër personit i cili pa bazë juridike, vendim gjyqësor ose ligj, në mënyrë të paautorizuar ndërmerr disa veprime me të cilët shkel të drejtën e fituara në bazë të këtij ligji dhe me këtë rast ka përfituar interes të caktuar, me padi mund të kërkohet kthimin ose kompensimin të këtij interesi, në pajtueshmëri me rregullat e përgjithshme për përfitim pa bazë nga Ligji për marrëdhënie obligative.

(4) Kërkesat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni nuk përjashtohen ndërmjet vetes. Në rast të kërkesave të parashtruara në mënyrë kumulative nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, gjykata do të veprojë në pajtueshmëri me rregullat e përgjithshme nga Ligji për marrëdhënie obligative.

Sekuestrimi dhe shkatërrimi i sendeve

Neni 300

(1) Me padinë mund të kërkohet që prodhimet të cilat janë krijuar ose furnizuar me shkeljen e të drejtave të fituara në bazë të këtij ligji, si dhe mjetet të cilat kryesisht janë shfrytëzuar në prodhime të tilla, të tërhiqen nga qarkullimi, të sekuestrohen ose të shkatërrohen.

(2) Masat nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata do t'i caktojë në barrë të të paditurit, vetëm nëse ekzistojnë shkaqe të veçanta që ashtu të mos vendoset.

(3) Në rast të përcaktimit të masës nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata do të ketë kujdes që masa të jetë në proporcion me shkallën e shkeljes së kryer.

Masat alternative

Neni 301

(1) Gjukata kompetente, me kërkesën e të paditurit mund të caktojë kompensim palës së dëmtuar si masë alternative, në vend të zbatimit të masave për tërheqje nga kanalet komerciale dhe mënjanim përfundimtar nga kanalet komerciale dhe masat për shkatërrim, pagesën kërkesës në para palës së dëmtuar.

(2) Masën nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mund ta caktojë nëse personi ka vepruar pa qëllim dhe pa kujdes, nëse zbatimi i masave lëndore do t'i shkaktonin dëm disproporcional dhe nëse pala e dëmtuar është e kënaqur nga kompensimi në të para.

Dorëzimi i të dhënave

Neni 302

(1) Në procedurën për shkeljen e së drejtës paditësi mund të kërkojë dorëzimin e dhënave për prejardhjen dhe për kanalet distributive të lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve me të cilat është shkaktuar shkelja.

(2) Padi ose masë e përkohshme nga paragrafi (1) të këtij neni mund të parashtrohet kundër:

1) personit i cili është paditur në procedurën për shkeljen e së drejtës nga ky ligj;

2) personave të cilët gjatë kryerjes së veprimtarisë ekonomike posedojnë mallra ose japin shërbime për të cilët ekziston dyshim se me to shkelet e drejta nga ky ligj;

3) personave të cilët gjatë kryerjes së veprimtarisë ekonomike japin shërbime të cilat shfrytëzohen në veprimet e subjekteve të tjera për të cilët ekziston dyshim se me to shkelet e drejta nga ky ligj; dhe

4) personave të cilët nga ana e ndonjë personi nga paragrafi (2) pikat 1), 2) dhe 3) të këtij neni janë cekur si pjesëmarrës në prodhimin ose distribuimin e mallrave ose në dhënien e shërbimeve për të cilët ekziston dyshim se me to shkelet e drejta nga ky ligj.

(3) Kërkesa nga paragrafi (1) të këtij ligji mund të parashtrohet edhe si kërkesë e parë në padi me më shumë kërkesa paditëse, nëse personi kundër të cilit është parashtruar padia është edhe në kërkesën kryesore.

(4) Kërkesa për parashtrimin e të dhënave për prejardhjen e mallrave dhe kanaleve distributive të mallrave dhe shërbimeve nga paragrafi (1) të këtij neni mund t'i përfshijë, posaçërisht

1) të dhënat për emrat dhe adresat e prodhuesve dhe të distribusve, të furnizuesve dhe poseduesve të mëparshëm të mallrave, përkatësisht dhënësve të shërbimeve, si dhe të shitësve me shumicë dhe pakicë për të cilët ai mall është dedikuar, dhe

2) të dhëna për sasinë e mallit të prodhuar, të përpunuar, të dërguar, të përdorur ose të porositur ose për shërbimet si dhe për çmimet e realizuara.

(5) Personi ndaj të cilit është parashtruar kërkesa për dorëzimin e të dhënave mund të refuzojë që t'i parashtrrojë nga të njëjtat shkaqe nga të cilat sipas rregullave të Ligjit për procedurë kontestimore mund të refuzohet dëshmia. Nëse refuzimi për parashtrimin e të dhënave nuk ka shkaqe të arsyeshme, personi përgjigjet për dëmin në pajtueshmëri me Ligjin për marrëdhënie obligative.

(6) Dispozitat nga ky nen nuk ndikojnë mbi zbatimin e dispozitave nga rregullat për mënyrën e shfrytëzimit të të dhënave të besueshme në procedurat civile dhe penale, dispozitat me të cilat janë verifikuar përgjegjësitë për keqpërdorimin e të drejtave të marrjes së të dhënave dhe dispozitat me të cilat rregullohen përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale.

(7) Dispozitat nga ky nen nuk kanë të bëjnë me nenin 314 të këtij ligji me të cilën rregullohet sigurimi i dëshmive.

Dënimi civil

Neni 303

(1) Gjatë shkeljes së të drejtave të fituara në bazë të këtij ligji, nëse të drejtat janë shkelur me qëllim ose pakujdesi të skajshme, bartësi i së drejtës mund të kërkojë pagimin e kompensimit të zakonshëm të rritur deri në 200%, pavarësisht nëse për shkak të shkeljes përjetona pësuar dëm pronësor në këtë shumë.

(2) Gjatë vendimmarrjes ndaj kërkesës për pagesën e dënimit nga paragrafi (1) të këtij neni dhe matjes së lartësisë së tij, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit veçanërisht shkallën e fajit të të paditurit, shumën, kompensimin e zakonshëm, si dhe qëllimin preventiv të dënimit.

(3) Nëse dëmi pronësor është më i madh se dënimi, bartësi i së drejtës ka të drejtë të kërkojë dallimin deri në zhdëmtimin e tërësishëm.

Shpallja e aktgjykimit

Neni 304

Paditësi mund të kërkojë që aktgjykimi i plotfuqishëm me të cilin madje edhe pjesërisht është pranuar kërkesa e padisë të shpallet në mjetet për informim publik me shpenzimin e të paditurit. Gjukata, në kufijtë e kërkesës së padisë do të vendosë në cilin mjete për informim publik do ta shpallë aktgjykimin si dhe atë se a do të shpallet i tërë aktgjykimi ose një pjesë e tij. Nëse gjykata vendos të shpallet vetëm një pjesë nga aktgjykimi, atëherë do të shpallet së paku dispozitivi dhe sipas nevojës ajo pjesë nga aktgjykimi nga i

cili është e qartë si është lloji i shkeljes dhe cili është personi që e ka shkelur të drejtën.

Shpallja e bartësit të patentës, përkatësisht dizajnit industrial

Neni 305

Zbuluesi, përkatësisht autori, trashëguesi i tij ose trashëgues tjetër ligjor me padi te gjykata kompetente mund të kërkojë që për tërë kohëzgjatjen e patentës, përkatësisht dizajnit industrial gjykata ta shpallë bartës të patentës, përkatësisht të dizajnit industrial, nëse patenta përkatësisht dizajni industrial është publikuar në emër të personit që nuk është shpikës, përkatësisht autor, trashëgues i tij ose trashëgues tjetër ligjor.

Kontesti për njohjen e zbuluesit gjegjësisht të autorit

Neni 306

(1) Zbuluesi i patentës, përkatësisht autori i dizajnit industrial, me padi te gjykata kompetente mund të kërkojë të përmendet në fletëparaqitje dhe në të gjitha dokumentet.

(2) Me vdekjen e zbuluesit, përkatësisht të autorit nga paragrafi (1) të këtij neni, e drejta e padisë kalon mbi trashëgimtarët e tij.

Afati për parashtrimin e padisë

Neni 307

Padia nga neni 306 të këtij ligji mund të paraqite nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes si dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së patentës, përkatësisht dizajnit industrial.

Kontestimi i së drejtës së markës tregtare

Neni 308

(1) Personi fizik ose juridik me padi për verifikim mund të kërkojë nga gjykata verifikojë se shenja të cilin e përdor në qarkullim për shënimin e mallrave të veta, përkatësisht shërbimi është identik ose i ngjashëm me markën tregtare të cilën e përdor person tjetër fizik ose juridik për shënimin e mallrave përkatësisht shërbimeve të veta nga lloji i njëjtë ose i ngjashëm dhe ajo shenjë është ka qenë e njohur mirë në kuptim të nenit 6 nga Konventa e Parisit si karakteristikë e mallrave, përkatësisht shërbimeve të paditësit para se paditësi të parashtrorë fletëparaqitje për markën tregtare.

(2) Paditësi mund të kërkojë nga gjykata që atë ta shpallë bartës të markës tregtare.

(3) Padinë nga paragrafi (1) të këtij neni gjykata nuk do ta pranojë nëse i padituri përkatësisht bartësi i markës tregtare dëshmon se para parashtrimit të fletëparaqitjes e ka shfrytëzuar shenjën kontestuese llojin njëjtë ose të

ngjashëm të, mallrave shërbimeve edhe atë aq sa edhe paditësi ose më gjatë se sa paditësi.

(4) Padia nga paragrafi (1) të këtij neni nuk mund të parashtrohet pas kalimit të pesë vjetëve nga dita e regjistrimit në markën tregtare në regjistrin e markave tregtare.

Rastet tjera të kontestimit të së drejtës së markës tregtare

Neni 309

Personi i cili në kohën e parashtrimit të fletëparaqitjes për njohje të së drejtës së markës tregtare ka firmë, përkatësisht emër identik me markën tregtare të personit tjetër, mund ta kontestojë atë markë tregtare për llojin e njëjta ose të ngjashëm të mallrave, përkatësisht të shërbimeve, përveç nëse bartësi i markës tregtare i cili ka qenë i vetëdijshëm në momentin e parashtrimit të fletëparaqitjes ka pasur firmë përkatësisht emër të njëjtë.

Shënimi në regjistër

Neni 310

(1) Në afat prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit gjyqësor të plotfuqishëm me të cilin është pranuar kërkesa e padisë, paditësi mund të kërkojë që të regjistrohet në regjistrin përkatës si bartës i së drejtës përkatëse dhe për këtë Enti t'i lëshojë dokument përkatës.

(2) Nëse personit të cilit i pranuar kërkesa paditëse në afat nga paragrafi (1) të këtij neni nuk parashtron kërkesë që të regjistrohet në regjistrin përkatës si bartës i së drejtës që i është pranuar, e drejta e regjistruar do të shlyhen nga regjistri përkatës.

Të drejtat e personave të tretë

Neni 311

Të drejtat të cilat personi i tretë i ka fituar nga bartësi i mëparshëm i të drejtave, vlen edhe ndaj bartësit të ri të së drejtës, nëse kanë qenë i shënuar në regjistrin përkatës ose janë paraqitur rregullisht para fillimit të kontestit.

Zbatimi i dispozitave për shkeljen e të drejtave

Neni 312

Në procedurat për kontestimin e të drejtave, zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat për shkeljen e së drejtës dhe masat për sigurim nga ky ligj.

Masat e përkohshme

Neni 313

(1) Personi i cili mund të parashtrrojë padi për shkeljen e të drejtave të veta të përcaktuara me këtë ligj, nëse dorëzon dëshmi me të cilat do të bëjë

të sigurt se e drejta e tij është shkelur ose do të shkelet, gjykata me propozimin e tij mund të përcaktojë masa të përkohshme për shkak të sigurimit të kërkesës së tij, edhe atë:

- të ndalohen të gjitha veprimet për shkelje dhe vazhdimi tyre;
- të konfiskohen, të tërhiqen nga qarkullimi dhe të ruhet ekzemplarët, mjetet, pajisjet dhe dokumentet në lidhje me to; dhe

- të miratohen masa të tjera të ngjashme.

(2) Me kërkesën e paditësit nëse dorëzon dëshmi me të cilët do të bëjë të sigurt se e drejta e tij është shkelur ose do të shkelet gjatë kryerjes së veprimtarisë ekonomike, me qëllim të përfitimit të interes ekonomik dhe me shkeljen e tillë mund të shkaktohet dëm i pakompensueshëm, krahas masave të përkohshme nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mund të caktojë si garanci marrjen e pronës së tundshme dhe të patundshme në pronësi të të paditurit pronë e cila është në lidhje direkte me shkeljen, si dhe ndalimin e të disponuarit me mjetet e llogarive tek institucionet financiare dhe të disponuarit me pronë tjetër.

(3) Për shkak të përcaktimit dhe zbatimit të masave nga paragrafi (2) të këtij neni, gjykata mund të kërkojë nga kryerësi i mundshëm i shkeljes ose nga persona të tjerë të cilët me të disponojnë, dorëzimin e të dhënave ekonomike ose qasje ndaj të dhënave të tjera të nevojshme dhe dokumenteve. Gjukata është kompetente ta sigurojë ruajtjen e fshehtësisë së këtyre të dhënave, si dhe të ndalojë keqpërdorimin e tyre.

(4) Masa e përkohshme nga paragrafi (1) të këtij neni mund të shqiptohet edhe pa informimin e kryerësit të mundshëm të shkeljes nëse propozuesi i garancisë bën të sigurt se masa tjetër e përkohshme nuk do të ketë efekt ose ekziston rrezik nga shkaktimi i dëmit të pakompensuar.

(5) Masa e përkohshme nga paragrafi (2) të këtij neni mund të shqiptohet edhe pa informimin e kryerësit të mundshëm të shkeljes nëse propozuesi i garancisë dëshmon se në të kundërtën masa e përkohshme nuk do të ketë efekt ose kjo është e domosdoshme duke marrë parasysh se bëhet fjalë për rrethana posaçërisht të rënda të shkeljes.

(6) Nëse masa e përkohshme është shqiptuar pa njoftimin e kryerësit të mundshëm, gjykata aktvendimin për masën e përkohshme menjëherë pas zbatimit të saj do t'ia dorëzojë kryerësit të mundshëm.

(7) Në vendimin për masën epërkohshme gjykata do të caktojë edhe kohëzgjatjen e kësaj mase. Nëse masa është përcaktuar para parashtrimit të padisë, afati në të cilin propozuesi i garancisë patjetër duhet të parashtrojë padi për shkak të dëshmisë së arsyetueshmërisë së atyre masave nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit propozuesit.

(8) Për procedurat për përcaktimin e masave të përkohshme zbatohen dispozitat për sigurimin e kërkesave, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Masat për sigurimin e dëshmive

Neni 314

(1) Me kërkesë të personit të cilit i është shkelur e drejta ose ekziston dyshim i arsyeshëm se do t'i shkelet e drejta, gjykata mundet të caktojë masë për sigurimin e dëshmive

(2) Masën nga paragrafi (1) të këtij neni gjykata mundet ta kumtojë veçanërisht për:

- (2) -përpunimin e përshkrimit në mënyrë të detajuar të mallit për të cilin mundet të bëhet e sigurt se ka shkelur të drejtë të caktuar, me apo pa marrjen e ekzemplarit;
- (3) -sekuestrimin e mallit për të cilin besohet se shkel të drejtë të caktuar; dhe
- (4) - sekuestrimin e materialeve dhe mjeteve që janë përdorur për përpunimin dhe shpërndarjen e mallit për të cilat ekziston dyshim se e cenon të drejtën e caktuar, si dhe dokumentacionin që ka të bëjë me të;

(3) Masa nga ky nen mundet të kumtohet dhe pa njoftim të palës së kundërt, nëse personi të cilit i është cenuar e drejta ose ekziston dyshim me bazë se do t'i shkelet paraqet prova me të cilat do të bëjë të sigurt se provat për këtë cenim mund të anulohen dhe se nuk do të mund të sigurohen ose do të shkaktohet dëm i pakompensueshëm. Nëse masa është kumtuar pa njoftim të palës së kundërt, gjykata do të vendos që masa menjëherë pas miratimit të saj t'i dorëzohet.

(4) Në aktvendimin për masën e përkohshme gjykata do të caktojë edhe kohëzgjatjen të kësaj mase. Nëse masa është caktuar para parashtrimit të padisë, afati në të cilin propozuesi i garancisë doemos duhet të parashtrrojë padi për shkak të dëshimit të arsyeshmërisë së këtyre masave nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit propozuesit.

(5) Në procedurat për caktimin e masave të përkohshme zbatohen dispozitat për sigurimin e kërkesave, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj.

Mbledhja e dëshmive gjatë procedurës kontestimore

Neni 315

(1) Kur pala në procedurë kontestimore thëritet në dëshmi dhe pohon se dëshmia gjendet te pala e kundërt ose nën kontrollin e saj, gjykata do ta thërrasë palën e kundërt që ta parashtrrojë atë dëshmi, duke përcaktuar edhe afatin e parashtrimit.

(2) Në rast kur bartësi i së drejtës nga ky ligj si paditës në padi pohon se ka ndodhur cenimi i së drejtës për shkak të përfitimit të dobisë ekonomike, si dhe kur në procedurën thirret në dokumente bankare, financiare ose të ngjashme ekonomike, shkresa dhe dëshmi të ngjashme dhe pohon se të njëjtat ndodhen te pala e kundërt ose nën kontrollin e saj, gjykata do ta thërrasë atë palë që t'i dorëzojë ato dëshmi, dhe do të caktojë afat për dorëzim.

(3) Kur pala e cila është e thirrur të paraqesë dëshmi mohon që dëshmia ndodhet te ajo ose në kontrollin e saj, gjykata mund të nxjerrë dëshmi për vërtetimin e atyre fakteve.

(4) Në lidhje me të drejtën e palës që ta refuzojë paraqitjen e dëshmisë së kërkuar, zbatohet e drejta e refuzimit të dëshmimit sipas dispozitave për procedurë kontestimore.

(5) Gjukata sipas bindjes së vetë do të vlerësojë se me çfarë rëndësie është ajo që pala nuk vepron sipas aktvendimit të gjykatës, me të cilin i

urdhërohet të dorëzojë dëshmi ose në kundërshtim me bindjen e gjykatës mohon që dëshmia gjendet te ajo.

PJESA E NJËMBËDHJETË

Mbikëqyrja

Neni 316

Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji bën Ministria e Ekonomisë.

Neni 317

Mbikëqyrje inspektuese për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në lidhje me qarkullimin dhe përdorimin e të drejtave të mbrojtura të pronësisë industriale bën Inspektorati shtetëror i tregut sipas detyrës zyrtare (në tekstin e mëtutjeshëm: Inspektorati) dhe me kërkesë të bartësit të së drejtës.

Neni 318

(1) Nëse Inspektori konstaton se janë shkelur të drejtat e pronësisë industriale do të miratojë aktvendim me të cilin do të urdhërojë tërheqjen e produkteve nga qarkullimi, përkatësisht pajisjes, mjeteve dhe dokumenteve në lidhje me to, përkatësisht do të caktojë masa adekuate për pengimin e shkeljes së mëtutjeshme dhe do të përcaktojë afat për tërheqjen e tyre nga qarkullimi, veçanërisht kur:

- 1)shfrytëzohet pa autorizim shpikja e mbrojtur;
- 2)shfrytëzohet ose imitohet pa autorizim dizajni i mbrojtur industrial;
- 3)shfrytëzohet ose imitohet pa autorizim marka e mbrojtur tregtare;
- 4)shfrytëzohet pa autorizim shenja ® për markë tregtare e cila nuk është e regjistruar; dhe
- 5)shfrytëzohet ose imitohet pa autorizim markë tregtare e njohur mirë dhe
- 6)shfrytëzohet ose imitohet pa autorizim emri i mbrojtur gjeografik,

(2) Nëse personi juridik ose fizik nuk vepron sipas urdhrit nga paragrafi (1) i këtij neni Inspektorati do të miratojë aktvendim për ndalim të përkohshëm të kryerjes së veprimtarisë në afat prej 30 ditësh për personin juridik, ndërsa për personin fizik deri më 15 ditë, do t'i vulosë hapësirat në të cilat kryhet veprimtaria dhe do t'i sekuestrojë produktet, pajisjen, mjetet dhe dokumentet në lidhje me to.

(3) Inspektori është i obliguar menjëherë t'ia dorëzojë gjykatës kompetente produktet, pajisjet, mjetet e marra dhe dokumentet në lidhje me to.

(4) Objektet e marra përkohësisht të krijuara me shkeljen e këtij neni, pas plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor shkatërrohen në pajtim me Ligjin për zbatimin e sanksioneve.

(5) Nëse inspektori konstaton se me shkeljen e bërë është realizuar përfitim kundërligjor pronësor është i obliguar që në kërkesën për ngritjen e

procedurës për kundërvajtje ta shënojë lartësinë e atij përfitimi dhe të kërkojë që ti merret kryerësit.

Neni 319

(1) Kur inspektori dyshon me bazë se me mallin e lëshuar në qarkullim shkelet e drejta e pronësisë industriale nga neni 318 paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa para parashtrimit të kërkesës nga ana e bartësit të së drejtës, mallin e ka vendosur jashtë qarkullimit me procesverbal.

(2) Për masën nga paragrafi (1) i këtij neni e lajmëron menjëherë bartësin e së drejtës, që të mund të parashtrojë kërkesë për marrjen e veprimeve në pajtim me nenin 320 të këtij ligji.

(3) Inspektori mund të kërkojë nga bartësi i së drejtës që t'i japë të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për vërtetimin e shkaqeve për dyshim.

(4) Nëse në afat prej 3 ditësh të punës nga lajmërimi, bartësi i së drejtës nuk paraqet kërkesë për marrjen e veprimeve në pajtim me nenin 320 të këtij ligji, malli do të lëshohet në qarkullim.

Neni 320

(1) Bartësi i së drejtës mund t'i paraqesë kërkesë në formë të shkruar Inspektoratit për ndërmarrjen e veprimeve të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale nga neni 318 i këtij ligji.

(2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i së drejtës është i obliguar t'i dorëzojë Inspektoratit:

1) dëshmi që e drejta adekuate e pronësisë industriale është e mbrojtur;

2) deklaratë që merr përgjegjësi të plotë për personat e kyçur në procedurë për shkak të veprimit ose lëshimit të bartësit të së drejtës ose kur është vërtetuar se malli objekt nuk shkel të drejtën e pronësisë industriale;

3) përshkrim teknik të mallit (të saktë dhe të detajuar);

4) vlerën e mallit origjinal në Republikën e Maqedonisë;

5) lokacionin e mallit;

6) të dhëna për importuesin e mallit, dhe

7) vendin ose vendet e prodhimit

PJESA E DYMBËDHJETË

DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 321

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 8.000 euro me kundërvlerë në denarë nga gjykata kompetente do t'i shqiptohet personit juridik për kundërvajtje, nëse:

1) pa autorizim merret me përfaqësim të personave të huaj juridikë dhe fizikë(neni 22);

2) shfrytëzon pa autorizim shpikje të paraqitur ose mbrojtur (neni 291 paragrafi (3));

- 3) shfrytëzon ose imiton pa autorizim dizajn industrial të paraqitur ose të mbrojtur (neni 291 paragrafi (3));
- 4) nëse shfrytëzon ose imiton pa autorizim markë tregtare të paraqitur ose të mbrojtur (neni 291 paragrafët (3) dhe (4));
- 5) nëse shfrytëzon ose imiton pa autorizim markë të njohur mirë tregtare (neni 291 paragrafi (3));

(2) Përveç gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik i shqiptohet sanksion për ndalesë të kryerjes së veprimtarisë prej një deri më tre vjet.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në person juridik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Përveç gjobës nga paragrafi (3) i këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik i shqiptohet sanksion ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në afat prej një deri më pesë vjet ose ndalesë të përhershme për kryerjen e veprimtarisë.

(5) Gjobë në shumë prej 700 deri në 1.200 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Përveç gjobës nga paragrafi (5) i këtij neni personit fizik i shqiptohet sanksion ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet.

(7) Për të gjitha kundërvajtjet nga neni 318 të këtij ligji dhe paragrafit (1) të këtij neni, personit juridik, personit përgjegjës në personin juridik dhe personit fizik do t'iu shqiptohet sanksion i veçantë për sekuestrimin e sendeve.

(8) Nëse vërtetohet se kundërvajtjet nga paragrafi (1) të këtij neni janë kryer nga grup i organizuar i personave, të përbërë së paku prej tre personave, gjykata kompetente mund të shqiptojë gjobë në shumë të trefishtë.

(9) Gjatë përsëritjes së kundërvajtjeve nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata kompetente mund të shqiptojë gjobë në shumë të pesëfishhtë.

(10) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1) të këtij neni me të cilët shkaktohet dëm më i madh pronësorë, në përmasa të lartësisë së dëmit të shkaktuar ose përfitimit të realizuar, gjykata kompetent mund të shqiptojë gjobë në shumë të dhjetëfishhtë të dëmit të vërtetuar.

Neni 322

(1) Gjobë në shumë prej 700 deri në 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit juridik për kundërvajtje, nëse:

1) shfrytëzon pa autorizim ® për markë tregtare e cila nuk është e regjistruar;

2) shfrytëzon ose imiton pa autorizim emrin e mbrojtur gjeografik (neni 291 paragrafët (3) dhe (4)), dhe

3) me kërkesë të bartësit të së drejtës nuk i ka dorëzuar dokumentet dhe të dhënat në lidhje me cenimin (nenet 297 paragrafi (2) dhe 314).

(2) Gjobë në shumë prej 350 deri në 700 euro me kundërvlerë në denarë do ti shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 350 deri në 700 euro me kundërvlerë në denarë do ti shqiptohet personit fizik për kundërvajtjet nga paragrafi (1) të këtij neni.

PJESA E TREMBËDHJETË

DOSPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Nxjerrja e akteve nënligjore

Neni 323

(1) Dispozitat e parapara me këtë ligj do të nxjerrjen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave nga paragrafi (1) të këtij neni, do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

Procedurat në rrjedhë

Neni 324

(1) Në procedurat për njohjen e të drejtave nga pronësia industriale për fletëparaqitjet e parashtruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, përveç për fletëparaqitjet për të cilat Enti ka ndërmarrë veprime të caktuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Për fletëparaqitjet evropiane të parashtruara para zbatimit të Ligjit për ratifikimin e Konventës për njohjen e patentave evropiane zbatohen dispozitat nga Marrëveshja për zgjerim.

(3) Dispozitat e neneve prej 119 deri 126 dhe neni 297 paragrafi (5) të këtij ligji do të zbatohen fletëparaqitjet evropiane të parashtruara pas 1 janari 2009.

(4) Dispozitat nga neni 74 të këtij ligji për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë për patentat me certifikatë për mbrojtje plotësuese do të zbatohen për fletëparaqitjet e parashtruara pas 1 janari 2004.

(5) Procedurat për mbrojtje gjyqësore, procedura për kundërvajtje dhe mbikëqyrja inspektuese nga ana e Inspektoratit shtetëror të tregut të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë përfunduar, do të përfundojnë sipas dispozitave të cilat kanë qenë në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(6) Për ankesat të cilat janë parashtruar kundër aktvendimeve të Entit deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vendos Komisioni i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vendimmarrje në procedurë administrative në shkallë të dytë në fushën e pronësisë industriale.

Pushimi i vlefshmërisë

Neni 325

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për pronësi industriale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/2002,42/2003,09/2006 dhe 79/2007).

Hyrja në fuqi

Neni 326

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".